

Nga fusha e leksikografisë

# Eufemizmat, ironia dhe fjalët me kuptim keqësues (pezhorativ) në FGJSSH të vitit 1980

Mr. Agim Spahiu

7 tetor 2008

## Përmbledhje

Gjuha shqipe (në ligjërimin e shkruar e të folur) është shumë e pasur me këtë kategori fjalësh e shprehjesh të këtilla gjuhësore. Derisa eufemizmat përdoren me kuptimin kryesisht pozitiv, ironia dhe fjalët pezhorative përdoren me kuptim negativ, përçmues, sharës, përbuzës, tallës, mospërfillës, mallkues etj. (të gjitha këto do të përfshihen në këtë **Fjalorth**), që, për fat të keq, shumë shqipfolës janë mishëruar me to në jetën e përditshme dhe janë bërë pjesë e kulturës së tyre gjuhësore. Sido që të jenë, edhe ato përbëjnë një pjesë të leksikut të shqipes. Prandaj, ato si të këtilla, duhet të mblidhen, të sistemohen dhe të studiohen. Derisa në gjuhë të tjera gjejmë mjaft studime dhe fjalorë të ndryshëm<sup>1</sup>, në gjuhën shqipe, në përgjithësi, mungojnë.

Hartuesit e **Fjalorit të gjuhës së sotme shqipe** të vitit 1980 i kanë kushtuar një vëmendje të madhe edhe kësaj kategorie gjuhësore, për çka ne e pamë të arsyeshme që, përmes programeve të linux-it t' i nxjerrim, t' i sistemojmë dhe ta krijojmë kështu një **Fjalorth**, që do ta ketë në dispozicion çdo lexues i interesuar.

Në Fjalorin e gjuhës shqipe të vitit 1980 fjala **EUFEMIZËM** është përkufizuar në këtë mënyrë: Fjalë ose shprehje që përdoret në vend të një fjale a shprehjeje tjetër, të

---

<sup>1</sup>E.Danninger, Tabubereiche und E.In: H. Welte (hg), *Sprachtheori und angewandte Ling.* Fs. A.Wolman, Tübingen, 1982, 237-251.- K. Allan, *Euphemism and Dysphemism: Language Used as Shield and Weapon.* Oxford 1991.- J. McDonald, *Dictionary of Obscenity, Taboo and Euphemism.* London 1995.- R.W.Holder, *A Dictionary of Euphemism and Other Double Talk.* N.Y, 1997.- A. Bertram, *NTC's Dictionary of Euphemism: The Most Practical Guide to Unraveling Euphemism.* Linkolnwood 1998;H. Lausberg, *Handbuch der lit. Rhetorik. Eine Grundlegung der Lit. wiss.* Stgt. 1990.- W.-D.Stempel, *I. als Sprechhandlung. Poetik und Hermeneutik 7,* 1976.- U. Japp, *Theori der I.* Ffm. 1983.-N. Bde.Tübingen 1984, 1985.- G. Ueding und B. Steinbrink, *Grundriß der Rhetorik. Geschichte, Technik, Methode,* Stgt. 1986.-R. Schnell, *Die verkehrte Welt. Lit.I. im 19 Jh.*Stgt. 1989.- E. Lapp, *Linguistik der I.Tübingen* 1992; P.Braun, *Personenbezeichnungen, Der Mensch in der Spr.* Tübingen 1997.- Ggwtd., 34- 38, 69- 80.- S. Karlbelschwili, *Lexikon zur Wortbildung der dt. Spr. (Augmentation und Deminution), Regensburg 1998.*/Të gjitha këto të dhëna u sollën nga: **Metzler Lexikon Sprache**, hartuar nga Helmut Glück, Stuttgart, 2000, f. 197, 319, 516/.

cilën nuk duam ose nuk duhet ta zëmë në gojë, fjalë a shprehje e butë a e zbutur (p.sh. të bukurat për "grykët", e paemra për "sëmundjen e shpretkës", buzëlidhuri për "i vdekuri", gojëlidhuri për "ujkun", nuk thotë të vërtetën në vend të "gënjen", u nda prej nesh në vend të "vdiq" etj<sup>2</sup>). Ndërsa **IRONIA**: Tallje (për dikë a për diçka) që bëhet në mënyrë të hollë e të mbuluar, duke folur gjoja me gjithë mend; qesëndi. *Ironi e fortë (therëse, keqdashëse). E kuptoj ironinë. Flet (qesh) me ironi. Godet me ironi.* Por kjo e fundit del edhe me vlerën e një figure stilistike. Dhe, si e tillë, në FGJSSH shpjegohet në këtë mënyrë: *let.* Figurë stilistike, me anë të së cilës shkrimtari, duke u dhënë fjalëve, shprehjeve etj. një kuptim të kundërt nga ai që kanë në të vërtetë ose duke bërë sikur pranon të kundërtën e asaj që mendon, përqesh e vë në lojë dikë a diçka. Përdor ironinë. \* *Ironi e fatit* libr. përdoret kur ndodh diçka që nuk pritej e as mund të mendohej, kur vjen diçka fare e rastit dhe e pagjasë ose kur diçka gjen një zgjidhje krejt të kundërt nga ajo që pritej a që duhej<sup>3</sup>.

Edhe fjalët dhe shprehjet me kuptim **KEQËSUES** (a **PEZHORATIV**= lat. **peior, më i keq/ më e keqe dhe deteriorativ; engl. pejorative word, term of abuse; fr. mot pejorativ**) zakonisht përkufizohen "kur një një gjësend a frymor lidhet me një fjalë dhe nënçmohet në mënyrë implicite"<sup>4</sup>.

Këtu më poshtë, me ndihmën e programeve të përmendura, kemi hartuar **një Fjalorth** të eufemizmave, ironive dhe atyre fjalëve e shprehjeve me kuptim keqësues (pezhorativ) që janë përfshirë në **Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe** të vitit 1980:

**AÇIK** mb. bised. 2. keq. Që vepron sheshit në mënyrë jo të hijshme e pa përfillur mendimin e njerëzve përreth, i pacipë, i pafytyrë. Grua açike. Sjellje açike.

**AFENDIKO** m. 2. keq. Njeri që mbahet rëndë si zotëri, fodull.

**AGA** m. 5. iron., keq. Ai që mbahet rëndë e që sillet me vrazhdësi; ai që kërkon vetëm të japë urdhra dhe të rrojë me mundin e të tjerëve. Rri (sillet) si aga.

**AGALLËK** m. 2. keq. Sjellje prej agai, qëndrim prej agai; të jetuarit në kurriz të të tjerëve si aga. E la agallëkun.

**AGESHË** f. 2. iron., keq. Ajo që sillet e vepron si grua agai.

**AGJENT** m. 2. keq. Bashkëpunëtor i fshehtë i organeve të zbulimit të një shteti të huaj ose i organeve policore të brendshme të një regjimi antipopullor; spiun.

Agjent i fshehtë (i vjetër, i regjur). Agjent i zbulimit amerikan. Bëhet agjent. Kapën një agjent. 3. keq. Ai që vihet në shërbim të synimeve e të veprimtarisë ideologjike, politike, ekonomike, ushtarake etj. të dikujt. Agjent i fashizmit (i imperializmit, i borgjezisë).

**AGJENTURË** f. 1. keq. Qendër e organizuar zbulimi a spiunazhi, që mbledh të dhëna të fshehta dhe që zhvillon veprimtari armiqësore kundër një vendi tjetër; grup ose organizatë, që u shërben synimeve dhe interesave ideologjike, politike, ekonomike, ushtarake etj. të një shteti, të një klase etj. Agjenturë e rrezikshme. Agjenturë e borgjezisë (e imperializmit).

**AGJËROJ** jokal. \* Agjëron ditën e vjedh natën keq. paraqitet i mirë, por në të vërtetë është i keq.

**AGJITATIV** mb. 2. keq. Që është i zbrazët e pa përmbajtje, që synon t'i mbushë

<sup>2</sup>Shih FGJSSH 1980, f. 438.

<sup>3</sup>Shih FGJSSH 1980, f. 729.

<sup>4</sup>Shih H.Gluck, *Metzler Lexikon Sprache*, Stuttgart.Weimer, 2000, f.515.

- mendjen dikujt me fjalë të zbrazëta. Frazheologji agjitative.
- AHA** pasth. 3. iron. Përdoret kur duam të theksojmë se është e pamundur të kryhet diçka, se është e kotë të shpresosh për të arritur diçka. Aha, nuk e arriti dot!
- AHENG** m. bised. 2. keq. Dëfrim i shturur me të pira të tepruara e me rrëmuje.
- AJËR** m. \* Ngre (ndërton, bën) kështjella në ajër (në erë) keq. shih te KËSHTJELL/Ë,~A.
- AJO** përem. 10. dëft. euf. përdoret për të zëvendësuar një emër (sëmundjeje etj.), që nuk dëshirojmë e që nuk e quajmë të udhës ta zëmë në gojë për shkak paragjykimesh a për arsye të tjera. Ajo punë sëmundja e tokës. Ajo e fëmijëve (e tokës) sëmundja e tokës. Ato të grave zakonet, rregullat e grave. Ajo e gjellës kripë gjelle.
- AKAPARIM** m. keq. Veprimi sipas kuptimeve të foljeve AKAPAROJ, AKAPAROHET. Akaparimi i mallrave (i tregut). Akaparimi i votave.
- AKAPAROHET** keq. Pës. e AKAPAROJ.
- AKAPAROJ** kal. keq. Shtie në dorë e grumbulloj në sasi të mëdha një mall a diçka tjetër për të siguruar fitime më pas me rrugë të padrejta; monopolizoj. Akaparon drithin (tokat). Akaparojnë votat.
- AKAPARUES** m. keq. Ai që akaparon, ai që merret me akaparime. Akaparues drithi (lëndësh të para).
- AKOMA** ndajf. 4. bised., iron. Përdoret me një mohim për të treguar se nuk shqetësohemi për të keqen që mund të ndodhë ose për të dëshiruar një të keqe. Akoma s'është thyer! Akoma s'ka thyer qafën! b) përdoret për të treguar se kërcënimi që na bëhet nuk na tremb. Është akoma (ende, hala) tek ura iron. shih tek UR/Ë,~A I.
- AKORDOJ** kal. \* I akordoi telat me dikë keq. është marrë vesh, ka rënë në ujdi me dikë.
- AKRABA** f. thjeshtligj., vjet. 2. ~, ~TË keq. Mik. Punë me akraba. Përkrah akrabatë.
- AKRABALLËK** m. keq. Përkrahje që u jepet miqve e farefisit në dëm të interesave të përgjithshme; miqësi e sëmurë.
- AKREP** I m. 2. keq. Njeri dorështrënguar. 3. keq. Njeri shpirtkeq, i pabesë e tinëzar.
- AKROBACI** f. 3. edhe ~RA, ~RAT fig. keq. Veprim i shkathët e dredharak, që synon të mashtrojë dikë, duke e mbuluar a kapërcyer thelbin e çështjes; pehlivanlëk. Akrobaci politike (filozofike).
- AKROBAT** m. 2. fig. keq. Ai që i kapërcen vështirësitë me dredhi e me shkathtësi, pa iu përmbajtur një parimi të qëndrueshëm e duke iu larguar thelbit të çështjes (zakonisht në veprimtarinë politike); pehlivan. Akrobatët e politikës. Politikan akrobat.
- AKROBATIK** mb. 2. fig. keq. Dredharak, që synon të kapërcejë një gjendje të vështirë me mashttrim e me shkathtësi. Ndërhyrje (veprime) akrobatikë. Me mënyra akrobatikë.
- ALARMIST** m. keq. Ai që përhap fjalë e lajme shqetësuese, ai që ngjall panik dhe e fryn rrezikun.
- ALILLUJA** pasth. fet. vjet. \* I këndon alilluja dikujt keq. i thur lëvdata të tepruara dikujt; i bën lajka; i shkon pas avazit.
- ALTOPARLANT** m. 2. fig. keq. Ai që përhap me të madhe idetë e mendimet e një tjetri. Altoperlantët e borgjezisë. Bëhet altoperlant i dikujt.
- ALLISHVERISHI** m. bised. 2. keq. Mar-rëveshje e veprime të mbuluara me qëllime të pandershme; tregti jo e pastër, dallavere. Bënte allishverishe. Merrej me allishverishe.
- AMBALAZH** m. 2. fig. keq. Diçka që përdoret për të mbuluar qëllimet e vërteta dhe për t'i paraqitur ndryshe nga ç'janë; veshja e jashtme për ta zbukuruar diçka. E paraqiti nën një ambalazh. Shërben si ambalazh.

- AMBICIE** f. 2. keq. Dëshirë e fortë për lavdi personale, për pozitë ose për pushtet; synim për të dalë me çdo mënyrë mbi të tjerët në përpjekjet për të arritur një qëllim. Ambicie e sëmurë. Ngjall (përkëdhel) ambicien. Kënaq ambiciet e dikujt.
- AMERIKANATË** f. keq. 1. Veprim që shkel rregullat e zakonshme të sjelljes në shoqëri, sjellje e shtthurur; aventurë për të bërë bujë. Amerikanatë e çmendur. 2. Muzikë e shtthurur.
- AMERIKANIZOHEN** vetv. 1. Marr tiparet e amerikanit; keq. bëhem si amerikan.
- AMERIKANIZOJ** kal. 1. I jap tiparet e amerikanit; keq. e bëj si amerikan, i fut mënyrën amerikane të jetesës.
- ANAÇ** mb. keq. Që përpiqet t'i shmangët punës, që i bën bisht punës, hileqar. Njeri anaç. Kafshë anaçe.
- ANADOLLAK** m. 2. keq. Njeri i prapambetur, që mendon e vepron sipas zakoneve të vjetruara e prapanike; njeri i pagdhendur, i vrazhdë.
- ANADOLLAK** mb. 2. keq. Që u përmbahet zakoneve të vjetruara e prapanike, i prapambetur; që ka mendime e sjellje të trasha, i pagdhendur, i vrazhdë; që është njëkohësisht shtypës e prapanik. Zakone anadollake. Sjellje anadollake. Regjim anadollak. Sundimtar anadollak.
- ANADOLLIZËM** m. keq. Mënyrë e prapambetur, anadollake e të jetuarit, e të menduarit, dhe e të vepruarit.
- ANË** I f. \* Ana e keqe euf. djalli. Në atë anë (krah, brinjë) fli! iron. shih te **KRAH**, ~U. Nga një anë të puth, nga tjetra të pret keq. shih te **PUTH**.
- ANGËSHT** ndajf. krahin. 2. fig. Me keqdashje, keq. Flet angësht për dikë.
- ANKOJË** f. keq. \* Moj dhelpër, moj ankojë, shumë armiq zure në gojë! iron. shih te **DHELP/ËR**, ~RA.
- ANTIKË** f. 2. thjeshtligj., iron. Njeri me zakone e me sjellje të veçanta e pak të çuditshme.
- APOSTOLIK** mb. fet. edhe iron. 1. Papnor. Delegat apostolik. 2. Që ka të bëjë me apostujt, i apostujve; që ka vetitë a tiparet e një apostulli. Fjalë apostolike. Butësi apostolike.
- AQ** Aq (kaq) e pati! zakon. iron. mori fund.
- ARË** f. \* I tregon (i rrëfen) babait arat iron. shih te **BABA**, ~I.
- ARËZ** f. \* Fole arëzash (grerëzash) keq. shih te **GRERËZ**, ~A.
- ARISTOKRAT** m. 1. Pjesëtar i shtresës së fisnikëve, ai që bën pjesë në aristokracinë e vendit. Shtresa e aristokratëve. Qëndrim prej aristokrati. keq. qëndrim përbuzës ndaj masave punonjëse.
- ARTË** mb. \* Çelës i artë libr. mjet për të zgjidhur çdo gjë, shkop magjik. E mesmja e artë (mesi i artë) keq. qëndrim i mesëm, as andej as këtej; qëndrim ose veprim që nuk të çon në ndeshje me dy palët e kundërta dhe që lejon të përfitosh nga të dyja anët.
- ARTIZANAL** mb. 3. fig. keq. Që bëhet me mënyra të prapambetura a primitive, që nuk njeh e nuk zbaton metodat shkencore e të përparuara; i prapambetur. Metoda (mënyra) artizanale. Koncepte artizanale.
- ARUSHË** f. \* Luan arushë me dikë keq. tallet me dikë, e sjell vërdallë sipas qejfit të tij.
- ARRË** f. \* Arrë fyçkë keq. shih te **FYÇK/Ë**, ~A.
- ARRËZ** I f. anat. \* Thyej (këput) arrëzën (qafën)! keq. largohu që këtej, shporru!
- ARRIJ** kal. dhe jokal. I arrijnë sytë gjer te maja e hundës keq. shih te **HUND/Ë**, ~A.
- ASQER** m. vjet. 2. keq. Ushtar i çrregullt.
- ASHIK** II m. vjet. 2. keq. Njeri i dhënë shumë pas qejfeve.
- ASHTUQUAJTUR** mb. 2. keq. Që quhet me një emër, i cili nuk përputhet me të vërtetën, që nuk është siç e mban veten

a siç duan ta paraqitin të tjerët. I ashtuquajturi «kapitalizëm popullor». Të ashtuquajturit «qytetërues».

**ATA** II përem. vjet. bised. \* Ç'qe ata! vjet., iron. Çudi! Si është e mundur! Si mund të ndodhte! Ç'është ata! vjet. Përdoret si përgjigje për ta qetësuar bashkëbiseduesin, duke e siguruar se diçka do të bëhet, me kuptimin: patjetër, pa asnjë dyshim.

**ATJE** ndajf. \* Qeni leh atje ku ha fj.u. keq. shih te QEN,~I.

**ATO** përem. \* Ato të grave euf. zakonet, të përmuajshmet e grave.

**ATOMIST** m. 2. keq. Ai që përkrah përdorimin e armëve atomike; ai që prodhon armë atomike.

**AUTOMATIZËM** m. libr. 2. fig. keq. Kryerja e një veprimi a e një pune në mënyrë mekanike, si pa vetëdije, pa u menduar ose sipas dëshirave a udhëzimeve të një tjetri.

**AVAZ** m. bised. 4. keq. Ves, huq, zakon i keq i dikujt; e metë, dobësi. Njeri me avaze. S'i ka lënë (s'i harron) avazet e vjetra. Hoqi dorë (filloi përsëri) nga avazet e mëparshme. \* Avazi i Mukës keq. gjë e vjetër, që është thënë e stërthënë; diçka e njohur, që është përsëritur vazhdimisht. (Këndoj, i heq këmbët, i hedh hapat) sipas avazit të dikujt keq. sipas dëshirave të dikujt, siç ka qejf ose siç me porosit dikush. I bie një (po atij avazi) (mban një avaz) keq. vepron në të njëjtën mënyrë ose flet po të njëjtat gjëra, i bie fyellit në një vrimë. I mban avazin (i shkon pas avazit, i vete pas avazit) i shkon pas qejfit, vepron sipas dëshirave e porosit të dikujt. Ia mban avaz ia përmend vazhdimisht, ia përsërit shumë herë, ia mban këngë.

**AVENTURË** f. 2. keq. Punë e rrezikshme dhe e pamenduar, që nisat pa peshuar rrethanat, mundësitë e forcat, veprim që fillohet pa parashikuar përfundimin, pa llogaritur pasojat. Aventurë politike

(ushtarake). I futet një aventurë. Hidhet në aventura.

**AVOKAT** m. 2. keq. Ai që mbron e përkrah me fjalë dikë tjetër, pavarësisht nëse ky ka ose nuk ka të drejtë. Avokat i të tjerëve. I doli (iu bë) avokat. Nuk kam nevojë për avokat.

**AVOKATLLËK** m. bised. keq. Mbrojtja dhe përkrahja me fjalë e dikujt tjetër, pavarësisht nëse ky ka apo nuk ka të drejtë. Merret me avokatllëqe. Lëri avokatllëqet!

**AXHAMI** m. bised. 2. keq. Njeri i papërvojë e i pastërvitur në një punë, kalama. 4. keq. Përd. mb. sipas kuptimit 2 të emrit.

**BABA** m. 3. vet. vjet. Deputetët reaksionarë në parlamentin e regjimit zogollian; iron. paria e vendit, që e mbante veten si ajka e shoqërisë. Baballarët e kombit. \* Për shpirt të babait iron. shih te SHPIRT,~I. S'ia jap për shpirt të babait s'ia jap falas, për asgjë (për diçka që jepet pa dëshirën e të zotit). (i rrëfen) babait arat iron. i shpjegon një tjetri diçka që ai e di më mirë nga përvoja e vet. Hajde baba të të tregoj arat (vreshtin) iron. i tregon babait arat. Bëmë baba (nënë) të të ngjaj shih te NGJAJ. Iu bë (iu gjend) nënë e baba dikujt shih te NËN/Ë,~A. Ca të babait (të nënës) ca të njerkut (të njerkes) njëri trajtohet mirë e tjetri keq pa të drejtë.

**BABË** m. \* Të vë babën burrë keq. është shpifës i madh.

**BAHÇEVAN** m. bised. \* Qen bahçevani (kopshti, kopshtari) keq. shih te KOPSHT,~I.

**BAJONETË** f. \* Me forcën e bajonetës keq. me armë, me dhunë. Nën bajonetën e armikut në mes të rrezikut.

**BAJRAK** m. \* Është me bajrak keq. është me nam të keq, është i njohur prej të gjithëve. Ndërroi bajrak tradhtoi, ndërroi flamur.

**BAJRAKTAR** m. 3. keq. Njeri që sillet ashpër e me mendjemadhësi, që i pëlqen vetëm të sundojë e të urdhërojë; ai që

- drejton punën me metoda të vjetruara, patriarkale e konservatore. Bajraktar i vogël. Ishte bërë bajraktar.
- BAJRAKTARIZËM** m. 2. keq. Mënyrë drejtimi e vjetruar e patriarkale, që mbështetet në komandimin me ashpërsi e me mendjemadhësi; qëndrim e sjellje prej bajraktari, synimi për të vepruar si bajraktar. Shfaqje të bajraktarizmit. Lufta kundër bajraktarizmit.
- BAKALL** m. vjet. \* Defter bakalli keq. regjistër i mbajtur keq, i fëlliqur e gjysmë i grisur. Pusullë (letër) bakalli keq. shkresë a letër, e shkruar në kartë të keqe, jo sipas rregullave dhe e mbajtur fare pa kujdes.
- BAKËR** m. 4. fig. keq. Gjë që nuk vlen shumë a që nuk e çmojmë si duhet. Para bakër diçka me vlerë të pakët ose fare pa vlerë. I doli bakri keq. iu zbulua fytyra e vërtetë, i dolën lakrat në shesh, i doli boja.
- BALO** m. \* Ku lë laroja të hajë baloja keq. shih te LARO,~JA. Kape laro, prite balo! tall. s'e merr vesh i pari të dytin, se secili bën sipas kokës.
- BALTË** f. 8. fig. keq. Send a njeri pa vlerë; diçka që kushton fare lirë. U bë baltë dikush a diçka. 9. edhe ~ËRA, ~ËRAT fig. keq. Diçka e ndyrë, ndyrësi, diçka e pandershme. Baltërat e shekujve. Balta e turpfit. Pastroi baltërat. b) keq. njeri i pakarakter; njeri i paqëndrueshëm, njeri i lëkundshëm. Baltë e ngjitur keq. shih te NGJITUR (i, e). Bën baltë tall. rri kot, rri pa punë ose merret me diçka të padobishme. Hëngri baltë përçm. shih te HA. I bëhej baltë në opingë dikujt keq. shih tek OPING/Ë, ~A. Mbuloi balta baltën përb. thuhet kur vdes një njeri i keq, i pavlerë a i poshtër, që ka bërë shumë të liga (në kuptimin «mirë bëri që vdiq»).
- BALLË** I m. I ka plasur cipa (peta) e ballit keq. është i pacipë, s'ka turp fare. I ka plasur damari (delli) i ballit (i marres) keq. shih te DAMAR,~I.
- BALLIÇ** mb. keq. Ballëdalë.
- BALLUKE** f. \* I vë balluke keq. e tradhton, e turpëron, i vë brirë (për bashkëshortët).
- BANAK** m. \* Nën banak keq. fshehurazi, duke ua shitur mallrat miqve e të njohurve pa i nxjerrë përpara blerësve (në kundërshtim me rregullat e tregtisë socialiste); nën dorë.
- BANAL** mb. 2. keq. I pahijshëm, i ndyrë, i turpshëm (për fjalët etj.); që përdor fjalë të ndyra e sillet në mënyrë të shëmtuar; që nuk ka ideale të larta; që ka shije të ulët. Fjalë (shprehje) banale. Shaka (anekdotë) banal. Njeri banal.
- BANDË** I f. 2. keq. Grup njerëzish të bashkuar për të bërë vjedhje, plaçkitje e krime; grup njerëzish, zakonisht në pushtet, që vepron në dëm të popullit me metoda kriminelësh e tradhtarësh. Bandë e armatosur. Bandë balliste (reaktionare).
- BANDIT** m. keq. Njeri që vret e pret dhe plaçkit në mënyrë të egër e të pamëshirshme; pjesëtar i një bande kriminelësh; keqbërës. Grup banditësh. Punë banditësh. I kapën banditët.
- BANIKE** f. euf. Prapanikja, të ndenjurit. I ra në banike.
- BANJË** f. 8. euf. Nevojtoje. Dera e banjës.
- BAR** I m. \* E ha barin pa shkop keq. shih te SHKOP,~I.
- BARASH** m. krahin. keq. Njeri që ka qejf të bredhë shumë, ai që e kalon kohën duke baritur a duke shëtitur.
- BARDHË** f. 8. vet. euf. Qenie fantastike, të cilat, sipas paragjyqimeve popullore, përfityroheshin si vajza, që rronin në mal e nën tokë dhe bënin të këqija kur zemëroheshin. \* E bën (e paraqit) të bardhën të zezë (të zezën të bardhi) keq. e paraqit diçka krejt ndryshe nga ç'është në të vërtetë, e shtrembëron fare të vërtetën.
- BARDHË** mb. 11. euf. Përdoret si gjymtyrë e dytë në emërtimet e pathjeshta të disa

- sëmundjeve ngjitëse e të rënda. Kolla e bardhë kolla e mirë. Grykët e bardha difteria. Lia e bardhë. Murtaja e bardhë tuberkulozi.
- BARK** m. Më plasi barku! iron. M'u dogj barku! iron. Fërkon barkun (duart) keq. shih te FËRKOJ. S'i hapet (s'i pëlçet, s'i di gjet) barku për dikë përçm. s'e ha merak fare për dikë, nuk shqetësohet për të, nuk ndien asgjë. Ktheu barkun (nga dielli) tall. shih te KTHEJ. Më preu barku (malli) për dikë a diçka iron. shih te PRES 1. Të vret barkun iron. shih te VRAS. I ra barku në bela shak. hëngri gjellë të mira shumë. Vret barkun në hije iron. shih te VRAS. Ia bëri kurrizin (shpinën) më të butë se barkun keq. shih te KURRIZ,~I.
- BARKAÇ** mb. keq. I pangopur, grykës. Njeri barkaç.
- BARKALAQ** mb. keq. Barkalec.
- BARKALEC** mb. keq. 1. Që e ka barkun pak të madh, që vjen si me bark. Njeri barkalec. Peshk barkalec. Lopë (dele) barkalece. Poçe (gotë) barkalece.
- BARKALIQ** mb. keq. Barkalec. Fëmijë barkaliqë. Poçe barkaliqe.
- BARKANJOZ** mb. keq. shih BARKMADH,~E.
- BARKARIS** kal. krahin. 2. fig. keq. E tret diku larg, e bëj të humbasë, e degdis.
- BARKARISEM** vetv. krahin. keq. Iki diku larg, degdisem, zhdukem nga sytë.
- BARKASHOR** mb. 2. keq. I pangopur, grykës.
- BARCKACEK** mb. keq. 1. Barkfytyrë.
- BARCKALBUR** mb. bised. keq. Zemërzi, shpirtlig.
- BARCKEQ** mb. bised. keq. Zemërzi, shpirtlig.
- BARCKLEDH** mb. thjeshtligj. keq. shih BARKMADH,~E 1,2.
- BARCLUBI** mb. bised. keq. 1. Që s'ndien të ngopur, i pangopur (edhe fig.). Gojëmi e barklubi.
- BARCKZHABË** mb. thjeshtligj., keq. 1. Që e ka barkun të madh, të squllët dhe të varur poshtë.
- BARONESHË** f. hist. 2. E shoqja ose e bija e baronit. Mbahej (sillej) si baroneshë. iron.
- BASTARD** m. 3. keq. vjet. Fëmijë i lindur jashtë martesë, fëmijë i jashtëligjshëm.
- BASTARD** mb. 4. keq.,vjet. Që ka lindur jashtë martesë, i jashtë ligjshëm. Fëmijë bastard.
- BASTARDOHEM** vetv. 2. keq. Humbas vetitë e mira, zvetënohem, prishem përdhosem e çoroditem. Bastardohej gjuha (kënga...).
- BASTARDOJ** kal. 2. keq. E bëj të humbasë vetitë e mira, e zvetënoj, e prish, e përdhos dhe e çorodit. Bastardoi idenë (mendimin) e dikujt. Bastardoi gjuhën e prishi gjuhën, duke e mbushur me fjalë, me shprehje e me ndërtime të huaja. Bastarduan kulturën.
- BASHIBOZUK** m. 2. keq. Pjesëtar i trupave të çrregullta, të paorganizuara e të padisiplinuara, që vrasin e plaçkitin popullsinë; ushtar i çrregullt dhe i padisiplinuar. Bashibozukët e «Ballit Kombëtar».
- BASHIBOZUK** mb. keq. 1. I përbërë prej bashibozukësh; që vret e plaçkit popullsinë. Forca bashibozuke. Bandë bashibozuke. 2. I çrregullt dhe i padisiplinuar, që është tipar dallues për bashibozukët. Sjellje bashibozuke. Jetë bashibozuke.
- BASHKË** ndajf. \* Kur të bëhen dy ditë bashkë iron. shih te DIT/Ë,~A. Më sa bëhen bashkë një grusht pleshta iron. shih te PLESHT,~I.
- BASHKOHEM** vetv. \* Kur të bashkohet (të takohet, të puqet) qielli e toka iron. shih te QIELL,~I.
- BATAK** m. 3. fig. keq. Njeri i ulët e i ndyrë, bataçqi; përmb. fundërrinat e shoqërisë, llumi. Bataku i shoqërisë.

- BATALL** ndajf. bised. \* Batall (i madh) fort!  
iron. punë e madhe!, s'ka gajle!, aq më  
bën!
- BE** f. b) iron. betohet me të madhe për të  
mbuluar diçka të rreme. Lëshoi be për  
diçka shih te LËSHOJ. I lëshoi (i qiti)  
be shih te LËSHOJ. U bë një be (beja  
e dheut) u bë turpi i botës. Rrahu benë  
vjet. shih te RRAH.
- BEDEL** m. 2. keq. Ai që bën një punë në vend  
të një tjetri, i cili e ka për detyrë; ai që  
bën a pëson diçka në vend të një tjetri  
kur nuk duhet. S'bëhem bedel i tjetrit.  
Nuk pranon bedel. S'ka bedel sot.
- BEGENIS** kal. bised. 3. jokal. iron. Pranoj  
të bëj diçka, megjithëse e quaj të papër-  
shtatshme për shkallën time. Nuk bege-  
nis të flasë. As begenisi t'i hidhte një  
vështrim. Begenis e fol me gojë!
- BEJLLËK** m. 4. keq. Jetë e shkujdesur dhe  
me gjithë të mirat në kurriz të të tjerëve,  
jetesë si e beut; sjellje prej beu.
- BEJTE** f. kryes. 2. keq. Vargje pa vlerë, vjer-  
shë e keqe. Shkruante bejte.
- BEJTEXHI** m. 2. keq. Ai që shkruan vargje  
pa vlerë artistike, vjershëtar i keq.
- BEKOJ** kal. 4. keq. Shpreh miratimin për  
diçka të keqe; e nxit punën për ta vijuar  
diçka më tej. Kisha i ka bekuar fashistët.
- BEKUAR** f. euf. Sëmundja e lisë.
- BEL** I m. \* M'u këput beli shih te KËPUTEM  
1. Rri me duar në bel (në ijë, në brez, në  
mes) keq. shih tek IJ/Ë, ~A.
- BELBËZOJ** jokal. 3. keq. llogarit. Belbëzoi  
diçka (me vete).
- BEND** III m. keq. Ai që i shkon pas dikujt  
për të përfituar prej tij. Bendi i beut.
- BESËPRERË** mb. keq. 1. Që të pret në besë,  
që s'e mban besën e dhënë, i pabesë.
- BETUAR** mb. 1. keq. Që nuk pajtohet kurrë  
me diçka, që qëndron deri në fund pa u  
lëkundur në të vetën, që nuk heq dorë  
kurrë nga qëndrimi i vet (për kundër-  
shtarët). Armik i betuar.
- BËHEM** vetv. 14. kryes. veta III vet. kr. thj.  
mospërf. Nuk është i asaj moshe a i asaj  
shkalle ose nuk ka atë vlerë, që të kraha-  
sohet me mua; nuk është i denjë për t'u  
barazuar me dikë, nuk meriton të përfit-  
let. U bë dhe ai... U bëtë dhe ju..U bëre  
dhe ti... U bë dhe koka e tij! U bë veza  
të mësojë pulën! iron. I bëhej baltë në  
opingë dikujt keq. Kur të bëhen dy ditë  
bashkë iron. shih te DIT/Ë, ~A.
- BËJ** kal. E bën të bardhën të zezë. keq. Kur të  
bëjë qarri arra. iron. kurrë. Kur të bëjë  
larushku rrush. iron. kurrë. E bëri (e  
qiti, e nxori) çirak dikë edhe iron. shih te  
ÇIRAK, ~U. I bënë dasmën dikujt iron.  
shih te DAS/ËM, ~MA. E bëri daulle  
dikë përçm. shih te DAULL/E, ~JA. I  
bën qejfin vetes keq. i mbush mendjen  
vetes për diçka se ashtu është siç mendon  
ai, se do të bëhet ashtu siç do ai. Bën hije  
mbi dhe keq. shih te HIJ/E, ~A.
- BËRDHAC** m. euf. Morr.
- BËRLLOK** m. 2. përd. mb. keq. I papastër, i  
ndyrë; që nuk vlen, i keq. Njeri bërllok.  
Mall bërllok mall i dobët, i pavlerë.
- BËRTAS** jokal. 4. keq. Flas ose shkruaj  
shumë për diçka, bëj shumë zhurmë për  
një çështje, duke u përpjekur me çdo  
mjet të tërheq vëmendjen ose të arrij, një  
qëllim; çirrem. Bërtet me të madhe. Çir-  
ret e bërtet.
- BËRRYL** m. \* I ka futur duart deri në bërryl  
keq. ka ndërhyrë shumë në punët e një  
tjetri.
- BËTAJË** f. krahin. 2. euf. Sëmundja e tokës,  
epilepsia. Bar bëtaje. E nget bëtaja. I  
rëntë bëtaja! mallk.
- BIBË** f. 3. fig. keq. Grua ose vajzë e trashë  
nga mendja. budallaqe.
- BIÇIM** m. thjeshtligj. 3. keq. Njeri që nga  
pamja ose nga sjelljet shquan për keq nga  
të tjerët; njeri i një lloji të veçantë. Biçim  
njeri (burrë). Biçim më vete. Çfarë  
biçimi!



**BIE** I jokal. I bie buzukut tall. shih te BUZUK,~U. Ranë çanakun e dikujt keq. shih te ÇANAK,~U. I bie daulles së dikujt keq. shih te DAULL/E, ~JA. Ra (zbriti, u rrëza) nga fiku iron. shih te FIK,~U. Ka rënë nga hëna iron. shih te HËN/Ë,~A. I ra hiles shih te HIL/E, ~JA. I ra hunda tall. shih te HUND/Ë,~A.

**BIOGRAFI** f. \* I bëri biografinë keq. tha gjithçka dinte për një njeri, duke e marrë nëpër gojë.

**BIRBO** m. keq. Njeri pa shtëpi e pa katandi; ai që bën jetë të parregullt; njeri mendjelahtë e i dhënë pas jetës së shthurur. Jetë birbosh.

**BIRUES** m. 2. keq. Ai që fut hundët kudo, ai që përzihet në punët e të tjerëve; biramel. Birues i keq.

**BISBIQ** II m. 2. keq. Njeri zakonisht me trup të vogël a të hequr, por shumë i lëvizshëm; llafazan e ngatërrestar; mistrec.

**BISHAR** m. keq. Njeri i egër si bishë.

**BISHT** m. 8. fig. keq. Shtojcë e pa-parashikuar dhe e tepërt, që paraqitet për të ngatërruar një punë ose për t'iu shmangur një detyre; trillim, diçka e paqenë që shtohet me një qëllim. Punë me bishta. Nxjerr (ngjit) bishta. I vuri bisht prapa. Dalin bishta. Kërkonte bishta. I gjeti një bisht. Ka bishta prapa. 9. fig. keq. Ai që ndjek dikë në mënyrë të verbër, ai që hiqet zvarrë pas dikujt. \* Me bisht keq. që është me të tepërt, që ka diçka më tepër se çdo të kishte zakonisht. Bisht pas bishti pa iu ndarë. Bishti i fshesës shih te FSHES/Ë,~A. Bisht lugati thjeshtligj. shih te LUGAT,~I. Iku me bisht ndër shalë përçm. iku i mundur e i turpëruar. Bën bisht (i bën bisht) i shmanget takimit me dikë a me diçka, bën mënjane ose largohet; i shmanget diçkaje, duke gjetur arsye të kota ose dredhi, dredhon. E drodh i (e përdrodh) bishtin (këmbën) mospërf. shih te DREDH. U lidh pas bishtit të

dikujt keq. shkon e vepron sipas intereseve të dikujt, lidhet ngushtë me dikë e vepron si do ai. Luan (dredh, përdredh, lëviz) bishtin keq. a) nuk mban qëndrim të mirë moral, shkon me disa burra (për femrat); b) mban qëndrim të lëkundur, nuk qëndron besnik. I luan (i tund) bishtin dikujt keq. ndjell pas vetes, përpiket të joshë pas vetes. Mblodhi bishtin përb. shih te MBLEDH. Ngriti bishtin keq. shih te NGRE. Zero me bisht (me xhufkë) keq. ai që nuk di gjë fare; ai që është fare i pazoti për të bërë një punë. E mban bishtin cakërr keq. shih te ÇAKËRR. Dhi e zgjebosur (e zgjebur) e bishtin përpjetë (bishtpërpjetë) tall. shih te ZGJEBOSUR (i, e). Me luge të kon, me bisht të verbosur keq. shih te LUG/Ë, ~A. Kur të këndojë qyqja e kuqe (nga bishti) iron. shih te QYQ/E, ~JA.

**BISHTALEC** m. \* I kanë dalë mendtë mbi bishtaleca keq. nuk është fare në gjendje të gjykojë e të arsyetojë drejt, s'i ka mendtë në kokë (për vajzat e për gratë).

**BISHTDREDHUR** mb. keq. 1. Që është e lëvizshme, që s'ka sjellje të mira morale, e përdalë (për femrat).

**BISHTGJATË** f. 1. euf. Dhëlpër.

**BISHTLËSHUAR** mb. bised. keq. Bishtluajtur.

**BISHTLËVIZUR** mb. bised. keq. Bishtluajtur.

**BISHTLUAJTUR** mb. bised. keq. 1. Që nuk ka qëndrim moral të mirë, bishtdredhur (për femrat).

**BISHTPËRDREDHUR** mb. 2. fig. keq. Bishtdredhur.

**BISHTPËRPJETË** mb. 2. fig. keq. Që mbahet me të madh pa pasur ndonjë vlerë, mendjemadh, fodull.

**BIZANTIN** mb. libr. 2. fig. keq. Që është karakteristik për sjelljen, qëndrimet e veprimet e shtresave të larta e të zyrtarëve në Perandorinë mesjetare të Bizantit; hipokrit, dredharak, dinak; që merret

me hollësi të tepruara e të kota. Sjellje bizantine. Njeri bizantin. Burokraci bizantine. Diskutime bizantine. Dinakëri bizantine.

**BIZGOSUR** mb. 2. fig. keq. Që është lëshuar e shkundur fare, i rënë. Njeri i bizgosur.

**BLEJ** kal. 2. keq. Bëj për vete dikë me anë të ryshfetit, i jap mitë ose dhurata për ta kthyer nga ana ime. E bleu me dhurata. \* Djali pa lerë e djepi (festja) blerë iron.

**BLERË** mb. 2. keq. Që është bërë për vete prej dikujt me anë të parasë a të ryshfetit; që është korruptuar.

**BLOJË** f. \* U vu në blojë *keq.* nisi të flasë pa pushuar, filloi të bluajë si mulli.

**BOHEMË** f. libr. keq. Turmë njerëzish (zakonisht artistësh endacakë) në vendet kapitaliste, që bëjnë jetë të çrregullt e të dhënë pas qejfeve; mënyra e jetesës së këtyre njerëzve.

**BOJATIS** kal. 3. bised., keq. I vë fytyrës shumë të kuq e pudër.

**BOJË** I f. 3. bised. Ngjyra e fytyrës ose pamja e përgjithshme e njeriut, çehre; keq. fytyra.

U nxi me bojë e zuri e keqja, e gjeti e zeza. Ia nxori (ia hoqi, ia qiti) bojën *keq.* e zbuloi se kush është, ia nxori të palarat në shesh, ia zbuloi fytyrën e vërtetë para të gjithëve.

**BONZ** m. 2. libr., keq. Njeri me përgjegjësi, që vepron në kokë të vet, udhëheqës politik i shkëputur nga masat, që drejton vetëm me urdhra.

**BORGJEZ** m. 2. keq. Ai që është dhënë pas fitimit, që lufton vetëm për mirëqenien vetjake dhe që vë interesin e tij mbi interesin e përgjithshëm, ai që ka fituar tiparet e një përfaqësuesi të borgjezisë. Borgjezët e rinj.

**BORGJEZ** mb. 3. keq. Që është karakteristik për borgjezinë ose për borgjezin, që shpreh interesat e klasës së borgjezisë; që përshkohet nga fryma e borgjezisë, që

është karakteristik për mënyrën e jetesës së borgjezisë. Botëkuptim borgjez. Ideologji (pikëpamje) borgjeze. Qëndrim borgjez. Nacionalizëm borgjez. E drejta borgjeze. Sjellje borgjeze. Moral (degjenerim) borgjez. Kulturë borgjeze. Art borgjez. Letërsi borgjez. Intelektual borgjez. Mënyrë borgjeze e jetesës. Humanizëm borgjez. Pacifizëm borgjez.

**BORGJEZOHEM** vetv. 2. keq. Marr tiparet e borgjezit, filloj të jetoj, të mendoj e të veproj si borgjez; bëhem borgjez.

**BORGJEZOJ** kal. keq. I jap tiparet e borgjezit, e bëj të jetojë, të mendojë e të veprojë si borgjez, e bëj borgjez.

**BOSTAN** m. \* Mbolli bostan e i dolën kastravecë iron. shih te MBJELL.

**BOTË** I f. Pret thika në mish të botës. keq. Hanë bukën tonë e bëjnë davanë e botës (rrahin thekrën e botës). 10. euf. Sëmundja e tokës, epilepsia. E kapi bota. \* I biri (burri) i botës përçm. një burrë a një djalë çfarëdo, një burrë a një djalë i panjohur; tjetri, dikush. E bija (gruaja) e botës përçm. një grua a një vajzë çfarëdo, një grua a një vajzë e panjohur; tjetra, dikush. Është jashtë botës keq. s'merr vesh nga bota; sillet ndryshe nga të gjithë e jo ashtu si duhet. Miell nga thesi i botës (i huaj) iron. shih te MIELL, ~I. Pula e botës duket më e majme fj.u. iron. shih te PUL/Ë, ~A.

**BRAMBULLIJ** jok. 2. fig. Bëj zhurmë; keq. flas shumë, llap kot, grij. Brambullin si këmborë e prishur. Mjaft brambullite!

**BRASHNJAR** m. 3. keq. Ai që merr ryshfet; ai që është i dhënë pas plaçkës.

**BRASHNJË** f. 3. keq. Ryshfet për një shërbim, plaçkë e vogël që merret pa të drejtë.

**BREDH** jok. 4. keq. Bëj jetë të shkujdesur e të zbrazët, jepem pas qejfeve; bëj dashuri të përciptë e sa për të kaluar kohën, shkoj pas femrave. Bridhte pas fustaneve. \* Bredh (shkon, shëtit) lule me lule dikush keq. shih te LUL/E, ~JA.

- BREDHACAK** mb. keq. 1. Që bredh shumë, që sillet pa punë lart e poshtë gjithë kohën, endacak.
- BREKË** f. vet. \* Ishte bythë e brekë me dikë thjeshtligj., keq. shih te BYTH/Ë,~A. Me brekë nëpër këmbë (nëpër shalë, zvarrë) thjeshtligj., tall. i mundur, i turpëruar; me frikë të madhe e plot rrëmujë. S'di të mbathë as brekët thjeshtligj., përb. shih te MBATH.
- BRENDA** a) nuk vjen në kundërshtim me një rregull, me një kërkesë të përgjithshme etj.; keq. i përmbahet formalisht diçkaje, përpiket të zbatojë, së paku në dukje, një masë, një rregull, një ligj etj;
- BRESHËR** m. \* Breshri e rreh e hunda me majë iron. shih te HUND/Ë,~A.
- BRESHKË** f. \* I ka hipur breshkës iron.
- BREZ** m. \* Me lugë në brez keq. shih te LUG/Ë,~A. Me shpatë në brez keq. me të keq e me të egër; gati për të goditur. Ka ngjeshur dy breza keq. mendon se është bërë burrë, zot i vetes dhe mund të veprojë pa pyetur njeri, nuk kërkon me këshilla e udhëzime nga askush (thuhet kur një djalë i ri arrin moshën e pjekurisë dhe bëhet mendjemadh e nuk i përfill më prindërit a më të moshuarit).
- BREZHUMBUR** mb. bised. keq.
- BRI** m. \* I fsheh brirët keq. e mbulon veten, nuk del a nuk sulmon haptas. Ç'i këllët brirët përçm. shih te KËLLAS. E nguli bririn përb. shih te NGUL. Nxjerr brirët (brirë) keq. del në shesh, zbulohet, e shfaq veten ashtu siç është; nis të duket, fillon e shfaqet. Shkoi shyta të kërkojë brirët, la edhe veshët fj.u. iron. shih te SHYT/Ë,~A.
- BRINJË** f. \* E mbështeti brinjën euf. shih te MBËSHTET. Na theve brinjët! iron. shih te THYEJ. I theu (i dërrmoi) brinjët (hundët, turinjët, dhëmbët, nofullat) përçm. shih te THYEJ. s'e vë në brinjë mospërf. nuk e merr për grua a për burrë, s'pranon ta ketë në krah si bashkëshort. Ia zbuti brinjët (kurrizin, shpinën) keq. shih te ZBUT. I zbërtheu brinjët keq. shih te ZBËRTHEJ. Në atë brinjë (anë, krah) fli! iron. shih te KRAH,~U.
- BRITANIK** mb. \* Luani britanik edhe iron. simbol për Britaninë e Madhe.
- BRONZ** m. 2. fig. keq. Gjë që nuk vlen shumë a që nuk e çmojnë si duhet, bakër.
- BRYMË** f. \* Rroftë sa kungulli në brymë! iron. rroftë shumë pak, vdektë shpejt!
- BUALL** m. I rëndë (i ngathët) si buall. Shtrihet si bualli në lerë. keq. 2. fig. keq. Burrë me trup të madh e të rëndë, por i ngathët e i trashë nga mendja.
- BUALLICË** f. 2. fig. keq. Grua me trup të madh e të rëndë, por e ngathët dhe e trashë nga mendja.
- BUÇE** f. 3. keq. Gojë. Mbylle buçen!
- BUF** m. 2. fig. keq. Djalë a burrë me flokë të paqethur, të pakrehur e të shpupurishur; burrë i parruar prej shumë ditësh.
- BUF** mb. bised. 3. fig. keq. I plogët e i trashë nga mendja; matuf, i shushatur.
- BUFALAQ** mb. bised. 3. keq. Që i ka flokët të paqethur, të pakrehur e të shpupurishur.
- BUFON** m. 2. keq. Njeri qesharak e pa karakter, palaço.
- BUHAVIT** kal. bised. 2. fig. keq. Mërzit së tepërmi, fryj. Na buhaviti me fjalë.
- BUHAVITEM** vetv. bised. 2. fig. keq. Mërzitem së tepërmi, fryhem nga diçka e padëshirueshme. U buhavita nga fjalët.
- BUJË** f. 2. keq. Zhurmë e madhe dhe e fryrë, që bëhet rreth një njeriu, një veprë, një çështjeje, një ngjarjeje, etj., për t'ia rritur vlerën dhe për ta bërë të njohur gjithandej; zhurmë për t'u dukur. Pa bujë. Punë (prirje) për bujë. I jep bujë. U bë bujë. \* E bëri bujë e zmadhoi a e fryu një gjë, bëri zhurmë rreth diçkaje, e paraqiti diçka si tepër shqetësuese e të ngutshme. Me kujë e me bujë shih te KUJ/Ë,~A. Me pohe e me bujë keq. me zhurmë e me shkëlqim të madh për t'u dukur dhe për të bërë përshtypje te të tjerët.

- BUJËMADH** mb. 2. keq. Që bën zhurmë rreth vetes ose rreth veprimeve të tij për t'u dukur e për të bërë përshtypje tek të tjerët, zhurmëmadh.
- BUJSHËM** mb. 2. keq. Që bëhet me bujë e me zhurmë të madhe sa për t'u dukur; që shoqërohet me bujë e me zhurmë për të bërë përshtypje tek të tjerët ose për të mashtruar të tjerët.
- BUKË** f. \* Buka e një mielli keq. të njëllojtë, nga një brumë (për njerëz me mendim e sjellje të njëjta etj.). Ia ha bukën gomari mospërf. shih te GOMAR, ~I. Kalli pa bukë. keq. njeri i mirë në dukje, po i cekët a i zbrazët. Kthej bukë shih te KTHEJ. Na e la bukën mospërf. vdiq. Iu bë buka drokth shih te DROKTH, ~I. a) keq. meriton dënimin më të rëndë.
- BUKËHARAM** m. keq. Ai që nuk rron me djersën e vet; ai që nuk punon dhe e ha bukën kot; si mallk. ai që e pastë bukën haram.
- BUKUR** f. 2. vet. euf. Grykët.
- BUKUR** mb. 5. bised., iron. I keq, i pakëndshëm, i shëmtuar, i padobishëm, i pavlefshëm (përdoret para ose pas një emri, me kuptim të kundërt nga ai që ka zakonisht kjo fjalë). Të bukur punë që paska bërë! Të bukur fjalë që paska thënë! Të bukur shok që paska! Të bukur lojë që bënë! Për sytë e bukur të dikujt iron. shih te SY, ~RI. Lëpjetë e bukur bot. shih te LËPJET/Ë, ~A. Zonjë e bukur bot. shih te ZONJ/Ë, ~A.
- BUKUR** ndajf. 3. bised., iron. Shumë keq, jo ashtu si duhet (përdoret me kuptim të kundërt nga ai që ka zakonisht kjo fjalë). Bukur, besa!
- BUKURI** f. 4. bised., iron. E keqja më e madhe (përdoret me kuptim të kundërt nga ai që ka zakonisht kjo fjalë). Bukuria ishte se ...
- BUKUROSH** mb. 2. iron. Që nuk vlen për asgjë, i zbrazët; i pakëndshëm, i papëlqyeshëm.
- BULEVARD** m. 1. Bredh bulevardeve. keq. bredh rrugëve. 2. keq. Diçka që u përshtatet shijeve të këqija mikroborgjeze e borgjeze; diçka e përciptë, e ulët e pa vlerë (përdoret si përcaktues pranë një emri tjetër). Gazetë bulevardi. Letërsi bulevardi. Shoqëri bulevardesh.
- BULMET** m. \* Bulmet hudhrash iron. shih te HUDH/ËR, ~RA. Ai stan atë bulmet ka mospërf. shih te STAN, ~I.
- BULLAR** m. 2. fig. keq. Djalë a burrë trashalug ose i ngathët.
- BULLARE** f. sh keq. Vajzë a grua trashaluqe dhe e ngathët.
- BULLËNDËR** f. 3. fig. keq. Llum, fundërr.
- BURNOT** m. 2. përd. mb. fig. keq. Që s'ka asnjë vlerë, që nuk shërben për asgjë; që s'di asgjë, i pazhvilluar nga mendja. Ishte burnot fare.
- BURRACAK** mb. keq. 1. Që s'ka guxim, që ka shumë frikë e s'e fsheh dot këtë, frikacak; që shpreh frikë.
- BURRË** m. \* Burri (i biri) i botës përçm. shih te BOT/Ë, ~A. Burri i nënës keq. shih te NËN/Ë, ~A. Ta vë babën burrë keq.
- BUTË** mb. \* Ia bëri kurrizin (shpinën) më të butë se barkun keq. shih te KURRIZ, ~I.
- BUZEL** mb. 1. keq. shih BUZAÇ, ~E.
- BUZË** f. \* Fshiji buzët (mustaqet) për murrizi (pas murrizit) iron. bëhesh gati kot, se gjë s'ke për të ngrënë a për të marrë.
- BUZËBARDHË** mb. \* Sa gomarë buzëbardhë ka! iron. s'është po ajo gjë, s'është ai ose s'është e atij që mendon ti, ka edhe të tjerë si ky.
- BUZËLIDHUR** m. euf. I vdekuri.
- BUZËPËRDREDHUR** mb. keq. Që bën naze, që përdredh buzët për çdo gjë, buzëhollë.
- BUZËQESHJE** f. \* Shkëmbyen buzëqeshje keq. shih te SHKËMBEJ.
- BUZO** m. 1. keq. Ai që i ka buzët të trasha, të varura e të shëmtuara.
- BUZOÇ** mb. keq. Buzaç.

- BYK** m. 3. fig. keq. Njeri a send që nuk ka asnjë vlerë dhe që s' hyn në punë; mbeturinë e padobishme. Kashtë e byk. Është byk.
- BYTHË** f. bised. \* Bytha e kuisë! shar. shih te KUSI,~A. Me bythë përpjetë shih te PËRPJETË. Ishte bythë e brekë me dikë thjeshtligj., keq. ishte tepër i afërt me dikë, ishte i lidhur shumë ngushtë me të. S'i zë bytha vend thjeshtligj., keq. shih te VEND,~I.
- BYZYLYK** m. 3. vet. thjeshtligj., iron. shih PRANGA,~T.
- CAK** m. \* E zuri në cak *keq.* e zuri duke kryer një vepër të keqe, e zuri me preshe në duar.
- CAKËRR** ndajf. bised. \* E mban bishtin cakërr *keq.* mbahet me të madh, kapardiset (zakonisht për femrat).
- CINXËR** m. 3. fig. iron. Ai që flet pa pushim dhe kot.
- CIPË** f. \* I ka plasur cipa (peta) e ballit keq. është bërë i pacipë, s'ka turp fare.
- CJAPOS** kal. keq. E dobësoj dhe e shëmtoj dikë.
- CJAPOSEM** vetv. keq. Dobësohem e shëmtohem.
- CJAPOSUR** mb. keq. I dobësuar e i shëmtuar.
- COPAMADH** m. keq. Pjesëtar i familjes që lakmon të marrë më shumë se të tjerët për të ngrënë dhe që nuk bën ndonjë punë në shtëpi, ai që kërkon pjesën më të madhe për vete; ai që kërkon më shumë nga sa i takon.
- CUCËRROSH** m. krahin., keq. Ai që hiqet si i druajtur, si i turpshëm.
- CUCËRROSHE** f. krahin., keq. Fem. e CUCËRROSH,~I.
- CYTANIK** mb. keq. Që ngacmon shumë të tjerët, ngacmues, ngacmimtar.
- Ç'** përem. \* Ç'që ata? vjet. shih tek ATA II. Ç'që ata! vjet., iron. shih tek ATA II. Që ç'ke me të shih te KAM. S'kishte ç't' i hante miu pas darke shih te MI,~U.
- ÇAKALL** m. sh 2. fig. keq. Njeri gjakpirës e i pangopur; ai që ulërin duke kërcënuar të tjerët. Çakejtë gjakpirës. Çakejtë imperialistë. Kope çakejsh. Britma çakejsh. Çakej të një strofke.
- ÇAKALLE** f. 2. fig. keq. Njeri që flet shumë e pa pushuar, llafazan. Çakalle e prishur. Çakalle mulliri.
- ÇALAMAN** mb. keq.
- ÇALASH** mb. keq. shih ÇALAMAN,~E 1,3.
- ÇALOK** mb. keq. shih ÇALAMAN,~E. Plak çalok. U mblodhën ca çalokë.
- ÇANAK** m. \* Lëpin çanakët (sahanët) e dikujt. keq. shih te LËPIJ. Ra në çanakun e dikujt. keq. b) u bashkua me interesat e pikëpamjet e dikujt, u bë shok i dikujt. Ha në një çanak me dikë. keq. ka të njëjtat pikëpamje e interesa me dikë, është i afërt më dikë e vepron si bashku me të. Mbeti jashtë çanakut keq. humbi mundësinë për të përfituar nga diçka që bëhej së bashku në kurriz të të tjerëve ose me mënyra të pa rregullta, mbeti pa pjesë. Janë të një çanaku keq. Kanë të njëjtat interesa e qëllime; veprojnë së bashku në kurriz të të tjerëve ose me mënyra të parregullta.
- ÇANAKLËPIRËS** m. keq. Sahanlëpirës. Çanaklëpirësit e pushtuesve.
- ÇAPAÇUL** mb. bised. keq. 1. Që është i çrregullt dhe s'është i zoti për asgjë; që nuk ka asnjë vlerë, që nuk e përfillin. Njeri çapaçul. Grua çapaçule.
- ÇARË** mb. \* Daulle e çarë keq. diçka pa vlerë, diçka që nuk hyn me në punë.
- ÇEÇO** m. bised. 2. keq. Njeri pak i lënë nga mendtë. Flet si çeço. Është bërë çeço fare.
- ÇEL** kal. \* Çel (nxjerr) zogj iron. shih te ZOG,~U. Çel (hap) e s'mbyll keq. nuk

- pushon së foluri, është llafazan i madh. Është nga ata (nga ato) që çelin njëqind (dyzet) dyer në ditë keq. rri tërë ditën duke vajtur te njëri e tek tjetri.
- ÇELËS** m. Ka (mban) çelësat (hapëset) e kashtës iron. shih te KASHT/Ë,~A.
- ÇENGEL** m. \* Ka hedhur çengelat dikush a diçka keq. shih te HEDH.
- ÇENGI** f. 2. keq. Grua bishtdredhur; grua e përdalë.
- ÇERDHE** f. 3. fig. Vendi ku rriten dhe edukohen njerëzit për një veprimtari të caktuar; keq. vend, zakonisht i fshehur e i mbrojtur, ku përgatitet për një veprimtari një grup njerëzish. Çerdhe e gjallë (e zjarrtë). Çerdhe revolucionarësh. Çerdhe lirie. Çerdhe e luftës partizane. Çerdhe hajdutësh (kusarësh, diversantësh). Çerdhe spiunazhi. Çerdhe e reaksionit.
- ÇESHIT** m. vjet. 3. keq. Mostër, lloj. Çeshite të shëmtuara.
- ÇETELE** f. vjet. \* E vë në çetele e mbaj shënim, e shënoj për të mos e harruar a për ta mbajtur parasysh. Janë puthitur çetelja me çetelen keq. janë bashkuar dy njerëz të njëjtë, janë si njëri tjetri, ka gjetur tenxherja kapakun.
- ÇIBAN** m. \* Lëpijnë çibanët (plagët) e njërit tjetrit keq. shih te LËPIJ.
- ÇIBUKÇI** m. vjet. 3. fig. keq. Ai që është vënë në shërbim të dikujt; shërbëtor. Çibukçinjtë e pushtuesve.
- ÇIFLIGAR** m. 2. keq. Ai që shfrytëzon dhe merr nëpër këmbë të drejtat e të tjerëve, ai që sillet me egërsi e me përbuzje ndaj njerëzve të thjeshtë, ashtu si përfaqësuesit e klasës feudale. Çifligar i ri.
- ÇIFLIGAR** mb. 2. keq. Që është karakteristik për çifligarët, që shpreh interesat e klasës së çifligarëve; që është veti e çifligarëve dhe e mënyrës së jetesës së tyre, të mbështetur në shfrytëzimin dhe në përbuzjen e popullit të thjeshtë. Botëkuptim çifligar. Qëndrim çifligar. Sjellje çifligare.
- ÇIFUT** m. 2. fig. bised., keq. Njeri shumë dorështrënguar dhe që në çdo gjë shikon përfitimin e vet.
- ÇILIMILLËK** m. bised. 2. keq. Sjellje ose veprim i një njeriu të papjekur; punë çiliminjsh, kalamallëk. Bën çilimillëqe.
- ÇINOJ** kal. 2. keq. Përqesh dikë, duke përsëritur lëvizjet, fjalët e veprimet e tij.
- ÇIRAK** I m. \* E bëri (e qiti, e nxori) çirak dikë edhe iron. e ndihmoi shumë dikë, i bëri një shërbim të madh, e nxori në dritë. Doli çirak edhe iron. i kaloi vështirësitë që kishte pasur, doli në dritë.
- ÇIZME** f. kryes. \* I lëpin (i puth) çizmet (këmbë) dikujt keq. shih te LËPIJ.
- ÇJERR** kal. 6. euf. Tredh. Çjerr cjamin (dashin, mëzatin). Çjerr kalin.
- ÇJERRË** mb. 4. euf. I tredhur. Cjap (dash, mëzat, ka) i çjerrë. Kalë i çjerrë.
- ÇOJ** I kal. \* E çoi (e dërgoi) në djall (në dreq) dikë a diçka thjeshtligj., keq. shih te DJALL,~I. E çofshin me katër veta! mallk. vdektë! Mos e çoftë kryet (kokën) shëndoshë! mallk. vdektë!
- ÇOPARKA** f. vet. \* I ngriti (i mblodhi, i mori) çoparkat iron. e braktisi një vend, u largua menjëherë, ua mbathi këmbëve.
- ÇORBË** f. 3. fig. keq. Diçka e përzier në mënyrë të parregullt e pa shije, diçka e ngatërruar dhe e paqartë; rrëmuje e madhe, pështjellim. Çorbë citatesh. Çorbë dialektesh.
- ÇUÇURIMË** f. 2. vet. keq. Fjalë që thuhet vesh më vesh, thashetheme. Dëgjon çuçurimat e të tjerëve.
- ÇUDIT** kal. 2. Ç'na çudite! iron. nuk na the asgjë të veçantë!
- ÇULL** m. 3. keq. Mbulesë ose rrobë shumë e papastër. U bë çarçafi çull.

- DAL** jokal. \* I doli boja keq. shih te BOJ/Ë,~A I. Doli çirak edhe iron. shih te ÇIRAK,~U I. S'i kanë dalë (ende, akoma) dhëmbët mospërf. shih te DHËMB,~I. Dal jashtë euf. shih te JASHTË. I dalshin sytë! mallk. u verboftë, i plaçin sytë! I dalshin trutë! mallk. shih tek TRU,~RI. Sapo ka dalë nga shpërgënjtë mospërf. shih te SHPARG/ËR,~RI. I daltë hithra në vatër! mallk. shih te HITH/ËR,~RA. Doli me këpucë të kuqe dikush iron. shih te KUQ (i), ~E (e). Doli mendje mbi mendje tall. shih te MENDJ/E,~A. S'del dhjamë nga pleshti fj. u. përçm. shih te DHJAM/Ë, ~I. Del si mëzi para pelës tall. shih te MËZ,~I. Këtej i hyri, këtej i doli mospërf. shih te HYJ. I hyn në një vesh e i del nga tjetri (nga një vesh i hyn, aga tjetri i del) mospërf. shih te HYJ. S'i ka dalë (s'i ka djersitur) ende (mirë) mustaqja shih te DJERSIT. s'ka dalë ende nga lëvozhga e vezës (nga veza) mospërf. shih te VEZ/Ë,~A. E kthen barkon nga del dielli përçm. shih te KTHEJ. Hyr e dil e tund peshqirin mospërf. shih te HYJ. Hyri mish e doli peshk mospërf. shih te MISH,~I. Mbolli bostan e i dolën kastraveca iron. shih te MBJELL. I kanë dalë mendtë mbi bishtaleca keq. shih te BISHTALEC,~I. Lëshon hije pa dalë dielli mospërf. shih te HIJ/E,~A. Shkoi (vajti) për lesh e doli (u kthye, erdhi) i qethur fj. u. iron. shih te LESH,~I.
- DALLKAUK** m. bised. keq. 1. Njeri lajkatar, që mundohet të nxjerrë përfitime për vete, duke u bërë qejfin atyre që kanë fuqi e pushtet; njeri i pabesë, që të shet e të blen për përfitime vetjake; njeri me dy faqe, hipokrit. Mbreti me dallkawkët e tij. Ishte dallkawk. Iu mblodhën dallkawkët.
- DALLKAUKLLËK** m. bised. keq. Qëndrim, veprim a sjellje prej dallkawku. Bënin dallkawkllëqe.
- DAMAR** m. \* I ka plasur damari (delli) i ballit (i marres) keq. nuk ka më turp nga asgjë, është bërë i paturpshëm, i ka plasur cipa.
- DARDHË** f. b) edhe iron. kush rri pranë një njeriu që ka pushtet, pasuri, dituri etj. përfiton më tepër prej tij nga ata që janë larg.
- DASMË** f. \* I bënë dasmën dikujt iron. e vranë.
- DASHUR** f. 3. keq. Dashnore. E ka të dashur. Doli me të dashurën.
- DASHUR** m. 4. keq. Dashnor. U takua (doli) me të dashurin.
- DASHURI** f. 4. zakon. keq. Lakmi. Dashuria për lavdi (për para).
- DASHUROHEM** vetv. \* Është dashuruar me vetveten keq. i pëlqen tepër vetja, është bërë egoist.
- DAULLE** f. \* Daulle e shpuar keq. shih te SHPUAR (i, e). Daulle e çarë keq. shih te ÇARË (i, e). E bëri daulle dikë përçm. e la të vdekur në vend. I bie daulles së dikujt keq. bëhet tellall i dikujt, flet ashtu siç e udhëzon ai, i shkon pas avazit. Është (fare) daulle dikush mospërf. s'di gjë fare, e ka kokën fare bosh. Mori rrethin e daulles iron. shih te RRETH,~I. Kërcen (hedh këmbët, luan këmbët, hedh vallen) siç bie daullja (sipas daulles, siç bie lodra) keq. bën ashtu siç i thonë të tjerët, s'ka mendim e qëndrim të vetin, shkon pas avazit të të tjerëve. Ku leh qen e ku del tym, ku bën daullja bum iron. shih te QEN,~I.
- DEFORMOJ** kal., libr. 2. fig. keq. E shtrembëroj qëllimisht diçka (realitetin, një fakt etj.); mundohem ta paraqit diçka jo ashtu siç është, por ashtu siç me intereson; shtrembëroj. Deformon faktet. Deformon thelbin e çështjes. Deformon të dhënat.
- DEFTER** m. \* Defter bakalli keq. shih te BAKALL,~I.
- DEGË** f. \* Tund degën e ullirit iron. shih tek ULLI,~RI.
- DEHEM** vetv. \* Dehet pa pirë iron. e humbet mendjen, turbullohet shpejt, pa ndonjë arsye të rëndësishme, pa shkak; është

- tepër mendjelehtë e i papërmbajtur. Dehet me një iron. gëzohet e entuziazmohet kot, dehet pa pirë. Tjetri pi, ai dehet shih te PI.
- DELIKAT** mb. 4. fig. Që preket lehtë në ndjenja, shumë i ndjeshëm; i hollë. Shpirt delikat. Zemër delikate. Është bërë shumë delikat. Sa delikat që je! iron.
- DELL** m. \* I ka plasur delli (damari) i ballit (i marres) keq. shih te DAMAR,~I. Këputtë dellin e qafës! mallk. vdektë!
- DEND** kal. 4. fig. bised., keq. I bëj dikujt shumë premtime, që nuk i plotësoj, i them fjalë të tepërta etj.; ngop. Na dendi me fjalë (me gjepura).
- DERË** f. \* Gëzim për derë iron. diçka që më ndodh mua sot, mund të të ndodhë edhe ty nesër. T'u haptë dera! shak. shih te HAPEM. I mbiu në derë keq. shih te MBIN. Tund (luan) derën mospërf. nuk bën asnjë punë, rri fare pa punë; merret me gjëra të kota, bën sikur punon. Dera e vogël euf. nevojtorja. I mbiftë ferra në derë! mallk. shih te FERR/Ë,~A. Po troket në derën tënde iron. për ty po flasin, për ty është fjala (i thuhet dikujt që bën sikur nuk merr vesh që po flitet për të). Është më afër dera se qilari fj. u. thuhet me ironi kur dikush sheh me parë interesin vetjak a të rrethit të tij të ngushtë, pastaj atë të përgjithshmin. Dy Kamberë në një derë vjet. dy të mira ose dy të këqija në të njëjtën kohë a në të njëjtin vend; mospërf. dy a më shumë njerëz të pazotë në një vend. E pafsha në (nëpër) dyert e botës (dyerve të botës)! mallk. e pafsha duke lypur!
- DERGJEM** vetv. 2. edhe keq. Rri shtrirë e pa lëvizur në një vend për një kohë të gjatë; rri pa bërë asnjë punë; rri kot.
- DERR** m. 3. fig. bised. keq. Njeri shumë i trashë dhe i majmur; njeri që nuk e mban veten pastër; njeri i trashë nga mendja e kokëfortë; njeri i ndyrë e i keq, maskara. \* Derr në thes keq. shih te THES,~I. Stallë (thark) derrash keq. dhomë, sallë etj. e fëlliqur, e mbajtur shumë keq. Hyn derri e dosa keq. hyn e del gjithkush si në një shtëpi pa zot, është han me shtatë porta. Ku di derri këmborë mospërf. thuhet për dikë që nuk merr vesh nga një punë a nuk kupton dot përse bëhet fjalë ose për dikë që nuk di të vlerësojë diçka të mirë; ku di dhia ç'është tagjia. Vath i florinjte në vesh të derrit shih te FLORINJTË (i, e).
- DERRE** f. bised. 2. keq. Grua a vajzë kokëfortë.
- DESPOT** m. 2. fig. libr., keq. Tiran. Ishte despot në familje.
- DESPOTIZËM** m. 3. fig. libr., keq. Sjellje e qëndrim prej despoti, tirani.
- DESHIFROJ** kal. 3. bised. Arrij të kuptoj diçka të shkruar me një shkrim shumë të keq a të palexueshëm; lexoj një shkrim të keq. Mezi e deshifroi recetën (letrën).
- DET** m. \* Kur të bëhet deti kos iron. shih te KOS,~I. Është si tapa në shpinë të detit keq. shih tek TAP/Ë,~A. Ngre kodra përmbi det iron. shih te KOD/ËR,~RA. Peshku në det, tigani në zjarr fj. u. iron. shih te PESHK,~U.
- DËBUAR** mb. \* Rri si qen i dëbuar keq. rri mënjanë, me frikë e i shtruar, rri me bisht ndër shale, si qen i rrahur.
- DËFRIM** m. 2. Gjithçka që bëhet për të dëfryer, ajo që na dëfren; argëtim, qejf. Dëfrime të organizuara (të kulturuara). E kalon kohën me dëfrime. Është dhënë pas dëfrimeve. keq.
- DËGJOHEM** vetv. \* Dëgjohej nëpër botë keq. merret nëpër gojë, flasin e përflasin për dikë. I dëgjohej fjala dikujt ia pranojnë mendimin, porosinë etj., ka ndikim tek të tjerët, i shkon fjala, i zë vend fjala. Dëgjohej vetëm kambana e tij keq. shih te KAMBAN/Ë,~A.
- DËLIR** kal. 5. euf. Tredh. E dëliri thiun.
- DËLIREM** vetv. 2. euf. Lirohet nga barra, lind (gruaja); pjell (kafsha). U dëlir gruaja. U dëlir lopa. 4. fig. krahin., keq. Shporrem, qërohem; largohem. Dëliru prej këtej!



- DËLIRË** mb. 2. euf. Që është liruar nga barra (për një grua lehone).
- DËNGLAMADH** mb. bised. keq. Që thotë dëngla, që shet shumë dëngla, që flet gjepura.
- DËR-DËR** onomat. bised. keq. Përdoret për të qortuar dikë që të mërzit duke dërdël-litur ose për të shfaqur mospërfillje për atë që flet. Mbeti dër-dër tërë ditën! Ne i themi të pushojë, ai dër-dër! Mos bëj dër-dër!
- DËRGOJ** kal. \* E dërgoi (e çoi) në djall (në drej) dikë a diçka thjeshtligj., keq. shih te DJALL, ~I.
- DËRRASË** f. 6. përd. mb. fig. bised., keq. I trashë nga mendja, budalla; që s' di gjë fare. Është fare dërrasë. Ishte dërrasë në aritmetikë.
- DËRRMOHEM** vetv. U dërrmua te gurët. U dërrmua në krah. U dërrmua keq. I janë dërrmuar këmbët (gishtat).
- DËSHTAK** mb. 3. keq. I dobët nga trupi, ligaç (zakonisht për fëmijët). Fëmijë dështak.
- DIELL** m. \* Me këmbë nga dielli mospërf. shih te KËMB/Ë, ~A. Jemi ngrohur nga (nën) një diell iron. shih te NGROHEM. Prapa diellit të vejë! mallk. mos ia pafsha sytë!, në djall të vejë! Matet me diellin (me hijen) e mëngjesit (e mbrëmjes) keq. shih te MËNGJES, ~I. I ktheu potkonjtë (thundrat, këpucët, këmbët) nga dielli përb. ngordhi; vdiq. Mos paftë diell me sy! mallk. Iu shoftë hija e diellit! mallk. shih te SHUHEM. I tregoi se nga lind dielli iron. shih te LIND. Ia tregoi potkonjtë (këpucët) diellit (qiellit) përb. ngordhi; vdiq. Tund këmbët në diell mospërf. rri kot; nuk punon, theket në diell, shullëhet. E kthen barkun nga del dielli përçm. shih te KTHEJ. Lëshon hije pa dalë dielli mospërf. shih te HIJ/E, ~A.
- DIKASTERIAL** mb. 2. keq. Që lidhet vetëm me një dikaster, që sheh vetëm interesat e dikasterit të vet. shumë i ngushtë, i njëanshëm; burokratik. Interesa dikasteriale. Fry me (prirje) dikasteriale. E sheh me syrin dikasterial.
- DILETANT** m. 2. keq. Ai që merret me veprimtari në fushën e shkencës, të artit, të teknikës etj. pa pasur përgatitjen e veçantë që nevojitet, pa pasur njohuri të plota e të thella. Punë diletanti. Ra në duar diletanti. Është diletant në matematikë (në gjuhësi, në filozofi, në politikë).
- DILETANTIZËM** m. libr. keq. Punë a veprimtari prej diletanti në fushën e shkencës, të artit, të teknikës etj.; punë e cekët, e përciptë. Diletantizëm i theksuar. Ra në diletantizëm. E kapërcyen diletantizmin.
- DIMËR** m. \* Na rrofsh për dimër, se për verë jemi vetë thjeshtligj., iron. i thuhet diku për t'i treguar se ia kemi nevojën në kushte të vështira dhe jo atëherë kur nuk na duhet.
- DITË** f. \* S'i ka bërë ende ditët edhe mospërf. është ende i vogël e pa përvojë, s' është bërë ende për diçka. Kur të bëhen dy ditë bashkë iron. asnjëherë, kurrë.
- DJALË** m. \* Djalë (vajzë) tigani mospërf. shih te TIGAN, ~I. E do si djalin e shemrës iron. shih te SHEM/ËR, ~RA. Djali pa lerë e djepi (festja) blerë iron. shih Peshku në det, tigani në zjarr te PESHK, ~U. Djemtë (fëmijët) hanë kumbulla (thana), pleqve u mpihen dhëmbët iron. shih te MPIHEM.
- DJALL** m. 2. fig. thjeshtligj., keq. Njeri dinak, shpirtkeq e smirëzi; njeri i prapë, i prirur për prapësina; drej. Është djall. S'të ndihmon ai djall. \* Në djall të vejë (të shkojë)! mallk. Prapa diellit vaftë! mos ia pafsha sytë! Dredha e djallit keq. njeri shumë i djallëzuar; djalli vetë.
- DJALLUSH** m. 2. bised., keq. Djalë (zakonisht i mitur) shumë i prapë, ngatërrestar e smirëzi; mistrec.
- DJALLUSH** mb. bised, 1. keq. Shumë i keq, ngatërrestar e smirëzi (zakonisht për njerëz që janë në moshë të re).

- DJALLUSHË** f. bised. 1. keq. Vajzë a grua shumë e prapë, ngatërrestare e smirëzezë, djalle; mistrece.
- DJEG** kal. \* I digjnin veshët shih te VESH,~I. Edhe i ha, edhe i djeg thjeshtligj., iron. shih te HA.
- DJEP** m. \* Djali pa lerë e djepi (festja) blerë iron. shih Peshku në det, tigani në zjarr te PESHK,~U. Djepi plot e këmbët jashtë iron. është i rritur, por flet a sillet si i vogël.
- DOÇ** m. sh thjeshtligj. edhe keq. shar.
- DOÇE** I f. \* E qiti në doçe e nxori pa gjë, e nxori pa pjesë, e la me gisht në gojë. Ka gjetur shkopi doçen keq. shih te SHKOP,~I.
- DONKISHOT** m. libr., keq. Njeri i shkëputur nga jeta e gjallë, i cili rron me ëndrra, lufton më kot për ideale e qëllime të paarritshme sa bëhet qesharak e për të ardhur keq (sipas emrit të Don Kishotit, heroit të romanit të njohur të shkrimtarit spanjoll M. Servantes).
- DONZHUAN** m. libr., keq. Burrë ose djalë i dhënë pas aventurave të dashurisë dhe pas qejfeve; ai që u vjen rrotull grave dhe që përpiket t'u pëlqejë atyre, t'i mashtrojë e t'i shtjerë në dorë me çdo mënyrë (sipas emrit të Don Zhuanit, heroit legjendar të disa veprave letrare spanjolle etj.).
- DORË** f. \* Nën dorë keq. fshehurazi dhe jo sipas rregullave të zakonshme të tregtisë (për shitjen e blerjen e diçkaje). Fërkon duart (barkun) keq. shih te FËRKOJ. Fut duart diku keq. shih te FUT. I holloi duart (së fërkuari) iron. shih te HOLLOJ. Ka dorë keq. Ia leu dorën (duart) diku keq. shih te LYEJ. Të puth dorën! iron., tall. shih te PUTH. I puth dorën (pëqirin, gjunjët, këmbët, këmbë e dorë) diku keq. shih te PUTH. I shkurtoi (i preu, i thau) duart (dorën, krahët). b) keq. e ngacmon dikë; e rreh; c) keq. merr diçka që s'është e tij, vjedh; e prek; e trazon. I ka futur duart deri në bërryl keq. shih te BËRRYL,~I. Ia dha këpucët (opingat) në dorë mospërf. shih te KËPUC/Ë,~A. Ia dha lecat në dorë diku mospërf. shih te LECK/Ë,~A. E ka dorën të gjatë (i ka duart të gjata) keq. shih te GJATË (i, e). Sikur ka kapur (ka zënë, ka rrokur) qiellin me dorë iron. shih te QIELL, ~I. Kërkoftë murin me dorë! mallk. shih te MUR,~I. I shpëlau duart nga kazma (nga lopata, nga çekani, nga bishti i lopatës) iron. shih te SHPËLAJ. Ia merr pula bukën nga dora mospërf. shih te BUK/Ë,~A. Ka (kërkon të ketë) një dorë në bakllava dhe tjetrën në revani (në mjaltë, në kabuni) keq. ka gjithë të mirat, s'heq dorë nga asnjë e mirë a kënaqësi.
- DOSË** I f. 3. fig. keq. Grua shumë kokëfortë. \* Si tym dose me të shpejtë, s'u duk nga vajti. Hyn derri e dosa keq. shih te DERR,~I.
- DRAGOMAN** m. vjet., edhe keq. Përkthyes që zakonisht bënte përkthime me gojë. Shërbente si dragoman.
- DRAPËR** m. \* I drejtë si drapri iron.
- DREDH** kal. \* Dredh (përdredh, luan, lëviz) bishtin keq. shih te BISHT,~I. E dredh gjuhën
- DREDHARAK** mb. 2. fig. keq. Që u shmanget me dredhi përgjigjeve e qëndrimeve të drejtpërdrejta e të çiltra, që i bën dredha fjalës ose që i bën bisht përgjegjesisë; që thuhet a që bëhet me dredhi, që ka dredhi a dinakëri; dinak. Njeri dredharak. Sjellje dredharake. Qëndrim dredharak. Politikë dredharake. Fjalë (përgjigje) dredharake.
- DREDHË** f. \* Dredha e djallit keq. shih te DJALL,~I. I bën dredha (plumbit) ruhet që të mos e zërë plumbi, i shmanget plumbit. I hoqi një dredhë shih te HEQ. Është si dredhë ka trup të hollë e të dobët. I bën dredha fjalës nuk i qëndron fjalës së dhënë, por sillet e flet si t'ia dojë puna; nuk e mban fjalën, e ha fjalën. I bën dredha punës (përgjegjesisë) i shmanget,

- i bën bisht. I bën dredha pyetjes nuk i përgjigjet pyetjes drejt e në mënyrë të çiltër.
- DREGËZAMADH** mb. keq. 1. Që ka shumë dregëza, që është plot me dregëza, dregaman.
- DREJTË** mb. \* I drejtë si drapri iron. shih te DRAP/ËR,~RI.
- DREQ** m. 2. fig. thjeshtligj., keq. Njeri dinak, shpirtkeq e smirëzi; njeri i prapë, i prirur për prapësira; djall. S'bëhet punë me atë dreq. Ngatërroi tërë botën, dreqi. \* E dërgoi (e çoi) në dreq (në djall) dikë a diçka thjeshtligj., keq. shih te DJALL,~I.
- DRIDHEM** vetv. Ia drodhën telat e zemrës edhe iron. shih tek TEL,~I. I dridhet (i rrëshqet, i shket, i luan, i lëviz) toka (trualli) nën këmbë
- DRU** m. 5. shih DRU,~JA 1,2. Luajti (valoi) druri u rrahën keq.
- DUA** kal. E do si prushin (si zjarrin) në gji (si kripën në sy). iron. nuk e do fare. \* I do në gojë keq. shih te GOJ/Ë,~A. E do si djaln e shemrës iron. shih te SHEM/ËR,~RA. E do si kau kashtën iron. shih te KA,~U. E do si kripën në sy dikë iron. shih te KRIP/Ë,~A.
- DUKEM** vetv. 8. keq. Përpiqem të dal mbi të tjerët, bëj çmos që të bie në sy a të dallohem për çdo gjë. Kërkon (i pëlqen) të duket. Nuk punon për t'u dukur. S'e bëri për t'u dukur. \* I duket hunda dyfek keq. shih te DYFEK,~U. Pula e botës duket më e majme iron. fj. u. shih te PUL/Ë,~A.
- DY** num. them. \* Kur të bëhen dy ditë bashkë iron. shih te DIT/Ë,~A. Kërkon të hajë me dy lugë keq. shih te LUG/Ë,~A. (Një) copë mish me dy sy përçm. shih te MISH,~I.
- DYFEK** m. vjet. \* Dyfek i palosur mospërf. shih te PALOSUR (i, e). I duket hunda dyfek keq. i duket vetja trim; është mendjemadh. Plasi Muçoja për dyfek tall.
- thuhet për dikë që ka dëshirë a ambicie të madhe për t'u ngritur në pozitë e për të komanduar etj. Qan dyfeku për zot iron. b) përdoret kur armën e mban dikush që është frikacak. I rrihte dyfeku lart dikujt keq. e mbante veten më të madh.
- DYLBI** f. \* I sheh me dylbi (gjërat) dikush i sheh punët nga larg, nuk i njeh mirë çështjet me të cilat merret a për të cilat flet, nuk është brenda e nuk e njeh thelbin e çështjeve. Ta shikosh me dylbi! iron. shih te SHIKOJ.
- DHE** m. sh 9. euf. Gjarpri, tokësi, dhetokësi. I zuri dheu lopën. E bëri dheun (sheshin, fushën) breg mospërf. shih te BREG,~U. Bën hije mbi dhe keq. shih te HIJ/E,~A.
- DHEN** vet. Si dhia në mes të dhenve keq. shih te DHI,~A.
- DHËMB** m. \* Me thikë ndër dhëmbë keq. duke kërcënuar, me kërcënim. I theu (i dërrmoi) dhëmbët (hundët, brinjët, turinjët, nofullat) dikujt përçm. shih te THYEJ. Zbardh (hap, zbuloj) dhëmbët keq. shih te ZBARDH. Mbeti (rri) me dhëmbë jashtë keq. shih te JASHTË. Djemtë (fëmijët) hanë kumbulla (thana), pleqve u mpihen dhëmbët iron. shih te MPIHEM.
- DHËNË** mb. 9. Që e do shumë dikë a diçka, që përpiqet me mish e me shpirt për dikë a për diçka; që është kushtuar një gjëje, që ka dëshirë të zjarrtë të merret me një gjë; keq. që e ka lëshuar veten pas diçkaje, që e ka rrëmbyer diçka, që i është bërë ves diçka. I dhënë pas nënës (pas fëmijëve). I dhënë pas punës (pas librave, pas muzikës, pas sportit). I dhënë pas pijes (pas lojës, pas qejfeve, pas lekut). I dhënë me mish e me shpirt pas dikujt a diçkaje.
- DHI** f. Si dhia në mes të dhenve keq. që bie në sy për keq në mes të të tjerëve, që nuk i përshtatet mjedisit ku ndodhet, që është i huaj për rrethin ku jeton.
- DHIMBSEM** vetv. \* I dhimbset jeta mospërf. ka frikë se mos vdesë, se mos pësojë gjë

- etj.; e ruan shumë veten. I dhimbset lëkura *keq.* i dhimbset jeta. I dhimbset qyqes shih te QYQ/E,-JA.
- DHISK** m. 3. fig. vjet. Ndhimë që mblidhej për dikë që mbetej keq.
- DHJAMEM** vetv. 2. fig. keq. Grumbulloj a vë pasuri, pasurohem. U dhjam me punën e të tjerëve.
- EFENDI** m. 2. iron. Zotëri.
- EPIDEMI** f. 2. fig. keq. Dukuri që përhapet shpejt në një masë të madhe njerëzish. Epidemia e modës.
- ERË** I f. Bën (ndërton, ngre) kështjella në erë (në ajër) keq. shih te KESHTJELL/Ë,~A. Ia hodhi trutë në erë keq. e vrau (zakonisht me plumb dhe duke e qëlluar në kokë).
- ËMBËL** f. 3. zakon. euf. Sëmundje të rënda që u bien fëmijëve (lia, kolla e mirë, fruthi etj.).
- ËMBËL** mb. 9. iron. Që përdoret sa për t'ia bërë qejfin dikujt (për fjalë, fraza etj.). Fjalë (lafe, fraza) të ëmbla. \* Fjalët të ëmbla, punët të tharta shih te FJAL/Ë,~A. Kolla e ëmbël (e mirë, e bardhë) mjek., euf. shih te KOLL/Ë,~A.
- ËMBËLSOJ** kal. 6. fig. keq. E zbukuroj diçka sa për sy e faqe, e vesh një mendim me fjalë të bukura e të buta, që fshehin përmbajtjen e vërtetë; sheqeros. 8. jokal. vet. veta III krahin. euf. (me një trajtë të shkurtër të përemrit vector në r. dhanore). Ther, sëmbon; dhemb. Me ëmbëlson në anën e majtë. Me ka ëmbëlsuar tërë natën në brinjë.
- ËMBËLSUAR** mb. 2. fig. keq. Që është thënë me fjalë të ëmbla sa për sy e faqe; i sheqerosur. Politikë e ëmbëlsuar. Fjalim i ëmbëlsuar.
- FABRIKOJ** kal. 3. fig. keq. Krijoj e përhap vazhdimisht diçka të paqenë, sajoj diçka që s'është e vërtetë; shpif, trilloj. Fabrikonte gënjeshtër (shpifje).
- FAJ** m. Faji është jetim. keq.
- FALEM** vetv. b) ia di për faleminderit, i jam mirënjohës. Gjeti kishë (xhami) ku të falet iron. shih te KISH/Ë,~A.
- FANFARË** f. muz. 4. fig. keq. Mburrje, lëvdatë e zhurmshme.
- FAQE** f. \* Paç faqen e zezë! mallk. shih te ZI (i), ZEZË (e). Të puth halla në të dy faqet thjeshtligj. iron. shih te HALL/Ë,~A.
- FAQEBUTË** mb. 2. fig. keq. Që nuk e ka vrrarë puna, që ka bërë një jetë të rehatshme.
- FAQEDJEGUR** mb. 2. fig. keq. Që i ka plasur cipa, i pacipë, i paturp.
- FAREFISNI** f. 3. keq. Përkrahja e mbrojtja që u bën dikush pa të drejtë njerëzve, me të cilët ka lidhje gjaku a gjinie. Shfaqje farefisnie.
- FARË** f. \* Farë (lëng) hardalli iron, shih te HARDALL, ~I. Farë e kalbur keq. njeri me shumë vese të këqija e i pandreqshëm, njeri i prishur moralisht. Kungull (trangu) pa fara mospërf. njeri pa mend në kokë, budalla. E nxori (e qiti) fare e shfarosi, e zhduku.
- FAT** m. \* Ironi e fatit iron. përdoret kur ndodh diçka që nuk pritej e as mund të mendohej, kur vjen diçka fare e rastit dhe e pagjasë ose diçka e kundërt me atë që duhej të ndodhte.
- FAVOR** m. libr. 2. keq. Ndhimë, përkrahje a mbrojtje e padrejtë, që i bëhet dikujt; anësi, hatër. Bën favore. Nuk lejohen favorët.
- FAVORIZOJ** kal. libr. 2. keq. Përkrah a mbroj dikë pa të drejtë, i mbaj anën, e mbaj me hatër.
- FERMAN** m. 2. iron. Dokument zyrtar, dëshmi. \* Me ferman keq. i njohur nga të gjithë si i keq, me nam.
- FERRACAK** mb. 2. fig. keq. Që nuk të shqitet, që të bëhet ferrë. Njeri ferracak.

- FËMIJË** m. \* Fëmijët (djemtë) hanë kumbulla (thana), pleqve u mpihen dhëmbët iron. shih te MPIHEM. Lodra e fëmijës euf. shih te LODËRZ, ~A.
- FËMIJËROR** mb. 2. fig. keq. Foshnjarak, i papjekur. Logjikë fëmijërore. Gjykim fëmijëror.
- FËRKOHEM** vetv. 4. fig. keq. Përpiqem t'i afrohem shumë dikujt duke e marrë me të mirë, duke i bërë lajka etj.; përpiqem t'i hyj në zemër dikujt me lajka. Nuk u fërkohej të tjerëve.
- FIJE** f. \* Fluturon me një fije bar përçm. shih te BAR, ~I I. Mbahet pas një fije floku (pas flokëve të vet) iron. shih te FLOK, ~U.
- FIK** m. \* Ra (zbriti, u rrëzua) nga fiku iron. ra nga grada ose nga pozita, e ulën në detyrë; e pësoi. Ulu zbrit nga fiku! iron. mos u mbaj me të madh, ule hundën!
- FILDISHTË** mb. \* Mbyllet në kullën e fildishtë keq. shih te KULL/Ë, ~A.
- FILOZOFI** f. 5. ~RA, ~RAT bised., iron. Fjalë e arsyttime të ndërlikuara që duken si të mëdha por që nuk kanë ndonjë vlerë; teori që nuk mbështeten dhe nuk zbatohen në praktikë; teoria. Ishte i vetmi për filozofira. Lëri filozofirat!
- FILOZOFIK** mb. 3. keq. Që ka karakter abstrakt, që teorizon.
- FILOZOFOJ** jokal. 3. bised., iron. Flas në mënyrë abstrakte, duke përdorur arsyttime të ndërlikuara e fjalë të mëdha, por pa ndonjë vlerë; merrem me filozofira. Filozofon kot. Ka prirje të filozofojë.
- FIS** m. \* Do të vejë në fis keq. do ta tregojë veten se ç'është e sa vlen.
- FJALË** f. I lëshon fjalët veresie keq. shih te VERESIE 2.
- FJETUR** ndajf. 3. euf. lart. Pa jetë, vdekur. Ishte fjetur.
- FLAS** jokal. \* I foltë hoxha (pifti). mallk. vjet. shih te HOXH/Ë, ~A. Kur të flasin lopët iron. shih te LOP/Ë, ~A.
- FLE** jokal. 3. euf. lart. Bie në gjumë të përjetshëm; prehet (për të vdekurin). \* Fjettë të mirën! mallk. vdektë! Paska fjetur zbuluar iron. shih te ZBULUAR. Në atë krah (anë, brinjë) fli! iron. shih te KRAH, ~U. Fle gjumin e vdekjes (fle gjumin e madh, fle të madhin) a) euf., mospërf. ka vdekur;
- FLETË** II f. \* I vuri fletë gojës e mbylli gojën, nuk foli, e qepi, i vuri kyç gojës. E ktheu (e ndërroi) fletën (pllakën) keq. shih te PLLAK/Ë, ~A.
- FLOK** m. \* Mbahet pas flokëve të vet iron. mbështetet te diçka shumë e dobët dhe e pasigurt. Iu ngritën (iu çuan) flokët (qimet e kokës, leshrat e kokës) përpjetë
- FOLE** f. \* Fole grerëzash (arëzash) keq. shih te GRERËZ, ~A. Bën (ngre, gjen, zë) fole
- FORMULË** f. 2. keq. Frazë a shprehje e gatshme që përsëritet gjithnjë njësoj, zakonisht për të dalë nga një gjendje e vështirë pa marrë asnjë zotim konkret. Formulë e gatshme. Me formulën e zakonshme. I gjeti një formulë.
- FOSHNJARAK** mb. 2. fig. keq. Që është karakteristik për një fëmijë të vogël, që i shkon a i përshtatet një foshnje; i papjekur. Veprim (mendim) foshnjarak. Në mënyrë foshnjarake.
- FRAZELOGJI** f. 3. edhe ~, ~TË keq. Fjalë e shprehje që duken të bukura, por fshehin a shtrembërojnë të vërtetën ose janë të zbrazëta e pa vlerë. Frazelogji e zbrazët (boshe). Frazelogji oportuniste (revizioniste). Frazelogji demagogjike.
- FRAZELOGJIK** mb. 2. keq. Që karakterizohet nga fjalë e shprehje, të cilat janë të bukura në dukje, por fshehin a shtrembërojnë të vërtetën ose janë fare të zbrazëta e pa vlerë.
- FRAZË** f. 2. keq. shih FRAZELOGJI, ~A 3. Fraza të zbrazëta (të fryra). Frazë e vjetruar.
- FRE** I m. \* Ia lëshoi (ia liroi) frerin (kapistallin, kapistrën) dikujt keq. shih te LËSHOJ.

- FRYJ** kal. 11. fig. keq. Rrit, zmadhoj a zgjeroj diçka më shumë sesa duhet; e paraqit diçka më të madhe nga ç'është në të vërtetë. I frynë organikat (kërkesat). I ka fryrë shifrat. Mos i fry të metat!
- FRYMË** f. \* Me frymën e shenjtë iron. shih te SHENJTË (i, e).
- FRYRË** mb. 6. fig. keq. Që është rritur, zmadhuar e zgjeruar më shumë nga ç'është; që paraqitet më i madh nga ç'është në të vërtetë. Organikë e fryrë. Plan i fryrë. Kërkesa të fryra. Shifra të fryra.
- FSHEH** kal. \* I fsheh brirët *keq.* shih te BRI,~RI.
- FSHEHTË** mb. 9. euf. bised. Gjonor; që ka të bëjë me organet gjinore. Organet e fshehta. Sëmundjet e fshehta.
- FSHIJ** kal. \* Nuk di të fshijë hundët mospërf. nuk është i zoti për asgjë, është fare i humbur. Fshiji mustaqet (buzët) për murrizi (pas murrizit) iron. shih te BUZ/Ë,~A.
- FSHIKËZ** f. \* Fshikëza e mirë veter. euf. plasja e bagëtive.
- FTOHEM** I vetv. 7. euf. Vdes.
- FTOHTË** mb. \* Sëmundja e ftohtë euf. tifoja. E pafsha të ftohtë! mallk. vdektë!
- FTOHUR** mb. 4. bised. euf. I vdekur. E gjeti të ftohur.
- FUNDIT** mb. \* Banesa e fundit euf. varri.
- FUSHATIZËM** m. libr. keq. Përpjekje për t'i zgjidhur detyrat e mëdha jo me një punë sistematike e të pandërprerë, por me fushata të përkohshme (metodë pune e gabuar që në thelb i lë problemet të pazgjidhura). Shfaqje të fushatizmit. Lufta kundër fushatizmit.
- FUT** kal. \* E futën (e rrasën) brenda thjeshtligj. mospërf. shih te BRENDA. Fut duart diku keq. ndërhy, merr pjesë në një punë, në një çështje etj. që s'i takon. Fut hundët (bundën, turinjtë) në diçka keq. ndërhy në një çështje që s'i takon, përzihet në një punë, në të cilën nuk duhet të përzihet. E futi (e vuri) në sirtar keq. shih te SIRTAR,~I. I futi (i nguli) thonjtë dikujt keq. shih te THUA.
- FYÇKË** mb. \* Arrë fyçkë keq. njeri mendjelehtë, njeri që e ka kokën bosh.
- FYRYFYÇKË** f. 2. keq. Grua a vajzë mendjelehtë. E bëri ajo fyryfyçka.
- FYTAFYTEM** vetv. Kapem fyta me dikë, kacafytem, përfytem. U fytafytën keq.
- GACË** f. \* U bë gacë u skuq në fytyrë, u bë prush në fytyrë. Gacë e mbuluar (thëngjill i mbuluar) keq. shih te MBULUAR (i, e). Ishte gacë në para kishte shumë para (përdorej sidomos për ata që kishin shumë para flori).
- GANEC** m. 2. keq. Kodosh.
- GARË** f. 3. keq. Konkurrencë. Gara e armatimeve konkurrencë që ka për qëllim rritjen e vrullshme të armatimeve, përgatitjen për luftë, frikësimin dhe nënshttrimin e popujve.
- GARUZHDE** f. 2. fig. keq. Njeri që përzien të tjerët, ngatërrestar. Është një garuzhdë që s'e ka shokun.
- GATUAJ** kal. 3. fig. keq. Thur diçka në mendje; sajoj; sendërgjoj. Gatuan plane. Gatuan në mendje. Ç'gatuan në kokë?
- GËZIM** m. \* Gëzim për derë iron. shih te DER/Ë,~A.
- GISHT** m. \* Zgjat gishtërinjtë (krahët, duart) keq. shih te ZGJAT.
- GLOBAL** mb. libr. 2. keq. Që lidhet vetëm me sasinë në përgjithësi, që nuk mban parasysh kërkesat për cilësi të mirë të prodhimit dhe për asortimentet e ndryshme; që mbështetet në globalizmin. Realizim global. 4. si em. ~, ~I m, keq. Realizimi i planit vetëm në sasi, pa pasur parasysh ose duke shkelur kërkesat për cilësi të mirë të prodhimit e për të gjitha asortimentet; globalizëm. Në global. Si global. Rendja pas globalit.

- GLOBALIZËM** m. libr., keq. Realizimi i planit vetëm në sasi ose kryerja e një detyre vetëm në përgjithësi, pa pasur parasysh ose duke shkelur kërkesat për cilësi të mirë të prodhimit e për të gjitha asortimentet; metodë e huaj dhe e dëmshme në fushën ekonomike, shoqërore, politike etj. që e paraqet punën vetëm në përgjithësi, vetëm me shifra të përgjithshme, pa bërë analizën e thelluar të çështjeve etj. Lufta kundër globalizmit. Hoqën dorë nga globalizmi.
- GOJAÇ** m. shar. 3. keq. Ai që flet shumë, llafazan. 4. keq. Ai që merr nëpër gojë të tjerët, ai që flet keq për të tjerët., Gojaç i keq.
- GOJË** f. Gojë (gjuhët) e këqija (e liga). keq. Gojë e botës. I do në gojë keq. do që t'ia bëjnë gati të gjitha e vetë të mos lodhet, e do të gatshme çdo gjë, është dembel i madh. Ka gojë a) keq. flet mbarë e prapë, përdor fjalë të rënda, fyese etj.; b) është gojëprishur; c) gati sa s'e them diçka, e kam në mend a e di po s'po mundem ta shpreh, ta tregoj a ta përcaktoj si duhet, e kam në majë të gjuhës. Sa për të larë (për të shpëlarë) gojën iron. sa për të thënë, sa për të shkuar radhën. E ka shturur gojën keq. shih te SHTHUR. Ia zgjidh gojën (gjuhën) dikujt shih te ZGJIDH. I derdh (i tret) plumbin në gojë dikujt përb. shih te DERDH 4. Ka (edhe) gojë të flasë (të thotë, të kërkohet) keq. si guxon e flet ai, kur është i përlyer e nuk është në rregull për vete. Moj dhelpër, moj ankojë, shumë armiq zure me gojë! iron. shih te DHELP/ËR,~RA.
- GOJËKYÇUR** m. euf. Gojëlidhuri.
- GOJËLIDHUR** m. euf. 1. Ujku. Ra gojëlidhuri në dhen. 2. Ariu. 3. Gjarpri. E kafshoi gojëlidhuri.
- GOJËLUBI** mb. keq. 1. Që ha shumë, që s'ngopet me të ngrënë a me të pirë, që gllabëron e përland çdo gjë.
- GOJËMADH** mb. 2. fig. keq. Që flet shumë, llafazan.
- GOJËMBËRTHYER** m. euf. Ujku. Çau dy dele gojëmbërthyeri.
- GOJËMBËRTHYER** f. euf. Milingona.
- GOJËNEPËRKË** mb. keq. Që nxjerr nga goja fjalë të hidhura, që të helmon e të ther me fjalët që thotë, gojëgjarpër, gojëhelm.
- GOJËQEPUR** m. euf. Gjarpri.
- GOMAR** m. \* Këndon si gomar këndon keq. 3. fig. thjeshtligj., shar. Njeri i trashë nga mendja, budalla; hajvan. Gomar i madh. Mori mendjen e atij gomari. Gomar qenka! Gomar me veshë. thjeshtligj., keq. \* (Punonte) për shpirt të gomarit punonte kot, i shkonte mundi humbur. Sa gomarë buzëbardhë (ka)! iron, shih te BUZËBARDHË. S'di si (nga) lidhet gomari mospërf. shih te LIDHEM. Ia ha bukën gomari mospërf. është shumë i ngathët dhe i mefshtë. S'di gomari ç'është bari mospërf. nuk është i zoti të vlerësojë atë që është me të vërtetë e mirë e me vlerë, nuk di dhia ç'është tagjia. S'di t'i japë ujë (as) gomarit dikush mospërf. është i trashë nga mendja ose fare i pazoti. Presin të ngordhë gomari (kali) që t'i marrin patkonjtë përb. presin të përfitojnë ndonjë gjë nga ajo që mbetet, presin të përfitojnë nga diçka pa bërë asgjë vetë.
- GRAZHD** m. 4. fig. keq. Mjedisi i papastër, ku ushqehet e brumoset dikush për qëllime jo të mira. Në grazhdin imperialist (revizionist).
- GREP** m. 13. fig. keq. thjeshtligj. Ai që të ngjitet pas e s'të ndahet, ai që të bëhet ferrë. Iu bë grep. \* Është grep arb. keq. është hamës i madh.
- GRERËZ** f. zool. \* Fole grerëzash (arëzash) keq. çerdhe njerëzish të ligj që punojnë për t'u sjellë të këqija të tjerëve; çerdhe njerëzish të këqij që zihen e grinden sa t'u hanë kokat njëri-tjetrit.
- GRIJ** kal. 7. fig. bised., keq. Flas shumë dhe pa vend, llap kot. Grin mbarë e prapë. Grin gjithë ditën. Grin a s'grin!

- GROMËSIRË** f. 2. fig. keq. Veprim i fëlliqur, punë e ulët, diçka e keqe; poshtërsi. Kush i ka shkruar këto gromësira? 3. fig. shar. Njeri i fëlliqur, njeri i keq. Mos e dëgjo atë gromësirë!
- GROPSHAR** m. keq. Ai që i bën me paramendim një të keqe dikujt, ai që dëshiron t'i bëjë gropën tjetrit, ai që i bën varrin tjetrit.
- GRUA** f. \* Ato të grave euf. shih tek ATO. Gruaja (e bija) e botës shih te BOT/Ë, ~A I.
- GRUPASH** m. keq. 1. Ai që merr pjesë në një grup fraksionist të krijuar brenda një organizate a një kolektivi; anëtar i një grupazhi, fraksionist. U demaskuan grupashët.
- GRUSHT** m. \* I rri me grushte hundëve dikujt keq. shih te HUND/Ë, ~A. Më sa bëhen bashkë (bashkohen) një grusht pleshta iron. shih te PLESHT, ~I.
- GRYKËHOLLË** f. euf. Pushkë.
- GRYKËNGUSHTË** mb. 3. si em. GRYKËNGUSHT/Ë, ~A f. ~A, ~AT euf. Pushkë. I shkëlqente grykëngushta.
- GUNGË** f. 11. përd. mb. fig. keq. Kokëfortë.
- GURËS** mb. 4. fig. keq. Dorështrenguar.
- GUSHAN** m. keq. Gushak; gushëdalë.
- GJAK** m. 6. I etur për gjak. keq. Është bërë gjak i madh.
- GJARPËRUSHE** f. 2. fig. keq. Grua zemërligë e ngatërrestare, nepërkë.
- GJATË** mb. E ka dorën të gjatë (i ka duart të gjata) keq.
- GJEJ** kal. Ka gjetur rrasa vegshin (vorbën). keq. Ka gjetur tenxherja kapakun (u rrokullis tenxherja, gjeti kapakun). keq. Ka gjetur shkopi doçen. keq. 20. iron. Përdoret për të shprehur mospëlqim e ironi për diçka që është thënë a është bërë pa vend, që nuk e vlen ose për një njeri, tek i cili nuk kemi besim a i cili nuk është i përshtatshëm për atë që kërkohet.
- Gjete çfarë të thuash! Gjete me se të merresh! Gjete kujt t'ia japësh. Gjete si të arsyetohet! Gjete kishë (xhami) ku të falet! E gjete lugën në pilaf keq. shih te LUG/Ë, ~A.
- GJEL** m. 2. fig. keq. Njeri mendjemadh e kapadai; njeri që fryhet e ngrëfuset dhe e mban veten për më kryesorin; njeri që kërkon grindje. Gjeli i shtëpisë. Është bërë gjel.
- GJELAS** ndajf. bised. 2. fig. Duke u zënë, duke u grindur vazhdimisht njëri me tjetrin, keq. Shkojnë gjelas.
- GJELKOKOSH** m. bised. 2. fig. keq. Njeri kapadai e mendjemadh, kokosh.
- GJELUC** m. 2. keq. Gjel me trup të vogël dhe shumë i dobët. 3. fig. keq. Njeri mburravec, por i dobët e i pazoti.
- GJELLË** f. b) diçka e pakëndshme, diçka e pashijshme. Pështyu në gjellë (në çorbë) shih te PËSHTYJ. Në çdo gjellë majdanoz! iron. shih te MAJDANOZ, ~I. Gjellë me kripë e kripa me karar fj. u. shih te KRIP/Ë, ~A. Mos shtjer kripë në gjellë të botës! fj. u. shih te SHTIE. Atij s'i japin bukë, kërkon edhe gjellë nuk e kupton gjendjen e vërtetë në të cilën ndodhet dhe ka kërkesa të tepruara.
- GJEMB** m. \* Qen me gjemba (me kreshta) keq. shih te KRESHT/Ë, ~A.
- GJETURA** f. vet. euf. Të përmuajshmet e grave. I erdhën të gjeturat.
- GJETHE** f. c) iron. është pa asnjë lek në xhep. Luan si gjethja e plepit nuk e mban fjalën a premtimin. Si gjethja në verë shih te VER/Ë, ~A I. Kur (sa) të bëhet gjethja sa këmba e patës shih te PAT/Ë, ~A.
- GJËMË** I f. 5. bised., keq. Diçka e keqe dhe e shëmtuar, që mezi durohet. ç' e ke atë gjëmë!?
- GJËMËMADH** II mb. 3. keq. Që bën shumë zhurmë e bujë, që ankohet në të katër anët, zhurmëmadh. Njeri gjëmëmadh.
- GJILPËRË** f. 9. fig. keq. Njeri dinak që të bën një të keqe prapa krahëve pa e marrë vesh.



- GJIZË** f. M'u prish gjiza thjeshtligj., iron. nuk shqetësohem fare për diçka, nuk bëhem merak, nuk më prishet puna. Lule gjize bot. shih te LUL/E,~JA.
- GJU** m. b) ka shumë frikë, trembet shumë. I puth gjunjët (këmbë e dorë, këmbët, pëqirin, dorën) dikujt keq. shih te PUTH.
- GJUHË** f. Gjuhët (gojët) e këqija (e liga). keq. E ka zgjatur (e ka rritur) gjuhën (e ka bërë gjuhën të gjatë). keq. shih te ZGJAT. E zgjati gjuhën si lëpjetë (si lëpushë). keq. shih te ZGJAT. Nuk është pa gjuhë keq. nuk është fare i urtë e i pafjalë siç duket, herë-herë kundërshton e flet pa vend; flet pak si shumë. c) përçm. vdiq. Ka gjuhë keq. është llafazan, flet shumë e pa vend; merr të tjerët nëpër gojë. I ka dhënë liri gjuhës keq. shih te LIRI,~A.
- GJUMË** m. Gjumi i madh (i përjetshëm) euf. vdekja.
- GJYSMË** f. Ka ngrënë me gjysmë luge iron. shih te LUG/Ë,~A.
- HA** kal. Ha në një çanak me dikë keq. shih te ÇANAK,~U. I ngrënça drekën! mallk. e pafsha të vdekur; vdektë! Hëngri dynjanë hoqi keq, vuajti shumë. Edhe i ha, edhe i djeg thjeshtligj., iron. edhe ka qejf për diçka, edhe nuk i leverdis; Hëngri (kafshoi) dhe (botë) përçm. shih te BOT/Ë, ~A II. E ngrëntë (e hëngërt, e përpiftë) dheu! mallk. vdektë, e shtifshin në varr! b) mospërf. vdiq. Hante urov vuante, hiqte keq. E ha bariu pa shkop keq. shih te SHKOP,~I. (i dhanë, mori) gjysmën e lekut përçm. shih te LEK,~U. Ka ngrënë me gjysmë luge iron. shih te LUG/Ë,~A. Si ha macja cironkat!? iron. shih te MAC/E,~JA. I ha pula qurrat mospërf. shih te PULË,~A. Djemtë (fëmijët) hanë kumbulla (thana), pleqve u mpihen dhëmbët iron. shih te MPIHEM. Kërkon të hajë me dy lugë keq. shih te LUG/Ë,~A. Qeni leh atje ku ha fj. u. keq. shih te QEN,~I.
- HABERMADH** mb. bised. keq. Që mëson lajme të ndryshme andej e këtej dhe i përhap ato, që i çon fjalët lart e poshtë.
- HAIR** m. bised. I pafsh hairin! iron. Mos e bëftë pikën e hairit! mallk. Të qoftë për hair! ur.
- HAJDE** pasth. bised. \* Hajde baba të të tregoj arat (vreshtin)! iron. shih te BABA,~I.
- HAJUJK** m. euf. 1. Djalli, qoftëlargu. 2. Shakullinë, dredhë.
- HAK** m. bised. \* I vjen hakut (i vjen për hak) dikujt keq. shih te VIJ.
- HALLDUP** m. 2. shar. Njeri i pagdhendur ose i trashë nga mendja; njeri i keq. Ik, or halldup.
- HALLDUPÇE** ndajf. bised., mospërf. 3. fig. keq. Kot më kot, pa e menduar mirë diçka, kuturu; në mënyrë të trashë.
- HALLË** f. \* Të puth halla në të dy faqet thjeshtligj., iron. u lamë bashkë; s'ke ç'merr, mos prit gjë, mori fund me kaq.
- HALLVË** f. \* Hallvë e ftohtë keq. diçka që mund të mos bëhet, diçka pa shpresë, punë e ftohtë. Hallvë e pjekur diçka që është bërë, punë e kryer. Të ngrënsha (të ndafsha, të bëfsha) hallvën! thjeshtligj. mallk. vdeksh!
- HAMALLËK** m. 3. fig. keq. Punë krahu e rëndë a e mërzitshme që nuk kërkon ndonjë aftësi a lodhje mendore; punë e pafrytshme, që nuk jep ndonjë përfitim; puna më e mërzitshme, por më pak e rëndësishme. Hamallëqe e shtëpisë. Merrej me hamallëqe.
- HAMSHOR** m. 2. fig. iron. Njeri i ushqyer mirë, i fortë e i papërmbajtur.
- HAN** m. 2. keq. Hotel që nuk mbahet pastër a që nuk ka as pajisjet më të thjeshta, hotel i keq. 3. fig. keq. Vend me rrëmujë të madhe, ku hyn e nga ku del kush të dojë e kur të dojë. Han me dy (me shtatë) porta. U bë han. ç'është ky han?
- HANXHAR** m. \* I ra me hanxhar diçkaje e dëmtoi rëndë, e prishi keq.

- HAP** kal. b) keq. na ngjalli neveri, na bëri të na vijë pështirë, na ngjalli krupën. Hap (zbardh, zbulon) dhëmbët keq. shih te ZBARDH. Hap (çel) e s'mbyll keq. shih te ÇEL. Ka (mban) hapëset (çelësat) e kashtës iron. shih te KASHT/Ë,~A.
- HARAKIRI** m. palak. libr. 2. fig. Flijim që bëhet për hir të diçkaje; keq. flijim i verbër, flijim i kotë.
- HARBOJ** jokal., bised. 1. keq. Bredh pa fre në vende të ndryshme, sillem lart e poshtë, shkoj sa në një vend në tjetrin. Harbon shumë (kot më kot, andej e këtej). Harboi nëpër botë. Harboi tërë natën. 5. keq. Bën si i shfrenuar, tërbohet, e kalon masën. Harboi kali (mushka). Harboi era (shiu). 6. fig. keq. Bëhem i papërmbajtur, s'u vë fre ndjenjave, dëshirave dhe epsheve, shthurem e jepem pas qejfeve; azdisem. Kërcenin e harbonin. Harbonte me vajza. Harboi pas pelave. 7. kal. fig. keq. E bën të papërmbajtur; e tërbon. E harboi pija (rakia, vera).
- HARBUAR** mb. bised. 1. keq. Që bredh pa fre lart e poshtë, që nuk qëndron gjëkund. Njeri i harbuar. 3. keq. Që është i papërmbajtur, që bën si i shfrenuar; i tërbuar, i egërsuar. 4. keq. Që është bërë i papërmbajtur, që s'u vë fre ndjenjave, dëshirave e epsheve, i shthurur e i dhënë pas qejfeve. Njeri (djalë) i harbuar. Grua e harbuar.
- HARBUTÇE** ndajf. bised., keq. Harbutërisht. I foli harbutçe. Sillej harbutçe.
- HARBUTËRISHT** ndajf. keq. Në mënyrë të pasjellshme, të pagdhundur, të ashpër dhe pa edukatë; vrazhdë, rëndë. Sillej harbutërisht. Foli (u përgjigj) harbutërisht.
- HARDALL** m. \* Farë (lëng) hardalli iron. njeri që ka lidhje farefisnie shumë të largëta me një tjetër. Doli hardall diçka shkoi kot, nuk fitoi gjë.
- HARVALLINË** f. 2. keq. Grua me trup të madh e të shëmtuar, gërdallë.
- HAVALE** f. bised. 4. euf. Sëmundja e tokës, epilepsia; sëmundje e pashërueshme. E ka zënë havaleja.
- HEDH** kal. I hodhi trutë në erë keq. shih tek ER/Ë,~A 1. Hedh këmbët (hedh vallen, luan këmbët, kërcen) siç bie daullja (sipas daulles, siç bie lodra) keq. shih te DAULL/E,~JA.
- HEKUROSUR** mb. 3. fig. iron. thjeshtligj. I ngathët, i ngrirë. Qenka fare i hekurosur.
- HEQ** kal. \* Më heq ana me dikë a me diçka shih tek AN/Ë,~A I. E hoqi (e tërhoqi) në baltë dikë shih te BALT/Ë,~A. Më heq (më shkon, më vete) bark shih te BARK,~U 10. Ia hoqi (ia nxori, ia qiti) bojën keq. shih te BOJ/Ë,~A. I heq (i tërheq) kërraba nga vetja keq. shih te KËRRAB/Ë,~A. I ka thonjtë pa hequr keq. shih te THUA, THOI.
- HERGJELE** f. 2. fig. Vajzë a grua e re dhe e shëndoshë; keq. femër e papërmbajtur dhe e harbuar.
- HËNË** f. Lehin si qentë në hënë (në hënëz) keq. shih te HËNËZ, ~A.
- HËNËZ** f. \* Lehin si qentë në hënëz (në hënë) keq. thërrasin shumë, bërtasin me të madhe.
- HIJE** f. sh Hijet e bardha. euf. hijet e liga. I rëntë hija! mallk. Pastë hijen e vet! keq. Vjen si hije vjen befas, vjen papritur. \* Bën hije diku (bën hije mbi dhe) keq. është, gjendet, është i gjallë, rron pa kryer ndonjë punë të dobishme, bën hije dikujt. Është (jeton, rron, rri) në hijen e dikujt keq. Më marrtë hijen! mallk. vdektë!
- HINGËLLIJ** jokal. 2. fig. keq. Thërras shumë, nxjerr një britmë të fortë; qesh fort e me ndërprerje. Hingëllinte si mëz i azdisur. Mos hingëlli ashtu!
- HIQEM** vetv. 1. Shkoj nga një vend në një vend tjetër, zhvendosem e ndërroj vendin, largohem nga vendi ku kam qenë; keq. largohem, shporrem. Hiqen anash (mënjatë, prapa).

**HISTERI** f. 3. fig. keq. Veprimtari e ethshme dhe e shfrenuar që zhvillohet në një fushë të caktuar të jetës shoqërore, në luftën kundër dikujt etj. Histeria politike e imperialistëve. Histeria antikomuniste e fashizmit. Histeria luftënxitëse e kapitalistëve.

**HISTERIK** mb. 2. fig., keq. I shfrenuar, i papërmbajtur, i tërbuar, si në gjendje histerie. Propagandë histerike. Thirrjet histerike të imperialistëve. Fushata histerike kundër komunizmit.

**HISTORI** f. \* U bë histori diçka kryes. keq. Ujët e hollë (e vogël) euf. shih tek UJ/Ë, ~I 2.

**HOLLOJ** kal. \* I holloi duart (së fërkuari) iron. Është shumë i kënaqur për diçka, fërkon duart nga kënaqësia.

**HORR** m. bised. 1. shar. Njeri me vese të këqija që sillet keq, pi ose luan kumar; njeri pa cipë e pa nder; rrugaç. Horr i horrave horr shumë i keq. Ishte horr i madh. Mos i beso atij horri! 3. përcm. Njeri i pasur, po dorështrënguar e zemërngushtë, kamës që jo vetëm nuk u jep gjë të tjerëve, por edhe vetë rron keq.

**HU** m. \* Bredh hu më hu keq. b) tallet me të gjithë, thumbon shumë. Sot i bën hunjtë, nesër i djeg nuk e mban fjalën, e ha fjalën, është i paqëndrueshëm; të ha në fjalë. Tre hunj e një thupër keq. shkel e shko. Më sa rri sorra më dy hunj shih te SORR/Ë, ~A.

**HUDHËR** f. \* Bulmet hudhrash iron. punë e kotë, punë boshe, diçka pa vlerë.

**HUMBALAQ** mb. keq. 1. I humbur, që nuk është i zoti. Njeri humbalaq. 2. Përd. em. sipas kuptimit të mbiemrit (për njerëzit).

**HUNDË** f. Fut hundët (hundën, turinjtë) në diçka keq. shih te FUT. Ka ngritur hundën me dikë keq. shih te NGRE. Ia nxori (ia qiti) nga hundët (nga hunda, për hundësh) diçka keq. I është rritur hunda (mendja) dikujt keq. shih te RRITEM. E sheh nën hundë dikë e

sheh me përcmim. I theu (i dërrmoi) hundët (turinjtë, dhëmbët, nofullat, brinjët) dikujt përcm. shih te THYEJ. E uli hundën iron. hoqi dorë nga krenaria e mburrja e kotë, pushoi së krekosuri; u bë më i shtruar. S'e ul hundën keq. vazhdon të mbahet me të madh, nuk afrohet e nuk pajtohet me dikë a me diçka; nuk i bindet dikujt. Zgjati hundët keq. shih te ZGJAT. b) u inatos keq. u tërbua nga inati. E bëri hundë me buzë shih te BUZ/Ë, ~A. I ka rënë hunda në dhe (përdhe) iron. është zemëruar shumë. Nuk i bie hunda në shesh dikujt nuk bie keq, nuk zihet ngushtë. Nuk di të fshijë hundët mospërf. shih te FSHIJ. I duket hunda dyfek keq. shih te DYFEK, ~U. E kam në majë të hundës dikë a diçka keq. I kullot hunda lart iron. është mendjemadh, e mban veten shumë lart. E mban (e ka) hundën lart (përpjetë) iron. mburret shumë, mbahet me të madh. E nxori hundën jashtë iron. u hodh në veprim, nuk qëndroi në pritje dhe i mbyllur diku. I rri me grushte hundëve dikujt keq. e kërcënon hapur dikë, nuk e lë të ngrejë kokë. I arrijnë sytë gjer te maja e hundës keq. nuk sheh përtej hundës së vet. S'e lë hunda të hajë (të kullotë) bar tall. është mendjemadh, vret lart dhe kjo e dëmton. Ka ulur pak hundën, por ka ngritur sqepin iron. shih tek UL.

**HUNDËÇIP** mb. 2. fig. keq. Mendjemadh, hundëpërpjetë.

**HUNDËMADH** mb. 2. fig. keq. Mendjemadh.

**HUNDËPËRPJETË** mb. 2. fig. keq. Mendjemadh.

**HURDHË** f. Ai i hurdhës bised. euf. shejtani.

**HUSHKULUR** mb. keq. 1. Që bredh poshtë e lart dhe nuk ngulet për të banuar në një vend, endacak; që s'ka një vend të përhershëm banimi. Njeri hushkulur.

**HUTAQ** mb. keq. 1. I hutuar; që harron shpesh, harraq. Nxënës hutaq.

- HYJ** jokal. Ka hyrë në një rabush me dikë keq. shih te RABUSH, ~I. ëtej i hyri këtej i doli mospërf. nuk kuptoi asgjë fare, nuk mori vesh asgjë nga ato që dëgjoi. Hyri mish e doli peshk mospërf. shih te MISH, ~I. Lëre lëngun e hyr në thela! iron. shih te LËNG, ~U.
- IDEALIST** m. 3. keq. Ai që nuk e kupton jetën drejt, ashtu siç është, por e zbuluron dhe e idealizon, që ka prirje të ëndërrorë dhe s'është në gjendje të veprojë në përputhje me realitetin.
- IDIL** m. 4. fig. iron. Dashuri e madhe a miqësi e fortë që lidh dy veta ose dy palë, paqe e mirëkuptim ndërmjet tyre për qëllime jo të pastra e në një bazë jo të shëndoshë. Idili i, ,harmonisë klasore??.
- IDIOTËSI** f. libr. 2. edhe keq. Veprim, punë, sjellje prej idioti, budallallëk i madh; fjalë, shprehje prej idioti. Idiotësi e madhe. Shprehje idiotësie. Gjithfarë idiotësirash. Arriti deri në idiotësi.
- IJË** f. b) keq. na shoi së gënjyeri. Mbjaj ijët (barkun, brinjët) me dorë shih te DOR/Ë, ~A. Rri me duar në ijë (në mes, në brez, në bel, në gj, në xhepa) rri kot e bën sehir, nuk punon, rri pa bërë gjë.
- IKACAKE** f. keq. Grua që ka lënë burrin.
- IKANAK** m. keq. Ikacak.
- ILAÇ** m. \* Ilaç i vjetër në shishe të re keq. përdoret kur diçka paraqitet në një formë, në një pamje a në një mënyrë të re pa ndryshuar përmbajtjen e saj.
- IMPORTOJ** kal. 2. fig. keq. Marr nga vendet e tjera diçka që zakonisht është e keqe ose e huaj për shoqërinë tonë, për vendin e për popullin tonë, huazoj nga vendet e tjera diçka të dëmshme e jo të natyrshe për vendin tonë. Nuk e importojmë modën (muzikën, ideologjinë) e huaj.
- IMPORTUES** m. 2. fig. keq. Ai që huazon e sjell nga jashtë diçka të huaj a të dëmshme për vendin e për popullin e vet, ai që bëhet bartës i diçkaje të huaj. Importues i modës (i muzikës, i ideologjisë) së huaj.
- INTELEKTUALIST** mb. keq. Që vuan nga intelektualizmi, që ka intelektualizëm; që karakterizohet nga intelektualizmi, që është karakteristik për intelektualin borgjez. Shfaqje (pikëpamje, prirje, mbeturinë) intelektualiste. Qëndrim (mendim, koncept) intelektualist.
- INTELEKTUALIZËM** m. keq. Mbivlerësimi i punës mendore, i teorisë, i shkencës, i rolit të specialistëve e përgjithësisht i punës së intelektualëve dhe nënvlerësimi i aftësive krijuese e drejtuese të masave punonjëse, i punës prodhuese në zhvillimin shoqëror e në tërë jetën e vendit; qëndrim i lëkundshëm në jetën dhe në veprimtarinë shoqërore, që është karakteristik për intelektualët borgjezë. Intelektualizëm borgjez. Frymë (shprehje) intelektualizmi. Shfaqje të intelektualizmit. Ra në intelektualizëm.
- INJORANCË** f. 2. keq. Njohje fare e cekët ose shumë e kufizuar e diçkaje (zakonisht për një fushë të dijes, për një dukuri etj.); trashtinë. Injorancë në filozofi (në politikë, në ekonomi).
- INJORANT** m. 2. keq. Ai që e njej diçka në mënyrë fare të cekët ose shumë të kufizuar; ai që nuk i kupton fare gjërat ose i kupton keq ato; njeri i pagdhundur që nuk di të sillet në jetë. Injorant i madh. Injorant në politikë (në letërsi, në muzikë, në art).
- ISO** f. \* I mban ison (i bën iso) dikujt keq. e mbështet dhe e përkrah dikë për çdo gjë, ia pranon a ia miraton mendimet, fjalët etj. për t'i bërë qejfin, i shkon pas qejfit, i mban avazin.
- JAM** jokal. ç'paske qenë! iron., mospërf. s'i gjendet shoku!, i vetmi qenka!, s'e paskam njohur! Të qoftë! merre!, e mbajtsh me shëndet!, e gëzofsh! (edhe iron.). Udhë e mbarë (i qoftë)! iron. shih tek UDH/Ë, ~A.
- JAP** kal. I dha një sheqerkë keq. shih te SHEQERK/Ë, ~A. I dha thonjtë dikujt keq. shih te THUA, THOI. I dhanë (hëngri mori) gjysmën e lekut përçm. shih

- te LEK, ~U. Ia dha këpucët (opingat) në dorë mospërf. shih te KËPUC/Ë, ~A. Ia dha lekat në duar dikujt mospërf. shih te LECK/Ë, ~A. I ka dhënë liri gjuhës keq. shih te LIRI, ~A. s' di t' i jep ujë (as) gomarit dikush mospërf. shih te GOMAR, ~I. Të jep thonjtë e bufit për të të nxjerrë sytë keq. shih te SY, ~RI. Të jep një thelë e të merr (të rrëmben) një pelë keq. shih te THEL/Ë, ~A. s' të jep as gur për të çarë kokën përb. shih te GUR, ~I.
- JARAN** m. vjet. 1. Miku i zemrës ose i dashuri i një vajze a i një gruaje; keq. dashnor. Kishte një jaran. I vinte jaranit. E gjetën me një jaran. E prisnin jaranët.
- JARGAVITEM** vetv. 1. keq. Më bien jargët nga goja, më kullon goja jargë; bëhem tërë lot e jargë nga të qarët; përgjem, jargosem.
- JASHTË** Dal jashtë euf. bëj nevojën. Të dalët jashtë shih te DALË, ~T (të). Është jashtë botës keq. shih te BOT/Ë, ~A. Mbeti (rri) me dhëmbë jashtë keq. mbeti duke qeshur. E nxori hundën jashtë iron. shih te HUND/Ë, ~A. Djepi plot e këmbët jashtë tall. shih te DJEP, ~I.
- JASHTËSME** f. vet. euf. mit. Qenie mitologjike, të cilat, sipas besimeve popullore shqiptare, rrinin nëpër pyje e male, rrëmbenin djem e vajza dhe luanin valle së bashku pa pushim derisa të rinjtë të treteshin e të vdisnin, nusët e malit.
- JATAK** m. 3. fig. kryes. keq. Strehë për dikë, bazë ku gjen vend a fshihet dikush; ai që fsheh dikë a diçka. Jatak i fshehtë. I biri jatak dikujt.
- JETIM** mb. \* Faji është jetim fj. u. keq. përdoret kur askush nuk e pranon fajin, kur askush nuk i del zot fajit.
- JO** pj. 6. Përdoret, zakonisht e shoqëruar me pasthirrma, kur folësi shpreh habi, mosbesim, mospërfillje, qesëndi, përçmim, pakënaqësi etj. Jo more, vërtet?! Jo moj, ç'na thënke! Po si jo! iron.
- JUDË** m. keq. Tradhtar e spiun i poshtër, ai që shet edhe babanë a vëllanë e vet. Judë i pabesë.
- JUNTË** f. keq. Grup njerëzish në krye të shtetit borgjez e reaksionar, që e ka marrë pushtetin me dhunë dhe që në emrin e një këshilli, të një asambleje etj. shtyp e shfrytëzon egërsisht popullin. Junta ushtarake (fashiste). Kreu i juntës.
- KA** m. E do si kau kashtën iron. nuk e do aspak. Qe si qe e u bë si ka shak. ndodhi si ndodhi, tashti ta lëmë këtë çështje, se mori fund.
- KABINET** m. \* Shkencëtar kabineti libr., keq. shkencëtar që ka shkëputur lidhjet me jetën, shkencëtar që nuk njeh praktikën revolucionare.
- KABUNI** f. \* Ka (kërkon të ketë) një rëndësi në bakllava dhe tjetrën në kabuni (në mjaltë, në revani) keq. shih te DOR/Ë, ~A.
- KAFEHANE** f. 2. keq. Kafene e vjetër, e papastër dhe me tym e rrëmujë.
- KALAMA** m. bised. 2. keq. Njeri i papjekur dhe pa përvojë nga jeta, njeri që sillet si fëmijë.
- KALAMALLËK** m. 2. keq. Veprim i papjekur, punë a sjellje prej kalamani. Bën kalamallëqe.
- KALBUR** mb. \* Dru i kalbur njeri që sëmuret shpesh, njeri i dobët; plak. Farë e kalbur keq. shih te FAR/Ë, ~A. Nuk shkel (nuk bie) në dërrasë (në dhogë) të kalbur shih te
- KALË** m. I ka hipur kalit lakuriq mospërf. shih te LAKURIQ. Sillet si kali në lëmë mospërf. sillet rrotull e nuk bën asnjë punë të dobishme, vjen vërdallë kot. U rrëzua kali, t' i presim këmbët! iron. përdoret kur për një gabim të vogël dikush kërkon një dënim të madh. Presin të ngordhë kali (gomari) që t' i marrin potkonjtë përb. shih te PRES II. Ajo e kalit euf. elbth, kath.
- KALTËRUAR** mb. 3. euf. Kufomë trupi i të vdekurit, i vdekuri.

- KALLAJIS** kal. 2. keq. Fëlliq dikë a diçka me baltë, me lyrë etj.; i vë një shtresë të hollë, lyej me diçka. Ka kallajisur fytyrën. E kallajisi me gëlqere.
- KALLAJISEM** vetv. 1. keq. Fëlliqem me baltë, me lyrë etj. U kallajis i tëri.
- KALLAJISUR** mb. 2. keq. Që është fëlliqur me baltë, me lyrë etj.; i përlyer. Me buzë të kallajisura.
- KALLAUZ** m. vjet. 2. keq. Njeri i paguar që vihet në shërbim të dikujt dhe i tregon atij gjithçka, spiun.
- KALLËP** m. 3. keq. Model a skemë që prahet dhe zbatohet verbazi, pa e studiuar, pa ia nënshtruar kritikës; shabllon, shtampë. Sipas kallëpeve të huaja. 4. fig. keq. Njeri që nuk është në gjendje të gjykojë e të mendojë në mënyrë të pavarur, që nuk i vështron gjërat me syrin e vet dhe i merr a i zbaton ashtu siç janë, pa i gjykuar fare; njeri i trashë nga mendja. 5. keq. Lloj, soj. Njeri i kallëpit të tij. Njerëz të çdo kallëpi. Janë të një kallëpi. 7. përd. ndajf. keq. Ashtu siç duket nga jashtë a siç thuhet, pa u përpjekur t'i zbërthejë e t'i kuptojë gjërat, pa hyrë në brendinë e gjërave, jo në mënyrë krijuese, shabllon.
- KALLOGJER** m. 2. keq. Njeri që bën jetë të mbyllur, ai që është shkëputur nga jeta e gjallë.
- KAM** kal. Ka (edhe) gojë të flasë (të thotë, të kërkojë. . .)! keq. shih te GOJ/Ë,~A. S'ka gojë të flasë (të thotë, të kërkojë. . .) keq. shih te GOJ/Ë,~A. Ka gjuhë keq. shih te GJUH/Ë,~A I. Nuk ka hundë (turinj) për dikë a për diçka mospërf. shih te HUND/Ë,~A. E kam në hundë dikë për b. shih te HUND/Ë,~A. S'ka thua mospërf. shih te THUA, THOI. Sa gomarë buzëbardhë ka! iron. shih te BUZËBARDHË. E kam në majë të hundës dikë a diçka keq. shih te HUND/Ë,~A.
- KAMBANË** f. \* Të gjithë i bien një kambane të gjithë të njëjtën gjë thonë. Dëgjohe
- vetëm kambana e tij keq. të gjithë veprojnë ashtu siç thotë a urdhëron dikush, i cili përpiqet të detyrojë të tjerët të pranojnë mendimin e udhëzimet e tij.
- KANDIS** kal. bised. Ama na kandise! iron. ama ç'na e mbushe mendjen, ama ç'na bëre të besojmë.
- KANIBAL** m. 2. keq. Njeri shumë i egër, njeri gjakatar e mizor. Kanibalët hitlerianë (fashistë).
- KANIBALIZËM** m. 2. keq. Egërsi e madhe, barbarizëm.
- KAP** kal. Kapi (zuri) qeni një lepur mospërf., iron. shih te QEN,~I. Sikur ka kapur (ka zënë, ka rrokur) qiellin me dorë iron. shih te QIELL, ~I. Kape laro, prite balo tall. shih te LARO,~JA.
- KAPAK** m. c) u çudita shumë, u mahnita. Ka gjetur tenxherja kapakun (u rrokullis tenxherja e gjeti kapakun) keq. shih tek TENXHER/E,~JA.
- KAPISTALL** m. Ia lëshoi (ia liroi) kapistallin (kapistrën, frerin) dikujt keq. shih te LËSHOJ.
- KARAKATINË** f. keq. 1. Ndërtesë e vjetër, që është gati për t'u rrëzuar; karrocë, makinë etj. e vjetër dhe e prishur, shkatërrinë. Është (u bë) karakatinë. Banonte në një karakatinë.
- KARAVIDHE** f. 2. fig. keq. Njeri shumë i lëvizshëm, që nuk zë vend; njeri i paqëndrueshëm e dredharak, që vetë nuk rri i qetë e nuk lë të qetë as të tjerët. Shportë karavidhesh grup njerëzish pa karakter e dredharakë, që nuk merren vesh, grinden e kacafyten vazhdimisht dhe i hanë kokën njëri-tjetrit.
- KARKACUL** mb. bised., keq. 1. I gjatë dhe i hollë (për njerëzit e për sendet). 2. I veshur keq, i veshur me rroba të grisura, i rrekosur; që s'ka rroba në trup, lakuriq. 3. përd. ndajf. Pa asnjë rrobë në trup, lakuriq. Mbeti karkacul.

- KARRIERIST** m. keq. Ai që mendon dhe synon të bëjë karrierë; ai që i vë vetes si qëllim kryesor e përpiqet të zërë poste sa më të larta shtetërore e shoqërore, për përfitime e mirëqenie vetjake, pa marrë parasysh të mirën e përgjithshme. Ishte karrierist.
- KARRIERIST** mb. keq. Që ka të bëjë me karri-erizmin e me karrieristin, që është tipar i karrieristit; që synon të bëjë karrierë. Me qëllime (me synime) karrieriste. Njerëz (elementë) karrieristë.
- KARRIERIZËM** m. keq. Synim i vetëdijshëm për të zënë poste sa më të larta në punët shtetërore e shoqërore, për të siguruar mirëqenien vetjake e sa më shumë përfitime për vete pa marrë parasysh të mirën e përgjithshme; mënyra si mendon dhe si vepron një karrierist. Lufta kundër karrierizmit.
- KARRIGE** f. \* Rri (qëndron) mbi dy karrige keq. i bën qejfin edhe njërit edhe tjetrit për të përfituar nga të dy krahët; nuk është parimor dhe i qëndrueshëm në pikë-pamjet e tij.
- KASAP** m. 2. keq. Njeri i pamëshirshëm dhe i egër, njeri që rreh, vret e ther njerëz dhe nuk ka dhembshuri. Kasapët imperialistë. Ra në thonjtë e kasapit. 3. keq. Kirurg i paaftë, kirurg kërpaç.
- KASNECOJ** kal. 2. keq. I bëj reklamë një pune a një veprimi të dikujt; shpall me bujë e bëj të njohur botërisht një punë a veprim që kam bërë vetë.
- KASTË** f. 2. keq. Grup i vogël njerëzish, që kanë një pozitë shoqërore të veçantë, që mbrojnë interesat e ngushta vetjake dhe e ndajnë veten nga të tjerët. Kastë burokratike.
- KASTRAVEC** m. bot. 3. përd. mb. fig. keq. I papjekur dhe pa përvojë në jetë; budalla. Ishte fare kastravec. \* Mos i shit kastravecë bostanxhiut! shih te BOSTANXHI, ~U. Mbolli bostan e i dolën kastravecë iron. shih te MBJELL.
- KASHTË** f. bot. E do si kau kashtën iron. shih te KA, ~U. Ka (mban) çelësat (hapëset) e kashtës iron. s'ka asgjë në dorë; nuk varet aspak prej tij (një punë). Rrinte si beu në kashtë tall. krekosej, mbahej rëndë kot.
- KATIL** m. keq. Ai që vret dikë në mënyrë mizore, vrasës i pamëshirshëm, kriminel; ai që nuk ngopet duke e munduar dikë, duke i bërë keq dikujt. Katilët fashistë. Me zemër (me shpirt) prej katili.
- KATILE** f. keq. Fem. e KATIL, ~I.
- KAZAN** m. 3. keq. Vendi ku zhvillohet vazhdimisht një veprimtari e etshme, ku zien lufta e mendimeve etj.; vendi ku përpunohet një mendim për të mashtruar të tjerët, burimi nga lind dhe përhapet një trillim, një shpifje etj.
- KAZERMË** f. 2. keq. Shtëpi, ndërtesë e madhe me kushte jo të mira për banim a për punë. \* Ushtri e kazermës keq. ushtri që i ka shkëputur lidhjet me masat e gjera të popullit, që zbaton formalisht rregulloret dhe nuk njeh kërkesat e Luftës Popullore.
- KECAN** m. vjet. 2. keq. Njeri i keq që i shërbën dikujt verbërisht e pa shpërblim.
- KEQAN** mb. keq. 1. Që ka zemër të keqe; i keq. Njeri keqan.
- KËLYSH** m. 2. fig. keq. Fëmijë që lind nga prindër të këqij e të pandershëm.
- KËLLIRË** f. 4. ~A, ~AT fig. keq. Njeri i keq, i papastër dhe i padobishëm për shoqërinë, fundërrinë e shoqërisë; diçka e keqe, që duhet pastruar a që duhet hequr qafe.
- KËMBË** f. 14. fig. keq. Zgjedhë, thundër. Nën këmbën e pushtuesit. E vuri nën këmbë e nënshtroi, e mundi, e mposhti. \* I ra këmbës (i puth) këmbët (çizmet) dikujt keq. shih te LËPIJ. Tundi këmbën mospërf. iron. shih tek TUND. I bëri këmbët baras (çift, kizë) mospërf vdiq. I çoi (i ngriti) këmbët bigë mospërf. shih te BIG/Ë, ~A. Djepi plot e

- këmbët jashtë iron. shih te DJEP,~I. Iu haptë varri (dheu) nën këmbë mallk. shih te HAPEM. E hoqi (e tërhoqi) këmbën zvarrë (rëshqitës) shih te ZVARRË. Kolos me këmbë argjile mospërf. shih te KOLOS,~I. Hedh këmbët (luan këmbët, hedh vallen, kërcen) siç bie daullja (sipas daulles, siç bie lodra) keq. shih te DAULL/E,~JA. U rrëzua kali, t'i presim këmbët iron. shih te KAL/Ë,~I. Do të nxjerrë prush me këmbët e maces keq. shih te PRUSH,~I.
- KËMBËKUQ** mb. 3. si em. ~E, ~JA f. ~E, ~ET euf. Dhel për.
- KËMBORË** f. 2. fig. keq. Njeri i përlulur e i nënshtuar, që i shërben dikujt për të nxjerrë ndonjë përfitim vetjak; njeri pa karakter, që mbështet, miraton e përhap mendimet e pikëpamjet e dikujt.
- KËNDES** m. 2. fig. iron. Ai që shet mend, njeri mendjemadh që ngrefoset e kapardiset, kaposh.
- KËNDOJ** I kal. Kur të këndoje qyqja e kuqe (nga bishti) iron. shih te QYQ/E,~JA.
- KËPUCË** f. \* Ia mbathi këpucët dikujt mospërf. shih te MBATH. Nuk e ka vvarë këpuca (samari) shih te VRAS. Doli me këpucë të kuqe dikush iron. shih te KUQ (i), ~E (e). Ia dha këpucët (opingat) në dorë mospërf. e përzuri, e dëboi (një njeri të padëshirueshëm). I hodhi (i futi) një gur në këpucë (në shollë, në opingë) dikujt shih te GUR,~I. I ktheu këpucët (këmbët, potkonjtë, thundrat) nga dielli për. shih te DIELL,~I. Iu ngjit si bagja (si balta) pas këpucës dikujt shih te BAJG/Ë,~A.
- KËPUSHË** f. 2. fig. keq. Njeri parazit që rron në kurriz të të tjerëve; njeri që të ngjitet e s'të ndahet.
- KËPUT** kal. \* Hiq (tërhiq) e mos e këput shih te HEQ. Këput (thyej) arrëzën (qafën)! keq. shih tek ARRËZ~A. Ia këputi frymën dikujt ia këputi shpirtin, e malëngjeu shumë. Na këputi ijët
- KËPUTEM** vetv. \* U këput ndër vete euf. u rrënxua. Iu këput rripi i pallës shih te RRIP,~I.
- KËRBAÇ** m. 2. edhe fig. keq. Goditja me këtë shkop a dredhë; goditje e fortë, dhunë, forcë e egër. I dha një kërbaç. Vuanin nën kërbacin e bejlerëve. Sundonin me kërbaç. I detyruar nga kërbaci. E mbanin nën kërbaç e mbanin me dhunë e me frikësime.
- KËRCEJ** jokal. Kërcen (hedh vallen, hedh këmbët, luan këmbët) siç bie daullja (siç bie lodra, sipas daulles) keq. shih te DAULL/E,~JA. Kërcen prifti nga belaja tall. shih te PRIFT,~I. I kërcyen trutë në kokë keq. shih te KOK/Ë,~A.
- KËRCU** m. 3. përd. mb. fig. keq. I trashë nga mendja, kokëtrashë, kokëgdhe; që rri i hutuar e si i ngrirë; që nuk lëviz nga vendi ku është ulur. Ishte (fare) kërcu.
- KËRCYER** mb. 3. fig. I papërmbajtur, që kërcen shpejt; keq. Që ka një dërrasë mangët.
- KËRÇEP** m. 5. përd. mb. fig. keq. shih KËRCU,~RI. E ka kokën kërbep. Është kërbep nga mendja është kokëtrashë, e ka kokën gdhe.
- KËRKAÇ** m. keq. 1. Ai që e ka ves t'u kërkohet vazhdimisht diçka të tjerëve, ai që s'e ka për turp t'i kërkohet kujtdo. Kërkaçi nuk është nikoqir. Kërkaçi e ka ngrënë turpin me bukë. 2. Ai që lyp derë më derë, lypës, përderës. Torba e kërkaçit. U bë si kërkaç.
- KËRKAÇE** f. keq. Fem. e KËRKAÇ,~I.
- KËRKOJ** kal. \* Kërkon për mokra keq. shih te MOK/ËR,~RA. Kërkoftë murin me dorë! mallk. shih te MUR,~I.
- KËRMË** f. \* Si sorrat pas kërmës keq. shih te SORR/Ë,~A.
- KËRPAÇ** m. bised. 2. keq. Zejtari që nuk bën punë me cilësi të mirë; njeri i pazoti në mjeshtërinë e tij. Ishte fare kërbep.
- KËRPAÇËRI** f. keq. Paaftësi në një mjeshtëri a profesion; punë e një cilësie të dobët, punë kërbepi.



- KËRRABË** f. b) u dobësua shumë nga trupi, u bë kockë e lëkurë. Mori kërrabën u bë bari. I tërheq (i heq) kërraba nga vetja keq. sheh kryesisht interesin vetjak, mendon në radhë të parë për vete.
- KËRRNJOTEM** vetv. 4. fig. keq. E kaloj kohën pa bërë ndonjë punë, ia fut gjumë.
- KËSHTJELLË** f. \* Kështjellë (kala) prej karte (prej letre) keq. pikëmbështetje e dobët. Bën (ndërton, ngre) kështjella në erë (në ajër) keq. bën projekte e plane që nuk mund të vihen në jetë; krijon me mend gjëra që nuk mbështeten në realitetin, sheh ëndrra me sy hapur.
- KISHË** f. \* Gjeti kishë (xhami) ku të falet iron. kërkon mbrojtje atje ku s'duhet, shkoi të zgjidhë një çështje atje ku nuk ia zgjidhin.
- KLAN** m. 3. keq. Grup njerëzish të lidhur nga interesa vetjake të njëjta. Klani revizionist.
- KLIKË** f. keq. Grup i vogël njerëzish që bashkohen nga ambicie, interesa e qëllime të këqija e që zhvillojnë një veprimtari të dëmshme. Klikë tradhtarësh (renegatësh). Klikë ushtarake. Klikë revizioniste.
- KLISHE** f. shtypshkr. 2. fig. keq. Ide, mendim ose shprehje, që është përdorur shpesh dhe përsëritet njësoj.
- KOCKË** f. \* La kockat (lëkurën, leshtë) keq.
- KODËR** f. \* Ngre kodra përmbi det iron. përpiqet të bëjë punë që janë të pamundura të bëhen, bën kështjella në erë. Gjahu në breg e qëllon në kodër shih te GJAH, ~U.
- KODOSH** m. keq. 1. Njeri i paturp, që bëhet ndërmjetës për punë të pamoralshme; njeri i shkathët e i djallëzuar, që është i zoti për të mashtruar ose për të bërë punë të poshttra. Kodoshi i beut.
- KOJ** kal. \* Me lugë të kon, me bisht të verbon keq. shih te LUG/Ë, ~A.
- KOKË** f. I kërcyen trutë në kokë keq. u inatos, u zemërua shumë.
- KOKËBOSH** mb. keq. Që nuk ka dije e kulturë, që s'ka gjë në kokë, që e ka kokën bosh, që nuk është në gjendje të mendojë, të gjykojë e të arsyetojë si duhet; i paaftë.
- KOKËTRASHË** mb. keq. I trashë nga mendja, që nuk kupton, kokëgdhe.
- KOKËTRASHËSI** f. keq. Të qenët kokëtrashë, vetia e njeriut kokëtrashë. Kulmi i kokëtrashësisë. Shpreh (tregon) kokëtrashësi.
- KOKËZBRAZËT** ndajf. keq. Kokëbosh.
- KOKOSH** m. 2. fig. keq. Njeri mendjemadh, që kapardiset e shet mend, këndes.
- KOLLË** f. \* Kolla e keqe (e zezë) mjek. tuberkulozi, veremi. Kolla e mirë (e ëmbël, e bardhë) mjek., euf. sëmundje ngjitëse e fëmijëve zakonisht deri shtatë vjeç, që shfaqet me kollë të fortë e të gjatë.
- KOLLTUK** m. 2. fig. keq. Punë zyre e rehatshme; vend pune me përgjegjësi e i rehatshëm.
- KOMANDANT** m. 4. bised., keq. Ai që ka dëshirë të japë urdhra dhe kërkon që të tjerët t'u binden këtyre patjetër, ai që e heq veten si kryetar e përgjegjës. Na u bë komandant!
- KOMANDUES** mb. 2. bised., keq. Që ka prirje për të dhënë urdhra, që i pëlqen a e ka zakon të komandojë; që i ngjan një urdhri. Njeri komandues. Qëndrim komandues.
- KOMPANI** f. 3. përmb., keq. Pasuesit e dikujt, ata që shkojnë verbërisht pas dikujt ose që bashkëpunojnë me të për qëllime jo të mira; ata që i mbajnë ison dikujt, që janë njësoj si ai, që mendojnë e veprojnë njësoj si ai. N.N. e kompani.
- KOMPROMISAXHI** m. keq. Ai që bie në marrëveshje me dikë duke i bërë lëshime; ai që ka prirje të bëjë kompromise të palejueshme.
- KONAK** m. vjet. Sheh tym e bën konak iron. shih tek TYM, ~I.

- KONFERENCË** f. \* I mban konferencë dikujt iron. shih te MBAJ. Konferencë shtypi shih te
- KONFORMIST** mb. libr. keq. 1. Që sillet e vepron në frymën e konformizmit; që përshkohet nga konformizmi; që mbështetet në konformizëm. Njeri konformist. Pikë-pamje konformiste. Qëndrim (mendim) konformist. Art konformist. Letërsi konformiste.
- KONFORMIZËM** m. libr., keq. Pajtim vetëm me fjalë me mendimet, veprimet a sjelljet e dikujt; prirje për t'iu përshtatur sa për sy e faqe qëllimeve, synimeve e interesave të më të fortëve a të shumicës; sjellje e veprime që bëhen sa për të qenë brenda. Shfaqje konformizmi. Ra në konformizëm. Luftojmë konformizmin.
- KONIUNKTURË** f. libr. Shfrytëzon koniunkturaturat. Njeri i koniunkturave. keq.
- KONSUM** m. 2. Përdorimi i diçkaje. Për konsum të brendshëm. libr. keq.
- KONTESHË** f. 3. iron. Grua a vajzë e rritur që vishet e pispilloset dhe e mban veten më të madh; ajo që nuk punon vetë dhe ka prirje të urdhërojë të tjerët.
- KOPSHT** m. \* Qen kopshti (kopshtari, bahçevani) keq. njeri që as vetë nuk e përdor diçka, as të tjerët nuk i lë ta përdorin, njeri që nuk e gëzon vetë një të mirë dhe nuk i lë as të tjerët ta gëzojnë.
- KOQE** f. sh \* Koqja e mirë mjek., euf. lëmsh i vogël në ngjyrë të errët, që formohet zakonisht në mollëzat e gishtërinjve e më rrallë në pjesë të tjera të krahut dhe që të jep dhembje të forta.
- KOS** m. \* Kur të bëhet deti kos iron. kurrë, asnjëherë.
- KRAH** m. \* Zgjat krahët (duart, gishtërinjtë) keq. shih te ZGJAT.
- KRENAR** mb. 4. keq. Që e çmon veten më lart se të tjerët dhe mbahet me të madh, që i është rritur mendja e sillet me mospërfillje a me përbuzje ndaj të tjerëve; që është karakteristik për një njeri të tillë, që shpreh një ndjenjë a një qëndrim të tillë; mendjemadh.
- KRENARI** f. 2. keq. Mendjemadhësi. Krenari e sëmurë.
- KRENARISHT** ndajf. 2. keq. Duke e çmuar veten mbi të tjerët dhe duke u mbajtur më të madh, duke u mburrur pa të drejtë; me mendjemadhësi, me mospërfillje ndaj të tjerëve.
- KRENOHEM** vetv. 2. keq. E vë veten mbi të tjerët, mbahem më të madh, mburrem pa të drejtë; sillem me mospërfillje ndaj të tjerëve.
- KRESHTË** f. \* Qen me kreshta (me gjemba) keq. njeri i rreptë; njeri i ashpër e i vrazhdë; njeri i pashpirt e mizor.
- KRESHTOHEM** vetv. 2. keq. Kapardisem, mbaj veten më të madh; shes mend.
- KRIMB** kal. 2. fig. keq. Grumbulloj diçka (para, ushqim, mall) dhe e ruaj për një kohë të gjatë pa e përdorur (thuhet zakonisht për koprracët). I krimbi paratë (mollët, fiqtë).
- KRIMBUR** mb. 6. bised., keq. Me mendime të mykura, me koncepte reaksionare e me mbeturina mikroborgjeze; që ka marrë tatëpjetën, pa të ardhme; i kalbur, i mykur.
- KRIP** kal. Të kripsa mendjen (trutë)! mospërf., iron. qenke fare pa tru! ç'janë këto budallallëqe që po thua! (i thuhet dikujt kur flet kot ose thotë diçka pa u menduar, pa gjykuar mirë).
- KROKODIL** m. 2. fig. keq. Njeri që përdor metoda mashtruese për të kënaqur dëshirat e tij të mbrapshta. Lot krokodili lot të rremë që lëshon dikush gjoja nga dhembja a nga hidhërimi ose ankesa të shtira që bën dikush me qëllim që të malëngjejë e të mashtrojë të tjerët.
- KROMASH** mb. keq. 1. Që i ka rënë kroma, zgjebarak. 2. shar. Përd. em. sipas kuptimit të mbiemrit.
- KRYEKUNGULL** mb. keq. përçm. Kokëkungull.

- KRYEPËRJETË** ndajf. 2. keq. Kryelartë, mendjemadh, hundëpërpjetë.
- KRYESHËRBËTOR** m. 2. keq. Ai që vihet kokë e këmbë në shërbim të dikujt dhe zbaton me zell e shkathtësi të veçantë urdhrat e tij. Kryeshërbëtor i imperializmit.
- KRYETHATË** mb. keq. Që nuk kupton dot a nuk merr vesh, që nuk i hyn gjë në kokë, i trashë nga mendja; trutharë.
- KRYQ** m. \* Puthi kryqin iron. shih te PUTH. I puthi kryqin dikujt iron. shih te PUTH.
- KTHEHEM** vetv. \* S'kthehet prapa dikush shih te PRAPA. Kthehet (shkon) nga të fryjë era shih tek ER/Ë,~A I. Shkoi (vajti) për lesh e u kthye (doli, erdhi) i qethur fj. u. iron. shih te LESH,~I. Nga lëviz qafa, kthehet koka fj.u. shih te QAF/Ë,~A.
- KUÇEDËR** f. 2. bised., keq. Grua zemërligë dhe e pashpirt, e vrazhdë dhe gjuhustër, që zihet vetë me të gjithë e fut në sherr edhe të tjerët. 3. fig. keq. Shtet me synime pushtuese e skllavëruese, fuqi agresive, shkatërrimtare e gjakatare, përbindësh. Kuçedra naziste (fashiste).
- KUFOMË** f. 4. fig. keq. Njeri që vetëm sa për sy e faqe e ka në dorë pushtetin në një vend; qeveritar i lartë që i ka ditët të numëruara a që mezi mbahet në fuqi me ndihmën e të huajve. Kufomë politike.
- KUKUDH** m. 2. keq. Njeri i lig, njeri shpirtkeq, lugat. U hyri kukudhi në shtëpi.
- KULLË** f. \* Kulla me gjizë shih te GJIZ/Ë,~A. Është mbyllur në kullën e fildishtë keq. jeton e merret me punë krijuese, duke qenë krejt i veçuar e i shkëputur nga jeta e gjallë e popullit (për një shkrimtar, artist a studiues).
- KULLOT** kal. 3. fig. bised. iron. I jap dikujt të hajë e ushqej. E ka kullotur i ati tërë jetën. I kullot hunda lart iron. shih te HUND/Ë,~A.
- KUMBULL** f. \* Fëmijët (djemtë) hanë kumbulla (thana), pleqve u mpihen dhëmbët iron. shih te MPIHEM.
- KUNGULL** m. a) iron. ende pa u rritur mirë ose pa fituar përvojën e duhur fillon të shesë mend, të mburret e të krekoset para të tjerëve; b) keq. e kishte mik dikë, por ka filluar t'i bëjë keq (thuhet kur dy miq a shokë prishen e fillojnë të dëmtojnë njëri-tjetrin). Flet hudhër në kungull shih te HUDH/ËR,~RA. Rroftë sa kungulli në brymë! iron. shih te BRYM/Ë,~A. U dogj nga kungulli (nga qulli) e i fryn edhe kosit. fj. u. shih te QULL,~I. Nuk mbahen dy kunguj
- KUPË** f. 9. fig. bised., keq. Vesi i të pirit alkool; rakia. Ishte dhënë pas kupës. Nuk e la kupa.
- KUQ** kal. 4. fig. (me trajta të shkurtra të përemrit vetor në r. dhanore e kallëzore). Ma punoi, ma ngjeshi, ma skuqi, më hoqi një vërejtje të rëndë. Ia kuqi keq. Mirë ia bëri që ia kuqi.
- KUQ** mb. \* Kur të këndojë qyqja e kuqe (nga bishti) iron. shih te QYQ/E,
- KUR** Ka të drejtë ai, kur e qasëm ne ... iron.
- KURDIS** kal. 2. fig. bised., keq. Nxit a shtyj një njeri kundër dikujt, e bëj dikë që të flasë a të veprojë ashtu siç dua unë për një qëllim të caktuar. 3. fig. keq. Organizoj me paramendim një komplot, intriga etj. kundër dikujt, thur. Kurdisin plane (komplete, intriga, provokacione).
- KURDISUR** mb. 2. fig. bised., keq. I nxitur a i shtyrë nga dikush. Ishte i kurdisur. 3. keq. Që është bërë me paramendim, i përgatitur a i sajuar që më parë për t'ia arritur një qëllimi të caktuar. Lojë e kurdisur. Mbledhje e kurdisur. Proces i kurdisur.
- KURESHTAR** m. 2. keq. Ai që është i prirur të dijë gjithçka, të marrë vesh edhe hollësira të parëndësishme edhe për gjëra që nuk i përkasin e nuk kanë të bëjnë me të; ai që ka kureshtje të tepruar.

- KURESHTAR** mb. 2. keq. Që ka kureshtje të tepruar. Plakë kureshtare. Mos u bëj kureshtar!
- KURESHTJE** f. 2. keq. Dëshirë e tepruar, prirje e sëmurë e dikujt për të ditur gjithçka, për të marrë vesh edhe hollësira të parëndësishme, sidomos për gjëra që nuk i përkasin e nuk kanë të bëjnë me të. S'e lë kureshtja të qetë.
- KURSENAC** mb. keq. Kurnac.
- KURRIZ** m. Ia zbuti kurrizin (shpinën, brinjët) keq. shih te ZBUT. Ia bëri kurrizin (shpinën) më të butë se barkun keq. e rrahu shumë, e zhdëpi në dru.
- KUSHEDI** ndajf. 5. kryes. iron. Përdoret kur flasim për diçka që nuk del ose nuk është në të vërtetë aq e madhe, aq e mirë etj. sa pandehet ose sa thuhet. Kushedi se ç'na tha! Kushedi se ç'kujton! Kushedi se ç'bëri! Kushedi (se) çfarë! Kujton kushedi se ç'është!
- KUTI** f. \* I mbyllur në kuti keq. i veçuar nga të tjerët, i ndarë (për njerëzit që nuk përzihen me të tjerët e shikojnë vetëm punën e tyre).
- KUVEND** m. \* Kuvendi Popullor organi më i lartë i pushtetit shtetëror, mbajtës i sovranitetit të popullit dhe të shtetit dhe i vetmi organ ligjvënës; mbledhja e përfaqësuesve të popullit të zgjedhur në këtë organ; ndërtesa ku mbledhet e zhvillon veprimtarinë e vet ky organ. S'ha kuvend dikush nuk flitet dot me të, nuk i dëgjon fjalët e të tjerëve, nuk merr vesh, nuk bindet. Kuvend lajthish keq. shih te LAJTHI, ~A.
- KUVLI** f. 2. keq. Kthinë e vogël dhe pa dritë, zakonisht në katin përdhes të një shtëpie; vend i ngushtë e i mbyllur, ku të zihet fryma. Banonte në një kuvli. U mbyll në një kuvli.
- KUZHINË** f. 3. fig. keq. Aparat që organizon e përgatit fushata propagandistike, trillime e intriga për qëllime të caktuara. Trillime të kuzhinës imperialiste.
- LABËRQAR** mb. keq. 1. Që kërkon të zhvatë sa më shumë nga të tjerët e të rrojë në kurriz të tyre, zhvatës, qelepirxhi.
- LAJ** kal. \* Të lan e të lyen keq. në sy të bën lajka dhe pas krahëve të bën të keqen, është me dy faqe. Laje gojën mirë (me uthull)! iron. matu mirë para se të flasësh për dikë, nuk je i denjë për ta zënë në gojë emrin e dikujt.
- LAJKAMADH** mb. 1. keq. Që të bën shumë lajka, që të lajkaton tepër. Njeri lajkamadh.
- LAJKATAR** m. keq. Ai që i bën lajka dikujt për të nxjerrë ndonjë përfitim për vete, lajkës. Lajkatar i madh. Lajkatarët e oborrit mbretëror.
- LAJKATAR** mb. keq. 1. Që të bën lajka, që të flet me lajka; që shpreh lajka; lajkatues. Njeri lajkatar. Fjalë lajkatare. Me zë lajkatar. 2. Që bën ledha, ledhatar; lozonjar. Vajzë lajkatare.
- LAJKATARE** f. keq. Fem. e LAJKATAR, ~I.
- LAJKATOJ** kal. 1. keq. I bëj lajka dikujt, për ta marrë me të mirë dhe për të nxjerrë ndonjë përfitim prej tij, i them fjalë lajkatuese, e marr me lajka.
- LAJKATUES** mb. 1. keq. Që i bën lajka dikujt, që e lajkaton; që shpreh lajka. Njeri lajkatues.
- LAJKAXHI** m. bised. keq. Lajkës, lajkatar, lajkatues.
- LAJKËS** m. keq. Lajkatar. Lajkësi të lan e të lyen. Lajkësi me gojë të lan e me dhëmbë të çan. fj. u.
- LAJKËS** mb. keq. Lajkatar, lajkatues. Njeri lajkës. Grua lajkëse.
- LAJKËSE** f. keq. Fem. e LAJKËS, ~I.
- LAJTHI** f. bot. \* Kuvend lajthish keq. punë e fshehtë, marrëveshje që bëhet fshehurazi.
- LAK** m. I drejtë si laku iron. dredharak, gënjeshtar e mashtrues, i drejtë si drapri. Flet pa leqe flet drejt, nuk dredhon, nuk i shtrembëron gjërat, thotë të vërtetën. Laku i qafës përb. tërkuza që mbanin gratë për ngarkesë. Me lak në qafë

- LAKMI** f. 1. keq. Dëshirë e madhe dhe e pangopur për ta pasur vetë diçka a dikë, etje e pashuar për diçka; synim i padrejtë për të pasur diçka me çdo mënyrë.
- LAKMOJ** kal. 1. edhe jokal. keq. Kam dëshirë të madhe e të pangopur për ta pasur vetë diçka a dikë; kam synime të padrejta për të pasur diçka me çdo mënyrë; e teproj në diçka (në të ngrënë etj.), tregohem i pangopur. Lakmon në të ngrënë. Nuk ka lakmuar asnjëherë pas parasë. Ma lakmon zemra. Ç'i lakmoi që e mori? Gjithnjë e kanë lakmuar atë vend.
- LAMASH** mb. bised. 3. keq. Që kërkon të hajë e të pijë në kurriz të të tjerëve, që i pëlqen qelepiri.
- LAMASHËRI** f. keq. 1. Sjellja e njeriut lamash; të qenët qelepirxhi; rrugaçëri. 2. përmb. Tërësia e njerëzve lamashë. U mbloodh lamashëria.
- LAPER** mb. bised. keq. 1. Leckaman. 2. shar. Që sillet rrugëve e flet fjalë të ndyra, rrugaç; gojëndyrë, gojëleshuar. Djalë laper. Grua laperë.
- LARASKË** f. zool. \* E ka sjellë laraska iron. nuk dihet se kush e ka sjellë (një send a një lajm).
- LARGKËTEJ** m. euf. Djalli, qoftëlargu.
- LARGNESH** m. euf. Djalli, qoftëlargu.
- LARGQOFTË** m. euf. Djalli qoftëlargu, largneshi.
- LARO** f. 2. fig. keq. Njeri i pabesë e tradhtar; ai që i shërben si qen një tjetri për të përfituar diçka prej tij, ai që e shet veten për një kockë, zuzar. Larot e Ballit Kombëtar
- LART** I kullot hunda lart iron. shih te HUND/Ë,~A. E mban (e ka) hundën lart (përtpjetë) iron. shih te HUND/Ë,~A. E mban (e ka) kokën lart b) keq. është mendjemadh. I rrihte dyfeku lart dikujt keq. shih te DYFEK,~U.
- LARUSHK** m. \* Kur të bëjë larushku rrush iron. kurrë, asnjëherë.
- LATË** I f. \* Si lata, sëpata keq. njësoj janë, si njëri ashtu edhe tjetri.
- LECKË** f. 3. fig. keq. Diçka fare pa vlerë, njeri a gjë që ka humbur çdo vlerë. Iu duk vetja leckë.
- LEDH** I m. \* S'i hedh dot ledh punës edhe poh. nuk e rregullon dot, nuk gjen dot një zgjidhje të drejtë e të qëndrueshme për një çështje. Zuri ledhin (përruan) keq. shih te ZË.
- LEH** jokal. \* Leh në hënë shih te HËNË,~A. Qeni leh atje ku ha fj. u. keq. shih te QEN,~I.
- LEJ** jokal. \* ç'len prej maces (ç'pjell macja), gjuan minj fj. u. keq. shih te MAC/Ë,~JA. Djali pa lerë e djepi (feshja) blerë iron. shih Peshku në det, tigani në zjarr te PESHK,~U.
- LEPE** pasth. bised. \* Ka lepe dikush është i bindur e i dëgjueshëm, i dëgjon të tjerët. Me lepe e me peqe edhe keq. gati për çdo gjë, duke shërbyer pa kundërshtim (thuhet zakonisht për dikë që nuk kundërshton kurrë e u përulet të tjerëve).
- LEPITKË** f. \* Iu bë lepitkë dikujt keq.
- LEPUR** m. Zuri (kapi) qeni një lepur mospërf., iron. shih te QEN,~I. Një herë shkoi lepuri mbi urë edhe iron. shih tek UR/Ë,~A. I. Lepuri në mal e vala (kusia) në zjarr fj. u. iron. peshku në det e tigani në zjarr.
- LEROSEM** vetv. U leros keq.
- LESH** as. \* La leshtë (kockat, lëkurën) keq. shih te KOCK/Ë,~A.
- LESHEM** vetv. 4. fig. keq. Mbuloj a fsheh veprimet e këqija, fshihem. Kërkonte të leshej.
- LESHTË** f. kryes. 2. vet. nj. euf. Sëmundja e tokës, epilepsia. I ra e leshta.
- LETËR** f. \* Kështjellë (kala) prej letre (prej karte) keq. shih te KËSHTJELLË,~A. Letër (pusullë) bakalli keq. shih te BAKALL,~I.

- LË** kal. I la nam të keq. I la (i bëri) glasën dikujt thjeshtligj. mospërf. iku pa pritur e fshehurazi nga dikush dhe as që u bë merak për të; mori ç'mundi: përfitoi sa mundi e iku papritur. I la hijen dikujt iron. iku, u largua papritur prej dikujt. La kockat (leshtë, lëkurën) keq. shih te **KOCK/Ë**, ~A. Ia la pendët (puplat) dikujt iron. shih te **PENDË**, ~A I. Shkoi shyta të kërkojë brirët, la edhe veshët fj.u iron. shih te **SHYT**, ~Ë.
- LËKURË** f. 7. bised. keq. Jeta a qenia e dikujt; trupi, vetvetja; jetesa (edhe në disa njësi frazeologjike). Ruan lëkurën e vet. I dhimbset lëkura. Shpëtoi lëkurën. La lëkurën diku mospërf. Sa para i bën (i vlen) lëkura edhe iron. sa vlen, sa i zoti a sa trim është (zakonisht për dikë që e mbivlerëson vetveten). Ia bëfshin lëkurën def! mallk., thjeshtligj. shih te **DEF**, ~I.
- LËNG** m. \* Lëng groshe mospërf shih te **GROSH/E**, ~A. Lëng (farë) hardalli iron. shih te **HARDALL**, ~ I. Lëng stërlëngu (lëng pas lëngu) mospërf shumë i largët nga lidhjet e gjakut ose nga lidhjet e tjera. Ia ka pirë lëngun dikujt mospërf. shih te **PI**. Lëre lëngun e hyrë në thela! iron. thuaje copë diçka!, mos i bjer anës e anës!
- LËNGURINË** f. zakon. 2. keq. Lëngëtyrë.
- LËNURUR** mb. 2. edhe fig. Që është bërë fije-fije a copë-copë, që është bërë fërtele; që është gërvishtur shumë; i rrahur keq. Me rroba të lënurura. Me fytyrë të lënurur. Si qen i lënurur.
- LËPIHEM** vetv. 3. fig. keq. Krihem e ndreqem në mënyrë të stërholluar; pispillosem. 4. fig. keq. I vij rrotull dikujt e i bëj lajka me përlulësi; i përlulem shumë dikujt për të përfituar diçka a i lutem shumë për të më bërë një të mirë; kam shumë dëshirë të shtie në dorë diçka. Nuk i lëpihet askujt. U lëpihej bejlerëve. I lëpihej pasurisë (prikës). s'është nga ata që lëpihen. 5. fig. keq. Kam marrëdhënie shumë të ngushta me dikë; puthem. Është lëpirë me fashistët (me ballistet).
- LËPIJ** kal. 4. fig. keq. E tërheq a e marr prapa diçka jo të mirë që kam thënë më parë. b) keq. është i pacipë, s'ka turp fare. I lëpin (i puth) këmbët (çizmet) dikujt keq. përlulet shumë para dikujt, i bëhet lepitkë dikujt, i bëhet baltë. Lëpin sahanët (çanakët) e dikujt keq. i shërben verbërisht e me përlulësi dikujt, rron me lëmoshën e tij dhe bën çfarë të kërkojë ai.
- LËPIRË** mb. 2. Që është shtruar mirë pas kokës (për flokët); që i ka flokët të shtruar mirë dhe të drejtë; keq. i pispillosur. Me flokë të lëpirë. Njeri i lëpirë.
- LËPIRËS** m. 1. keq. Ai që kërkon të hajë e të pijë qyl tek të tjerët, ai që rron në kurriz të të tjerëve duke u bërë lajka, sahanlëpirës. Lëpirës i keq.
- LËPJETË** f. bot. \* E zgjati gjuhën si lëpjetë (si lëpushë) keq. foli shumë e kot, tha gjëra të panevojshme a të pahijshme.
- LËPUSHË** f. \* E zgjati gjuhën si lëpushë (si lëpjetë) keq. shih te **LËPJETË**, ~A.
- LËSHOJ** kal. \* Ia lëshoi (ia liroi) frerin (kapistallin, kapistrën) dikujt keq. e ka lënë të lirë të veprojë si të dojë, nuk e mban më nën një kontroll të rreptë. I lëshon fjalët veresie keq. shih te **VERESIE** 2.
- LËTYRË** f. 6. fig. keq. Fundërria, llumi; diçka krejt e pavlefshme dhe e dëmshme.
- LËVAREM** vetv. 3. fig. keq. I lutem shumë dikujt për diçka, i bëhem baltë; i përlulem e i lëpihem dikujt, duke u hequr si i afërt, si i bindur ose si njeri i tij. Pas shpine të shan e në sy të lëvaret.
- LËVDATËMADH** mb. keq. Që lëvdohet shumë përpara të tjerëve, që mburret shumë. Njeri lëvdatëmadh.
- LËVERE** f. 4. fig. keq. Diçka fare pa vlerë, njeri a gjë që ka humbur çdo vlerë. U duk lëvere përpara të tjerëve. E bëri lëvere dikë e shau keq, ia nxori bojën, e bëri leckë.

- LËVIRË** f. 2. fig. keq. Lutje me shumë përlulesi, që i bëjmë dikujt për t'i kërkuar diçka.
- LËVIZ** kal. 10. jokal. bised., keq. Nuk ka qëndrim të mirë moral, është e lëvizshme, e luan bishtin (për femrat). \* Lëviz (dredh, përdredh, luan) bishtin keq. shih te BISHT, ~I.
- LËVIZSHËM** mb. 5. fig. bised. keq. Që ka qëndrim jo të mirë moral, bishtdredhur (për femrat).
- LIBRUSHKË** f. 2. keq. Libër me përmbajtje të keqe ose pa vlerë. Librushkë borgjeze.
- LIDHEM** vetv. \* U lidha pas bishtit të dikujt keq. shih te BISHT, ~I.
- LIG** mb. \* Farë e ligë (e keqe) shar. shih te KEQ (i), ~E (e). Në vend të lig (të keq) euf. në organet seksuale të mashkullit, në vete.
- LIGSHT** ndajf. 1. Në gjendje të keqe shëndetësore, keq. Ishte ligsht. 3. Në gjendje të keqe shpirtërore; në gjendje shumë të vështirë, në hall të madh, shumë ngushtë; keq. Ka qenë ligsht. E zuri ligsht. 5. Rrëmujë; ters, keq. Punët i shkojnë ligsht.
- LIGJ** m. \* Bën ligjin keq. vendos çdo gjë vetë pa pyetur asnjëri dhe pa përfillur rregullat e caktuara, ç'është ai bëhet. E ka ligjin në të shpatës shih te SHPAT/Ë, ~A.
- LIMER** m. 4. fig. keq. Vend i rehatshëm dhe i qetë që zë dikush, qoshe. Ka gjetur limer.
- LIND** jokal. \* I tregoi se nga lind dielli iron. e rrahu; e dënoi rëndë.
- LIPS** jokal. bised. keq. 1. shih LIPSEM 1. Lipsi nga fshati. 2. kal. E flak tutje dikë, e përzë, e dëboj, e shporr. E lipsi nga shtëpia.
- LIPSEM** vetv. bised. keq. 1. Largohem nga një vend e shkoj diku; kryes. veta III zhduket, shporret, qërohet. U lips një muaj nga shtëpia. M'u lips nga sytë. Lipsu që këtej! 2. Pës. e LIPS. \* Lipsur qoftë!
- në djall të vejël, s'ke ç'e do, s'ia vlentë mundohesh për të.
- LIRI** I f. \* I ka dhënë liri gjuhës keq. flet shumë e pa u menduar mirë, nuk i vë fre gjuhës.
- LIROHEM** vetv. 10. bised. euf. Bëj fëmijë; lind (për gratë). U lirua gruaja (nusja). 11. euf. Dal jashtë, bëj nevojën. Shko lirohul!
- LIROJ** kal. Ia liron (ia lëshoi) frerin (kapistallin, kapistrën) dikujt keq. shih te LËSHOJ.
- LIVADHIS** jokal. 2. fig. keq. Endem kot më kot; veproj ashtu si dua vetë pa përfillur fare të tjerët, nuk i zbatoj rregullat e kërkesat e caktuara në një punë. Livadhiste lirisht (sipas qejfit). Nuk e lanë të livadhiste si të donte. Livadhiste poshtë e lart.
- LODËR** f. 5. euf. shih LODËRZ, ~A 2. \* Luan lodrën (lojën) e dikujt shih te LUAJ. Iu bë barku lodër (daulle, kacek) shih te DAULL/E, ~JA. Hedh këmbët (luan këmbët, hedh vallen, kërcen) siç bie lodra (siç bie daullja, sipas daulles) keq. shih te DAULL/E, ~JA.
- LODËRZ** f. 2. euf. Sëmundja e tokës, epilepsia. I ra (e zuri) lodërza.
- LOPË** f. \* Kur të flasin lopët iron. kurrë. E ka lëpirë lopa shih te LËPIJ. Ia ka lëpirë lopa trutë (mendtë) dikujt tall. shih te LËPIJ.
- LOZONJAR** mb. 3. fig. keq. E lëvizshme, bishtdredhur (për femrat).
- LUAJ** jokal. \* Luan arushë me dikë keq. shih tek ARUSH/Ë, ~A. Luan (dredh, përdredh, lëviz) bishtin keq. shih te BISHT, ~I. I luan (i tund) bishtin dikujt keq. shih te BISHT, ~I. Luaj buzët flas; flas ngadalë e pa u ndier shumë. Luaj cemic shih te CICMIC, ~I. Luaj cingël me dikë shih te CING/ËL, ~LI. Luaj cingëlthi me dikë shih te CINGËLTHI. Luan (tund) derën mospërf. shih te DER/Ë, ~A. E luan gishtin (e pushkës) b) keq. nxit dy vetë kundër njëri-tjetrit, ndez sherrin.

- LUAJTSHËM** mb. 4. fig. bised. keq. Që lëviz sipas kushteve e rrethanave, i lëvizshëm, i paqëndrueshëm.
- LUAN** m. \* Pjesa e luanit libr. iron. pjesa më e madhe e më e mirë e diçkaje, që e merr më i forti për vete pa përfillur të tjerët
- LUBI** f. 2. fig. keq. Njeri që ha shumë, njeri i pangopshëm. \* E ka lubinë në bark keq. ha shumë, është i pangopshëm.
- LUGAT** m. 2. fig. keq. Njeri shumë i shëmtuar në pamje, që u kall tmerrin njerëzve; njeri i keq, që u bën dëm të tjerëve. \* Bisht lugati thjeshtligj. ters, keq. Vampiri e njeh lugatin fj. u. shih te VAMPIR, ~I.
- LUGË** f. \* Me lugë në brez keq. vetëm për të ngrënë; i gatshëm për të ngrënë kudo e kurdoherë në kurriz të të tjerëve, qelepërxihi. I bie maces me lugë mospërf. është në moshë ende të vogël. Hyn (futet) si luga në pilaf keq. merr pjesë menjëherë në diçka; ndërhyr menjëherë edhe atje ku nuk i takon, fut hundët. I dhënça ujë me lugë! mallk. u bëftë për vdekje, shkoftë në buzë të varrit! Kërkon të hajë me dy lugë keq. kërkon të përfitojë nga të dy krahët, përpiqet të nxjerrë përfitime për vete duke e pasur mirë me të dy palët. Kërkon të hajë me lugë të madhe keq. kërkon të përfitojë nga diçka më shumë nga sa i takon; është lakmitar. I mbeti luga në pilaf iron. u turpërua, mbeti me turp. I mbeti luga në qull iron. nuk i eci fjala, nuk ia dëgjuan fjalën që tha, nuk ia vunë veshin. Me lugë të kon, me bisht të verbon keq. është njeri me dy faqe, shumë i lig e dinak, në sy të ndihmon e pas krahëve të dëmton.
- LUKUNI** f. 2. fig. keq. Turmë njerëzish të harbuar, që sulen kundër të tjerëve me synime keqbërëse. Lukuni armiqsh (nazistësh).
- LULE** f. 8. vet. euf. Të përmuajshmet e grave, zakonet, gjakrat. Ishte me lulet. 9. vet. euf. Organet seksuale të mashkullit; herdhet. Lulet e dashit. Bredh (shkon, shëtit) lule më lule dikush keq. është tepër i dhënë pas vajzave dhe nuk ka dashuri të qëndrueshme. Lulja e mirë mjek. veter. euf. plasja.
- LULËKUQE** f. 2. vet. euf. Të përmuajshmet e grave, gjakrat, zakonet.
- LUM** mb. 3. si em. ~E, JA (e) f. euf. Lia. I doli e lumja. E preu e lumja.
- LUME** f. vet. euf. Zanat. Të lumet e natës. kr. pop.
- LUMË** m. \* Ai i lumit (i lumit) euf. shejtani, djalli, i paudhi. U bë lumë mospërf. u deh shumë u bë tapë. E hodhi lumin (përruan, vaun, hendekun) shih te HEDH 20.
- LURTIM** m. 3. keq. Mashtrim.
- LURTOJ** kal. 2. keq. E mashtror dikë.
- LUSTËR** f. 3. fig. keq. Zbukurim i jashtëm i diçkaje, që ka për qëllim të fshehtë të vërtetën e të mashtror të tjerët, shkëlqim i rremë. Lustër e rente. Lustër demagogjike.
- LUSTROJ** kal. 2. fig. keq. E paraqit diçka me ngjyra të bukura, e zbukuroj për të fshehur të vërtetën e për të mashtruar të tjerët. E lustroj gjendjen.
- LUSTRUAR** mb. 2. fig. keq. Që është paraqitur me ngjyra të bukura, që është zbukuruar për të fshehur të vërtetën e për të mashtruar të tjerët.
- LUSTRUES** m. 3. fig. keq. Ai që e paraqit diçka me ngjyra të bukura, ai që e zbukuron diçka për të fshehur të vërtetën e për të mashtruar të tjerët.
- LUSH** m. 2. fig. keq. Njeri i papërmbajtur, ai që bën si i tërbuar.
- LUSHË** f. 2. fig. keq. Grua e papërmbajtur, ajo që bën si e tërbuar; bushtër.
- LYEJ** kal. 3. fig. keq. I vë njollë diku, e përlyej; e fëlliq. I leu keq (kokë e këmbë). 4. fig. keq. Fsheh thelbin e vërtetë të diçkaje duke e paraqitur të zbukuruar e me tjetër ngjyrë. \* Të lan e të lyen keq. shih te LAJ. Ia leu dorën (duart) diku keq. i dha diçka që të mos e pengonte në qëllimet e tij, të mos ia zbulonte të



- këqijat, t'i mbaronte një punë jashtë rregullave etj. I ka lyer duart në diçka ka marrë pjesë në një punë të keqe është përlyer, ka gisht. I ka lyer rrotën dikujt keq. i ka dhënë mitë që t'i mbarojë një punë, t'i plotëson një kërkesë jashtë rregullave etj. E lyen me sheqer diçka shih te **SHEQER**, ~I. I ka lyer (i ka bërë) duart me gjak shih te **GJAK**, ~U I.
- LYER** mb. 3. fig. keq. Që është njollosur nga ana morale; që ka marrë pjesë në diçka të keqe, i përlyer, i fëlliqur. Njeri i lyer. Rrinte si i lyer.
- LYHEM** vetv. 3. fig. keq. Marr pjesë në një punë të keqe; i vë njollë vetes, përlyhem nga ana morale; fëlliqem. Është lyer keq. U lye edhe ai në atë punë.
- LYRËT** mb. 3. fig. keq. I paturp, i pacipë; i ndyrë. Njeri i lyrët.
- LYSHTËR** f. 3. fig. zakon. keq. Shumicë e madhe njerëzish, turmë e madhe, mizëri, rrëmet.
- LLACKOS** kal. bised. 2. keq. E lyej shumë e në mënyrë të pahijshme me të kuq a me diçka tjetër në fytyrë etj. (zakon. për gratë). E llackosi në faqe.
- LLACKOSEM** vetv. bised. 2. keq. Lyhem shumë e në mënyrë të pahijshme me të kuq a me diçka tjetër në fytyrë etj. (zakon. për gratë). Ishte llackosur e s'shihej dot me sy.
- LLACKOSUR** mb. bised. 2. keq. I lyer shumë e në mënyrë të pahijshme me të kuq a me diçka tjetër në fytyrë etj. (zakon. për gratë). Me fytyrë të llackosur.
- LLAÇKË** f. bised. 3. keq. Grua a vajzë budallaqe.
- LLAGAP** m. bised. 2. Nofkë. Llagap i keq. I kanë ngjitur një llagap.
- LLAPAN** mb. 2. fig. keq. Që llap shumë, llafazan.
- LLAPOJ** kal. 2. jokal. keq. Flas shumë e kot, llap.
- LLASTOJ** kal. 1. Përkëdhel jashtë masës (sidomos të vegjlit), duke ua hapur shumë syrin e duke i mësuar kështu keq. I llastonte fëmijët. Mos i llasto shumë.
- LLOKMË** f. 2. fig. keq. Diçka e dobishme dhe e çmueshme, që merr dikush zakonisht pa e merituar; përfitim i padrejtë; thelë. I dhanë (mori) një llokmë të mirë. Ishte mësuar me llokma. Nuk ka gjithnjë llokma.
- LLOKMËMADH** mb. keq. Që është mësuar të zhvatë sa më shumë, që lakmon të nxjerrë përfitime të mëdha. Njeri llokmëmadh.
- LLOSH** mb. keq. 1. Që s'e mban veten në rregull, që s'kujdeset për veshjen e vet, shkatarraq; që vesh rroba tepër të gjera, që i varen rrobat. Djalë llosh. 2. I trash nga mendja, budalla; i marrë. Është llosh.
- LLUPASH** mb. keq. 1. Llupës, grykës. Njeri i llupash.
- LLUQ** mb. 2. fig. keq. I plogët; i qullët, i mefshtë; i trashë nga mendja. Ishte fare lluqe. 3. keq. Përd. em. sipas kuptimit 2 të mbiemrit.
- LLURBËTIRË** f. 5. fig. keq. Fundërria e njerëzve; diçka krejt e pavlefshme ose e dëmshme; llum. Llurbëtira e shoqërisë së vjetër.
- MACE** f. 2. shar. keq. Grua a vajzë e egër dhe grindavece; grifshë. Është një mace ajo! I bie maces me lugë mospërf. shih te **LUG/Ë**, ~A. Do të nxjerrë prush me këmbët e maces keq. shih te **PRUSH**, ~I. s'i ha macja cironkat!? iron. shtiret e bën gjoja se nuk i pëlqen diçka. s'e ka mbytur macen iron. shih te **MBYT**. Ia ha macja bukën në dorë (ia merr macja bukën nga dora) dikujt mospërf. është fare i pazoti, s'është për asnjë punë, është fare qyqar. ç'len prej maces (ç'pjell macja), gjuan minj fj. u. keq. si është prindi, ashtu është edhe fëmija (thuhet kur fëmija ndjek rrugën e gabuar të prindit ose merr veset e

- tij). Nuk pi macja uthull iron. shih tek UTHULL,~A.
- MADH** mb. 10. Që punon e vepron me shumë zell: keq. që e bën diçka me tepri, që a kalon masën a kufirin. 14. keq. Që ka karakter tepër mburrës, lavdërues, premtues, kërcënues etj. nga jashtë, por nga përmbajtja është i zbrazët; i fryrë. Flet me fjalë të mëdha. \* Batall i madh (fort) iron. shih te BATALL,~I. Fle të madhin euf. mospërf. shih te FLE. Gajle e madhe iron. shih te GAJL/E,~JA. Gjumi i madh (i përjetshëm) euf. shih te GJUM/Ë,~I. E zëntë gjumi i madh! mallk. shih te GJUM/Ë,~I. Nevoja e madhe euf. shih te NEVOJ/Ë, ~A 4. Ujë të madh (e trashë) euf. shih tek UJ/Ë,~I 2. Punë e madhe! mospërf. shih te PUN/Ë,~A. Kërkon të hajë me lugë të madhe keq. shih te LUG/Ë,~A.
- MADHEM** vetv. 2. keq. Mbahem më të madh, më rritet mendja e mburrem; krenohem.
- MADHËROHEM** vetv. 2. keq. Mbahem më të madh, mburrem; krenohem.
- MADHËSHTI** f. 3. keq. Të mbajturit më të madh, kryelartësi; mendjemadhësi. Ishte verbuar nga madhështia. I kishte hyrë madhështia dikujt i ishte rritur mendja.
- MADHËSHTOHEM** vetv. 2. keq. Mbahem më të madh; mburrem. Mos u madhështoj kot.
- MADHOJ** kal. 3. keq. I rrit vlerën a rëndësinë dikujt ose diçkaje; e mburr dikë më shumë sesa e meriton a sesa duhet, e lëvdoj tepër. Ia madhuan nusen. Mos e madho, se e njohim.
- MAGJE** f. I ka zënë magjja kokën është në hall të madh, është shumë ngushtë, e ka punën keq.
- MAJDANOZ** m. bot. \* Në çdo gjellë majdanoz iron. thuhet kur dikush, me vend e pa vend, merr pjesë në të gjitha punët a çështjet ose kur diçka përdoret për shumë punë edhe kur s'është nevoja.
- MAJË** f. E kam në majë të hundës dikë a diçka keq. shih te HUND/Ë,~A. I arrijnë sytë gjer te maja e hundës keq. shih te HUND/Ë,~A. Breshri e rreh e hunda me majë iron. shih te HUND/Ë,~A. Vëri majat (gishtat) nga (ke) thembrat! iron. shih te THEMB/ËR, ~RA.
- MAJM** kal. 3. fig. bised., keq. E pasuroj dikë duke i dhënë mall e para, i krijoj mundësi a i jap rast të fitoj shumë para të mëdha, e pasuroj shumë. E majmi me para (me të mira).
- MAJMEM** vetv. 2. fig. bised., keq. Pasurohem shumë, fitoj shumë para dhe vë kapital. U majm me para. Majmen kapitalistët në kurriz të punëtorëve.
- MAJMË** mb. 3. fig. bised., keq. Që ka vënë shumë pasuri, pasanik. Shtresat e majme. \* Flet fjalë të majme flet fjalë të mëdha. Pula e botës duket më e majme fj. u. iron. shih te PUL/Ë,~A. Zorra e majme bised. zorra e trashë.
- MAJMUN** m. zool. 2. bised., keq. Njeri shumë i shëmtuar në fytyrë; njeri me qime të gjata e të dendura, njeri leshtor.
- MAJMUNËRI** f. keq. 1. Sjellje e veprime si prej majmuni; ngërdheshje e shëmtuar e fytyrës. 2. Imitim i verbër i dikujt.
- MAJTË** mb. 4. keq. Që hiqet si revolucionar sa për sy e faqe, që fsheh me fraza revolucionare thelbin e vet mikroborgjez e oportunist (për parti e grupe politike social demokrate në vendet borgjeze); majtist; kund. i djathtë. Oportunistët e majtë. Parulla të majta.
- MAKUT** mb. keq. 1. Që nuk ngopet në të ngrënë, i pangopur, llupës, grykës. Njeri makut. 2. Që ka lakmi të pangopshme për mall e para, për fitime etj.
- MAKUTËRI** f. keq. 1. Të qenët makut, grykësi. 2. Lakmi e tepruar për mall e para, për fitime etj.
- MAL** m. Lepuri në mal e vala (kusia) në zjarr fj. u. iron. shih te LEPUR,~I.

- MALL** I m. \* Nuk më merr malli për dikë mospërf. nuk dua të di fare për të, nuk dua t'ia shoh fytyrën. E preu malli (barku) për dikë a për diçka iron. shih te **PRES** I. Rrallë e për mall shih te **RRALLË** 2.
- MALLKUAR** mb. 3. si em. ~I (i) m. euf. Djalli, shejtani.
- MANIPULIM** m. libr. 2. fig. keq. Mënyrë e stërholluar e dredharake për të mashtruar dikë, duke e përpunuar vazhdimisht që të sillet e të veprojë në një mënyrë të caktuar.
- MANIPULOJ** kal. libr. 2. fig. keq. E vërtit dhe e sjell rrotull dikë siç dua vetë me gjithfarë mashtrimesh e dredhish, e përpunoj dikë për ta bërë të sillet e të veprojë siç dua unë.
- MARKË** II f. 2. fig. bised., keq. Njeri çfarëdo, dikush; lloj, farë (për njerëzit). E njohim se çfarë marke është ai.
- MARR** kal. Mori rrethin e daulles iron. shih te **RRETH**, ~I.
- MASHË** f. 2. fig. zakon. keq. Njeri që përdoret nga dikush si vegël për një qëllim të caktuar, vegël. Nuk bëhet masha e të tjerëve. Ishte (u bë) masha e pushtuesve. I rrinte mashë dikujt ishte gati t'i shërbente si vegël. Kur ka mashën, pse të djegë dorën? fj. u.
- MATEM** vetv. Matet me hijen (me diellin) e mëngjesit (e mbrëmjes) keq. shih te **MËNGJES**, ~I. Matu me hijen tënde! shih te **HIJ/E**, ~A. Matet me hijen e vet shih te **HIJ/E**, ~A.
- MATERIALIST** m. 2. bised., keq. Ai që punon, vepron e gjykon duke u nisur gjithnjë a kryesisht nga përfitimi material.
- MATRAPAZ** m. bised., keq. 1. Tregtar i vogël pa dyqan që blen mallra të ndryshme dhe i shet me çmim më të lartë për të nxjerrë fitime duke mashtruar të tjerët. Matrapaz lëkurësh. Ra në duart (në thonjtë) e matrapazëve. E bleu nga një matrapaz.
- MATRAPAZLLËK** m. bised., keq. Puna e matrapazit; veprim e sjellje prej matrapazi; të qenët matrapaz. Matrapazllëk i ndyrë (i poshtër). Bënte matrapazllëqe. Merrej me matrapazllëqe.
- MBAJ** kal. \* Mban një avaz (i bie një [po atij] avazi) keq. shih tek **AVAZ**, ~I. b) edhe keq. është me nam. I mban ison (i bën ison) dikujt keq. shih tek **ISO**, ~JA. I mban konferencë dikujt iron. i flet dikujt gjatë për një çështje a për t'i mbushur mendjen për diçka. Mbage me shëndet iron. shih te **SHËNDET**, ~I. Mbjaj vendin! keq. mos fol, mos ndërhy, mëshoji vendit! E mban bishtin cakërr keq. shih te **CAKËRR**. E mban (e ka) hundën lart (përpjetë) iron. shih te **HUND/Ë**, ~A.
- MBALLOMË** f. bised. 2. fig. keq. Diçka që përdoret për të mbuluar një të metë a një zbrazëti në punë, diçka që shërben për të rregulluar një punë sa për të kaluar radhën, në mënyrë gjysmake e të përkohshme; arnë. Punë me mbaloma. E ndreqën (e rregulluan) me ca mbaloma.
- MBALLOS** kal. bised. 2. fig. keq. Mbuloj ose fsheh me marifet një të metë në punë, arnoj. 3. fig. keq. Ia hedh pa të drejtë dikujt, ia ngjesh, ia lë në derë. Ia mballosi atij tjetrit fajin.
- MBARË** mb. \* Rruga (udha) e mbarë (të qoftë)! iron. i thuhet dikujt që matet të largohet për t'i treguar se nuk kanë nevojë për të dhe se mund të shkojë nga të dojë.
- MBES** jokal. I mbeti luga në qull iron. shih te **LUG/Ë**, ~A.
- MBETURINË** f. kryes. 6. keq. Koncept, mënyrë të menduari, paragjykim a çdo gjë tjetër e huaj e reaksionare, që ka mbetur nga e kaluara dhe ruhet ende në mendjen e ndërgjegjen e njerëzve; njeri që shfaq koncepte të tilla ose është bartës i këtyre koncepteve.

Mbeturinë e vjetër (e huaj). Mbeturina borgjeze (mikroborgjeze, patriarkale, fetare). Njeri me mbeturina. Lufta kundër mbeturinave të së kaluarës. Ka ca mbeturina.

**MBIN** jokal. \* I mbiu në derë keq. i vete shpesh sa e mërzit, i mbeti në derë. Më mbiu në sy mospërf. shih te SY,~RI. I mbiftë ferra në derë! mallk. shih te FERR/Ë,~A.

**MBJELL** kal. \* Mbolli bostan e i dolën kas-travecë iron. ndryshe e mendoi e ndryshe i doli, mendoi për mirë, po i doli keq. \* Mblodhi bishtin përb. u tërhoq, ndenji urtë e s'u ndie më (zakonisht nga frika). I mblodhi (i ngriti, i mori) çoparkat iron. shih te ÇOPARK/Ë,~A. Ia mblodhi ia ngriti, lekat (rraqet) dikujt mospërf. shih te NGRE. Mblodhi (ngriti) lekat (rraqet) mospërf. shih te NGRE. I mblodhi (i ngriti, i ngarkoi) plaçkat edhe iron. shih te PLAÇK/Ë, ~A.

**MBRETËRIM** m. 2. fig. keq. Sundim. Mbretërimi i imperialistëve mbi kolonitë. Mori fund mbretërimi i tyre.

**MBRETËROJ** jokal. 2. fig. keq. Sundoj mbi dikë si një mbret, sillem si mbret. Ai nuk qeveriste, por mbretëronte.

**MBRËMJE** f. \* Matet me hijen (me diellin) e mbrëmjes (e mëngjesit) keq. shih te MËNGJES,~I.

**MBULESË** f. 10. fig. keq. Diçka që shërben për të fshehur fytyrën e vërtetë, për të mbuluar qëllimet e vërteta; maskë. Mbulesë e rreme (demagogjike). Ia hoqi (ia çorri) mbulesën ia hoqi maskën.

**MBULUAR** mb. \* Thëngjill i mbuluar (gacë e mbuluar) keq. njeri i djallëzuar, po që nuk e zbulon veten, njeri që i ka të gjitha nën lëkurë, që vepron nën rrogos; tinëzar, fsheharak.

**MBURR** kal. \* Bufi i mburr zogjtë e tij iron. shih te BUF,~I.

**MBURRACAK** m. keq. 1. Ai që e mburr tepër veten përpara të tjerëve, ai që e

ka zakon të lëvdojë veten vazhdimisht; mburravec. Ishte mburracak i madh.

**MBURRAVEC** m. keq. Mburracak. Mbur-ravec i keq.

**MBURRJE** f. 3. keq. Të mbajturit me të madh duke mbivlerësuar veten dhe duke mos përfillur të tjerët. Flet me mburrje.

**MBUSH** kal. 12. fig. keq. I flas vazhdimisht dikujt dhe e nxit kundër një tjetri, e fryj kundër dikujt. E mbushi me fjalë. E mbushi kundër shokut. Kush e kishte mbushur ashtu! E kishin mbushur të tjerët.

**MBUSHEM** vetv. 11. bised. Mbushu! keq. ik, shporru që këtej, m'u hiq sysh, këput qafën!

**MBYLL** kal. \* Çel e s'mbyll keq. shih te ÇEL. c) euf. vdiq. Mbyll një sy bën ndonjë lëshim, bën sikur nuk i vë re disa të meta e gabime, i lë të kalojnë; tregohet i mëshirshëm e lëshues.

**MBYLLEM** vetv. T'u mbylltë dera! mallk. u shofsh me të gjithë sa ke! Është mbyllur në kullën e fildishtë keq. shih te KULL/Ë,~A.

**MBYT** kal. \* S'e ka mbytur macen iron. nuk e ka treguar forcën që në fillim që t'u shtinte frikën të tjerëve, nuk ia dinë egërsinë që t'i tremben.

**MEGAFON** m. 2. fig. keq. Njeri që i shërben verbërisht dikujt për të përhapur idetë e mendimet e tij. Megafon i imperializmit.

**MEJHANE** f. 2. keq. Kafene a pijetore e mbajtur keq, ku venë lloj-lloj njerëzish, bëhet zhurmë dhe ka shumë tym. Ishte bërë mejhane.

**MEMUR** m. 2. bised. keq. Nëpunës i paaftë e burokrat.

**MEND** f. vet. Nuk i ki mendtë e tij! edhe iron. nuk është aq i zgjuar sa ai! I kishte mendtë në tra (nga trarët, nga qofkat) dikush mospërf. shih te TRA,~U. Ia ka lëpirë lopa mendtë (trutë) dikujt tall. shih te LËPIJ. U plak me një palë mend

- mospërf. nuk ndërroi kurrë mendim, vazhdoi tërë jetën në atë të vetën; nuk u bë më i mençur nga ç' ishte në fillim.
- MENDJE** f. Hajde mendje, hajde! mospërf.. iron. ama ç'mendje më paske! I ka vdekur mendja mospërf. shih te VDES. Doli mendje mbi mendje iron. doli mbi të gjithë, e bëri veten për më të zgjuarin.
- MENDJELARTË** mb. 2. keq. Që mbahet me të madh, kryelartë.
- MERIMANGË** f. \* End si merimanga keq. përpiket e ngre kurthe për të dëmtuar të tjerët prapa krahëve.
- MES** m. \* Mesi i art ë(e mesmja e artë) keq. shih tek ARTË (i,e).
- MESËM** mb. \* E mesmja e artë (mesi i artë) keq. shih tek ARTË (i, e).
- MËLÇI** f. \* Ia vari ujkut mëlçitë në qafë iron. shih te VAR. E ruan si qeni mëlçitë (si qeni mishin) iron. shih te QEN,~I.
- MËNGJARASH** mb. 3. iron. Që hiqet si i majtë në politikë; gjoja i majtë. Parulla mëngjarashe. Prirje (shfaqje) mëngjarashe. Qëndrime mëngjarashe.
- MËNGJES** m. \* Matet me hijen (me diellin) e mëngjesit (e mbrëmjes) keq. e vlerëson veten më shumë se sa është në të vërtetë, është mendjemadh, e mburr veten e nënvlerëson të tjerët.
- MËSOJ** kal. U bë veza të mësojë pulën! iron. 8. I tregoj dikujt se ku ndodhet diçka a se ç'ka ndodhur. I mësoi të rejat e ditës. Hajde, baba, të të mësoj arat! fj. u. iron.
- MËSHOJ** kal. bised. Mëshoji vendit! keq. rri aty e mos fol! mos ndërhy! mbaj vendin!
- MËZ** m. \* Del si mëzi para pelës keq. nuk përmbahet; flet pa radhë, para se të flasin të mëdhenjtë.
- MI** m. \* Ka frikë (trembet) edhe nga miu mospërf. është shumë frikacak. Ç'len prej maces (ç'pjell macja), gjuan minj fj. u. keq. shih te MAC/E,~JA.
- MIELL** m. \* Bukë e një mielli keq. shih te BUK/Ë,~A. E bën drithë e miell mospërf. shih te DRITH/Ë,~I. Mielli nga thesi i botës (i huaj) iron. është punë a vepër e tjetërkujt, s'është vepër origjinale e dikujt; fjalë, mendim etj., që është marrë nga të tjerët. Shto ujë e shto miell mospërf. shih te SHTOJ.
- MIKROBORGJEZ** m. 2. keq. Ai që vë interesin e ngushtë vetjak mbi interesin e përgjithshëm të shoqërisë, që është dhënë pas përfitimeve vetjake dhe përpiket vetëm për mirëqenien e vet; ai që ka mbeturina të një përfaqësuesi të mikroborgjezisë ose ka fituar tipare të tilla. Ishte bërë një mikroborgjez.
- MIKROBORGJEZ** mb. 2. keq. Që është karakteristik për një mikroborgjez, prej mikroborgjezi. Koncept (qëndrim, kuptim) mikroborgjez. Egoizëm mikroborgjez. Sedër mikroborgjeze. Shfaqje mikroborgjeze. Frikë mikroborgjeze.
- MINDER** m. \* Njeri i minderit keq. njeri që ka qejf të rrijë rehat ose të ketë një detyrë të lartë e të rehatshme; njeri i kolltukut.
- MIRË** f. 7. euf. Sëmundja e tokës, epilepsia. E zuri e mira. I raftë e mira! mallk. 8. zool., euf. Nusja e lalës, bukla.
- MIRË** mb. I dha një ryshfet (një bakshish) të mirë. keq. 15. euf., mjek. Përdoret si gjymtyrë e dytë në disa emërtime të pathjeshta që shënojnë sëmundje të rënda e ngjitëse; i bardhë. Kolla e mirë. Lia e miri. Grykët e mira. Fshikëza (lulja) e mirë plasja. Koqe e mirë i thatë. \*Zonjë e mirë euf. shih te ZONJ/Ë,~A.
- MIRË** ndajf. 6. iron. bised. Ashtu si duhet ose ashtu si e meriton (përdoret me kuptim të kundërt nga ai që ka zakonisht kjo fjalë kur dikush vepron keq a kur diçka, bëhet keq). Mirë, besa! Ia punoi mirë! Mirë e gjeti! Mirë ia bënë! \*Laje gojën mirë (me uthull)! iron. shih te LAJ.
- MISTREC** m. 2. keq. Njeri i keq, shpirtvogël e ngatërrestar, që fut spica e nuk lë dy

- gurë bashkë, njeri grindavec. Mistrec i keq. Sillet si mistrec. Nxirre jashtë, mistrecin! Mos u merr me atë mistrec!
- MISH** m. \* Mish për top keq. shih tek TOP, ~I. Një copë mish me dy sy mospërf. njeri i trashë që s'kupton kurr gjë, buf. E ruan si qeni mishin (si qeni mëlçitë) iron. shih te QEN, ~I. Hyri mish e doli peshk mospërf. nuk mësoi asgjë, nuk zuri mend. Pret thika në mish të botës keq. shihte THIK/Ë, ~A.
- MITË** II f. 1. keq. Para a diçka tjetër që dikush ia jep nën dorë një nëpunësi në kundërshtim me moralin socialist që t'i mbarojë një punë në rrugë të jashtëligjshme; ryshfet. Marrja (dhënia) e mitës dënohet me ligj. Merrte mitë.
- MITRALOZ** m. 2. bised. keq. Njeri që flet shumë dhe kot, njeri të cilit nuk i pushon goja.
- MIZË** f. Mizë kali keq. njeri që të ngjitet e s'të ndahet dhe të bezdis, njeri i mërzitshëm. Vret (numëron, zë) miza (gjithë ditën) mospërf. e shkon kohën kot; bën punë të kota pa vlerë, i bie legenit, luan derën. shih te ZOG, ~U.
- MODERN** mb. libr. 4. iron. Që hiqet sikur jeton me kohën, që i duket vetja sikur përfaqëson të sotmen; që i pëlqejnë moda e sjelljet e huaja borgjeze dhe i imiton ato me mendjehetësi; që është tipar i një njeriu të tillë. Njeri modern. Veshje moderne. Në mënyrë moderne.
- MODERNIZOHEM** vetv. 2. iron. Hiqem sikur jetoj me kohën, sillem e veproj gjoja si njeri modern.
- MOKËR** f. \* Kërkon për mokra keq. flet kot, bluan, grin. I vuri mokrat në këmbë e pengoi, nuk e la të bëjë diçka.
- MOLLÇINKË** f. 2. keq. Kokërr molle e vogël; mollë kokërrvogël dhe e thartë. Ç'janë këto mollçinka!
- MORAL** m. 3. keq. Këshilla që përsëriten e bëhen të mërzitshme, predikim i zbrazët për parimet, normat, rregullat, sipas të cilave duhet të sillet dikush. Shet moral. Moral po na bën?! 5. Nder; sjellje e ndershme, ndershmëri. Grua me moral të lartë. Ishte me moral të keq. U prishën për çështje morali.
- MORALIST** m. 2. keq. Ai që moralizon, ai që shet moral. Moralistët borgjezë. Është një moralist i mërzitshëm.
- MORALIZIM** m. keq. 1. Veprimi sipas kuptimit të foljes MORALIZOJ. 2. Këshillë morale që përsëritet e bëhet e mërzitshme, predikim i zbrazët për çështje të moralit. Moralizime të gjata (të mërzitshme, të kota, të thata). Mbushur me moralizime.
- MORALIZOJ** kal. keq. I jap dikujt këshilla morale të mërzitshme, i shes moral; merrem me predikime të zbrazëta për çështje morali.
- MORALIZUES** mb. keq. 1. Që synon të shesë moral; që moralizon. Fraza moralizuese. Ka karakter moralizues.
- MOROZE** f. 2. keq. Grua që ka lidhje dashurie me burrin e tjetërkujt.
- MORRAC** mb. keq. Morracak.
- MORRACAK** mb. keq. 1. Që ka shumë morra, i krimbur në morra. 2. I fëlliqur, i ndytë, i qelbur (edhe fig.). 3. Përd. em. sipas kuptimeve të mbiemrit (për njerëzit). Morracak i ndyrë!
- MORRASH** mb. keq. Morracak.
- MPIHEM** vetv. \* Djemtë (fëmijët) hanë kumbulla (thana), pleqve u mpihen dhëmbët iron. njëri bën një veprim dhe dikush tjetër shqetësohet pa nevojë për të.
- MPREH** kal. a) iron. e quan që më parë, pa e pasur ende në dorë, si gjënë a pronën e tij, përgatitet shpirtërisht për ta pasur si të tijën; shpreson më kot se do të ndodhë ose se do të shkojnë punët ashtu si do a si mendon ai;
- MPRIHEM** vetv. 3. iron. E quaj që më parë, pa e pasur ende në dorë, si gjënë a pronën time, përgatitem shpirtërisht për

- ta zotëruar etj.; shpresoj më kot se do të ndodhë a se do të shkojnë punët ashtu siç mendoj unë, bëhem gati për diçka, mpreh dhëmbët. Ç'qenke mprehur! U mpreh të shkonte edhe ai atje. Kot që mprihesh!
- MUAJ** m. \* Muaji i mjaltit muaji i parë i jetës bashkëshortore. Ato të muajit euf. gjakrat, të larat, zakonet.
- MUF** mb. 2. fig. keq. I papjekur nga mendja.
- MUFKË** mb. 6. si em. MUFK/Ë, ~A f. ~A, ~AT keq. Fjalë, punë etj. që nuk është menduar mirë, diçka e pa pjekur. Ç'janë këto mufka që thua (që bën)!
- MULLAC** mb. 1. keq. Që ka vënë bark, barkmadh. Burrë mullac.
- MURG** m. 2. fig. keq. Njeri i vetmuar, që bën një jetë të mbyllur; njeri i shkëputur nga jeta e gjallë.
- MURRIZ** m. bot. \* Fshiji buzët (mustaqet) për murrizi (pas murrizit)! iron. shih te BUZ/Ë, ~A. Gjithkujt murrizi i vet i duket i njomë fj.u. iron. thuhet kur dikush lavdëron tepër gjërat e veta, fëmi-jët e vet a punën e vet, edhe kur nuk e meritojnë.
- MUSTAQE** f. kryes. I janë varur mustaqet iron. i ka shkuar burrëria, s'është më për burrë, s'e quajnë më për burrë. Fshiji mustaqet (buzët) për murrizi (pas murrizit)! iron. shih te BUZ/Ë, ~A.
- MUSHKË** f. \* Kur të pjellë mushka iron. asnjëherë, kurrë. I pjell edhe kau (mushka) dikujt shih te KA, ~U. Ashtu (kështu) i do mushka drutë keq. b) ashtu e do puna. I gjeti mushka drutë keq. gjeti atë që kërkonte, e pësoi siç e meritonte, mori përgjigjen a dënimin e merituar. Harro mushkë Valarenë! iron. s'është më ajo kohë, iku ajo kohë (kur dikush e kishte çdo gjë të lehtë).
- NAKATOS** kal. krahin. 2. keq. E fut së bashku me të tjerë diku ose në diçka, e ngatërroj në diçka ose me dikë, përziej. Mos më nakatos në ato gjëra.
- NAKATOSEM** vetv. krahin. 2. keq. Përzihem në një punë, marr pjesë diku a në diçka së bashku me të tjerë, ngatërrohem, trazohem. Ai nuk nakatoset në punë të tilla. Mos u nakatos me atë!
- NALLBAN** m. 2. fig. keq. Njeri i paaftë në mjeshtërinë e vet.
- NAM** m. bised. I vajti nami larg. T'u shoftë nami! mallk. I humbtë nami! mallk.
- NDËRSEJ** kal. 2. fig. keq. Nxit dikë për të sulmuar e për të goditur një tjetër, e shtyj kundër dikujt. E ndërseu kundër tij. E ndërsejnë njërin kundër tjetrit. I ndërsejnë kundër vendeve të tjera.
- NDËRRESË** f. 5. vet. euf. Të përmuajshmet e grave.
- NDËRROJ** kal. \* E ndërroi (e ktheu) pllakën (fletën) keq. shih te PLLAK/Ë, ~A.
- NDIZEM** vetv. 7. fig. Më rrëmben një ndjenjë e fortë, marr zjarr; zemërohem, më hipën inati. Ndizet shpejt. U ndez inati. U ndez më keq. Prit, mos u ndiz!
- NDOT** kal. 3. jokal. euf. Bëj ujët, dal jashtë.
- NDOTEM** vetv. 2. euf. Bëj ujët, dal jashtë. Është ndotur foshnja.
- NDREQ** kal. \* I ndreqi orët me dikë keq. shih tek OR/Ë, ~A I.
- NDRIT** jokal. 7. kal. iron. E bëj keq një punë, e prish. E ndriti punën! Ç'na ndrite dhe ti me këto!
- NDYHEM** vetv. 3. euf. Dal jashtë, bëj nevojën, ndotem. U ndy foshnja.
- NDYJ** kal. 4. jokal. euf. Dal jashtë, bëj nevojën.
- NEGATIVISHT** ndajf. 2. Në mënyrë të dëmshme për dikë a diçka, keq. Ndikon negativisht.
- NEOFIT** m. libr. 2. keq. Ai që ka përqaftuar rishitas një ide, një doktrinë politike ose që sapo është bërë pjesëtar i një lëvizjeje politike, shoqërore etj.; rishtar në ndonjë punë a veprimtari. Me zellin e neofitit.

- NEVOJË** f. 4. euf. Mbeturinat që nxjerr jashtë njeriu ose kafsha, jashtëqitje. Nevoja e madhe ujët e trashë. Nevoja e vogël ujët e hollë. Nevoja e qenit (e maces). Bëri nevojën.
- NËNBANAK** m. Pjesa nën syprinën e një banaku nga ana e shitësit. Nxjerr nga nënbanaku. Blen (shet) nga nënbanaku. keq. blen (shet) në rrugë të paligjshme, duke i hequr mënjane mallrat.
- NGALAKAQ** mb. keq. Që është i ngadalshëm në lëvizje; që ecën dhe lëviz me përterë, i plogët, i ngathët; kund. i shkathët. Fëmijë ngalakaq.
- NGARKOJ** kal. \* I ngarkoi (i ngriti, i mblodhi) plaçkat edhe iron. shih te **PLAÇK/Ë,~A**.
- NGËRQESHM** vetv. keq. Qesh me ligësi, zgërdhihem, zbardh dhëmbët. Ç'më ngërqeshesh ashtu?
- NGORDH** jokal. 2. keq. Vdes. Ngordhin rrugëve (në kurbet). Ngordhi beu. Ngordhi si qen. Armiqtë le të ngordhin.
- NGORDHALAQ** mb. keq. 1. I dobët e i pafuqi, që mezi qëndron në këmbë. Kalë ngordhalaq. Djalë ngordhalaq. 2. Që i mungon gjallëria evullneti, që nuk ka shpirt iniciative; i plogët; i mefshtë, i humbur. Njeri (plak) ngordhalaq.
- NGORDHAQ** mb. keq. Ngordhalaq. Fëmijë ngordhaq.
- NGORDHJE** f. 3. keq. Vdekje (edhe fig.) U erdhi ngordhja bejlerëve.
- NGRE** kal. \* Ngriti bishtin keq. I ngriti (i mblodhi, i mori) çoparkat iron. shih te **ÇOPARKA,~T**. Ka ngritur hundën me dikë keq. është zemëruar me dikë. I ngriti (i mblodhi, i ngarkoi) plaçkat iron. shih te **PLAÇK/Ë,~A**. E ngriti (e hodhi, e ktheu) me këmbë përpjetë mospërf. shih te **KËMB/Ë,~A**. Ngre (bën, ndërton) kështjella në erë (në ajër) keq. shih te **KËSHTJELL/Ë,~A**. Ngre kodra përmbi det iron. shih te **KOD/ËR,~RA**. Ka ulur pak hundën, por ka ngritur sqepin iron. shih tek **UL**.
- NGREHALUC** m. keq. Njeri që kapardiset e shet mend; njeri që përpiqet të bjerë në sy me veshjen, me paraqitjen ose me mënyrat e jashtme. Ngrehaluc i padurueshëm.
- NGREHALUCEM** vetv. keq. Kapardisem, krekosem; shes mend. Ngrehalucet si gjel.
- NGREHINË** f. 2. fig. Diçka e ndërtuar me punë mendore. Ngrehinat e shkencës. Një ngrehinë teorike. keq. Ngrehinat e mendjes.
- NGROHEM** vetv. \* Jemi ngrohur nën (nga) një diell iron. jemi fare të largët njëri për tjetrin, s'kemi të bëjmë fare njëri me tjetrin; nuk jemi as fis, as soj.
- NGROHTË** mb. \* Qoshe e ngrohtë (vend i ngrohtë) keq. punë e rehatshme, pa telashe e vështirësi dhe me të ardhura të mira. b) keq. kishte përkrahje a mbrojtje nga një njeri a organ i rëndësishëm, edhe pa të drejtë.
- NGUSHTË** ndajf. 3. fig. Në një gjendje të vështirë për ta përballuar, pa rrugëdalje, pisk, keq. Ishte (gjendej, ndodhej) ngushtë.
- NGUSHTOHEM** vetv. 5. fig. U ngushtua keq. U ngushtuan të iknin.
- NGJALË** f. 2. fig. keq. Njeri dredharak, që di t'u bëjë bisht e t'u shpëtojë gjendjeve të vështira.
- NGJELKË** f. bised. keq. Grua llafazane, që merret me thashetheme. Ngjelkat e mëhallës. Fjalët e ngjelkave.
- NGJIT** I kal. \* I ngjiste (i vinte) brirë (brirët e kaut) dikujt keq. shih te **BRI,~RI**.
- NGJITUR** mb. 3. fig. keq. Që të qepet prapa dhe nuk të ndahet, i bezdisur, i mërzitshëm. \* Baltë e ngjitur keq. Njeri i mërzitshëm që të ngjitet nga pas e nuk të shqitet.
- NGJYRË** f. 6. fig. keq. Lloji i prirjeve dhe i bindjeve politike, rrymë, drejtim. Armiq (reaktionarë, imperialistë) të çdo ngjyre. Reaksioni i të gjitha ngjyrave.



- NIS** kal. \* Si e nisi, e grisi keq. si e filloi keq, ashtu edhe e përfundoi (jetën ose një punë).
- NISEM** vetv. \* Si u nis, ashtu u bitis (u gris) keq. si filloi keq një punë ashtu edhe përfundoi. Ku u nis e ku u degdis! ndryshe filloi e krejt ndryshe mbaroi, ku filloi e ku mbaroi!
- NIVELOJ** kal. 3 keq. fshij, zhduk mekanikisht çdo lloj dallimi e ndryshimi ndërmjet njerëzve ose vlerave, rrafshoj. E niveloi zhvillimin shoqëror.
- NOÇKË** f. 4. kryes. keq. Fytyra e njeriut, turi. Shtrembëron (përdredh) noçkat. I theu noçkat.
- NOTOJ** jokal. \* Noton në të njëjtat (në po ato) ujëra me dikë keq. shih tek UJ/Ë,~I.
- NXIHEM** vetv. 4. fig. keq. Mbushet një vend plot e përplot me diçka jo të dëshirueshme.
- NXJERR** kal. \* Ia nxori (ia hoqi, ia qiti) bojën keq. shih te BOJ/Ë,~A. Nxjerr brirët (brirë) keq. shih te BRI,~RI. E nxori (e bëri, e qiti) çirak dikë edhe iron. shih te ÇIRAK,~U I. Nxori (qiti) veshët keq. shih te VESH,~I. Nxjerr (çel) zogj iron. shih te ZOG,~U. E nxori hundën jashtë iron. shih te HUND/Ë,~A. Do të nxjerrë prush me këmbët e maces keq. shih te PRUSH, ~I. Të jep thonjtë e bufit për të të nxjerrë sytë keq. shih te SY,~RI.
- NJERI** m. \* Njeri i minderit keq. shih te MIN-DER, ~I.
- NJË** Mbytet në një pikë (lugë, gotë, filxhan, gisht) ujë mospërf. shih tek UJ/Ë,~I. Tre hunj e një thupër keq. shih te HU,~RI.
- NJËJTË** mb. \* Noton në të njëjtat (në po ato) ujëra me dikë keq. shih tek UJ/Ë,~I.
- NJOH** kal. \* Ia njoh kokën dikujt keq. shih te KOK/Ë,~A 4.
- NJOHUR** mb. 2. Që e njohin mirë të gjithë, që është bërë popullor me vetitë e cilësitë e mira që ka, që ka bërë emër, i dëgjuar, i shquar; keq. që e njohin të gjithë si të tillë, që është me damkë. Shkrimtar (kompozitor, këngëtar, artist, dijetar) i njohur. Melodi e njohur. Vepër e njohur. Vjedhës (hajdut, kriminel) i njohur. Agjent i njohur. Është i njohur.
- OJNAK** mb. 2. keq. Dredharak, dinak. Njeri ojnak.
- OKATAR** mb. 2. fig. keq. Që pi shumë raki, që është pijanec i madh. Burrë okatar.
- OKSIGJEN** m. kim. \* I jep oksigjen dikujt libr. keq. e ndihmon a e nxit dikë për të bërë një të keqe, i fryn zjarrit.
- OKTAPOD** m. 2. fig. keq. Njeri i lig e i djallëzuar, që përpiket ta shtrijë sa më gjerë e pa zhurmë veprimtarinë e vet të dëmshme.
- OPINGË** f. kryes. I bëhej baltë në opingë dikujt keq. i ngjitej shumë dikujt sa e mërziste, nuk i ndahej fare, i shkonte gjithnjë pas. Ia dha opingat (këpucët) në dorë mospërf. shih te KEPUC/Ë,~A.
- OREKS** m. 2. fig. zakon. keq. Dëshira a etja për të pasur diçka, për të bërë një gjë etj.; synimi për t'ia arritur diçkaje; lakmi; qejfi për t'u marrë me një punë. Oreks i pangopur.
- ORË** I f. I ndreqi orët me dikë keq. thuri a kurdisi planet me dikë kundër dikujt tjetër, i bashkërendoi veprimet me dikë kundër një tjetri.
- ORË** II f. \* Ora e shtëpisë euf. bolla.
- ORGJI** f. 2. keq. Dëfrim i shthurur me të pira e me këngë. Orgji e shfrenuar. Orgjitë mbretërore. Natë orgjish. Bëjnë orgji.
- ORTAK** m. 3. fig. keq. Bashkëpunëtor në një punë të keqe a në një veprimtari të dëmshme. Ortakët e imperializmit.
- ORTODOKS** mb. 2. fig. keq. Që i përmbahet me kokëfortësi diçkaje; dogmatik. Njeri ortodoks.

- PAATDHE** mb. 2. keq. Që mohon atdheun dhe vepron kundër tij, që nuk ka dashuri për atdheun a që e ka tradhtuar atdheun. Mercenarë të paatdhe.
- PACAK** mb. 2. keq. Që nuk ka vend a strehë të përhershme banimi; që endet andej-këtej dhe nuk zë një vend për të jetuar a për të punuar. Njeri i pacak.
- PAÇJERRË** mb. euf. I patredhur. Kalë i paçjerrë.
- PADRON** m. 2. fig. keq. Ai që ka vënë të tjerët nën urdhra; ai, të cilit i nënshtrohet me bindje e me lajka dikush për të nxjerrë ndonjë përfitim. Qeveritë e vendeve borgjeze u shkojnë pas avazit padronëve amerikanë. 3. keq. Ai që sillet e vepron si pronar kapitalist ndaj vartësve ose ndaj njerëzve që kanë të bëjnë me të. Është padron në familje.
- PADUKUR** m. euf. Djalli.
- PADUKUR** f. euf. Sëmundja e plasjes. I ra lopës e padukura.
- PAEMËR** m. 1. euf. Djalli.
- PAEMËR** f. 1. mjek. euf. Urdhje, shpërgëti. I ra e paemra. 3. mjek., euf. Sëmundje e shprekës, që shfaqet me ënjtje të saj, zmadhim i shprekës. 4. edhe ~RA, ~RAT (të) mjek., euf. Fryrja e damarëve të këmbëve, shpesh te gratë shtatzëna. Në çdo barrë i dilnin të paemra.
- PAGOJË** m. euf. 1. Djalli. E marrtë i pagoji! mallk. 2. Ujku.
- PAGUAJ** kal. 4. keq. I jap të holla dikujt për të bërë një të keqe kundër një tjetri, shtie dikë.
- PAGUAR** mb. 2. keq. Që është vënë nga një tjetër me para për të bërë një të keqe kundër dikujt tjetër, i shtënë. Vrasës i paguar. Kalemxhi i paguar.
- PAJË** I f. \* Bëhu pajë! keq. shporru, qërohu! E mori pajë me vete (iu bë pajë) i mbeti përgjithnjë si njollë, nuk i hiqet më. Ia bëri pajë dreqit (shejtanit) e shporri dikë, e hoqi qafe.
- PAJTIM** I m. 1. Veprimi dhe gjendja sipas kuptimeve të foljeve PAJTOJ I, PAJTOTHEM I. Politikë pajtimi. keq.
- PALLMË** f. 2. keq. Zë i fortë si i gjedhit a i gomarit, që nxjerr dikush kur bërtet; thirrme e fortë, ulërimë. Pallmë ngjethëse. Dha pallmën. Lëshoi një pallmë.
- PANEGJIRIK** m. 2. iron. Lëvdatë e tepruar që i bëhet dikujt a diçkaje me fjalë ose në një shkrim.
- PANEGJIRIST** m. 2. iron. Ai që i thur lëvdata të tepruara dikujt a diçkaje.
- PANGOPËSI** f. 2. fig. keq. Vetia e njeriut që nuk ka të ngopur me diçka, lakmi e madhe për pasuri e mall; të qenët i pangopshëm. Pangopësia e borgjezisë. Pangopësia për fitime. I shtyrë nga pangopësia.
- PANGOPSHËM** mb. 2. fig. keq. Që nuk është i kënaqur asnjëherë me atë që ka ose me atë që ka arritur; që është gjithnjë i etur për pasuri e mall. Njeri i pangopshëm.
- PANGOPUR** mb. 3. fig. keq. I pangopshëm. Njeri i pangopur.
- PAPIZËM** m. fet. keq. Pushteti i kishës katolike, i mishëruar në figurën e papës; nënshtrimi i verbër ndaj pushtetit të papës dhe dogma që kërkon këtë nënshtrim.
- PAPJESI** m. bised. euf. Djalli, qoftëlargu, mospastëpjesi.
- PAQENË** mb. 3. si em. PAQEN/Ë, ~I (i) m. bised. euf. Djalli, qoftëlargu, i papjesi.
- PARALIZOHET** vetv. 3. fig. Humbas mundësinë të veprojë lirisht, mbërthehem keq. U paralizuan krejt.
- PARAZIT** m. 2. fig. keq. Ai që nuk punon vetë dhe jeton me djersën e një tjetri ose në kurriz të shoqërisë; ai që bën një jetë të zbrazët e të kotë. Klasë (shtresë) parazitësh.
- PARAZITIZËM** m. 2. fig. keq. Mënyrë jetese e dikujt që shfrytëzon punën e të tjerëve ose që rron në kurriz të të tjerëve a të

- shoqërisë, jetë parazit. Parazitizmi i kapitalistëve.
- PARTIZANÇE** mb. bised. 2. keq. Në mënyrë jo gjithnjë të rregull e të organizuar me rreptësi, me metoda e me forma të rastit.
- PARTNER** m. libr. 2. edhe keq. Ai që bën së bashku me një tjetër a me të tjerë një punë, një marrëveshje, një bisedë etj. Partner i fuqishëm.
- PASQAFE** f. 2. fig. euf. Vdekja. I erdhi pasqafja.
- PASHTËPI** mb. 2. keq. Që endet a bredh rrugëve, që s'mblidhet në shtëpi; rrugaç. Djalë i pashtëpi.
- PATRIARK** m. 3. keq. Njeri që sillet si sundimtar në familje, në një vend etj.; sundimtar me pushtet të pakufizuar. Qëndrim (sjellje) patriarku.
- PATRIARKALIZËM** m. 2. keq. Pushtet i pakufizuar i burrit a i kryefamiljarit mbi gruan e mbi njerëzit e tjerë të familjes; qëndrim patriarkal a sjellje patriarkale e dikujt në shtëpi. Shfaqje (prirje) të patriarkalizmit.
- PAUDHË** m. 1. euf. Djalli, qoftëlargu. Të marrtë i paudhi! mallk. I doli (iu shfaq) i paudhi. Ka të paudhin në bark ka djallëzi, është djallëzor.
- PAZAR** m. bised. \* Hyri në pazar me dikë keq. shih te HYJ.
- PAZARLLËK** m. 2. keq. Marrëveshje e ulët, jo e ndershme që bëjnë dy a me shumë njerëz, palë, shtete etj. për interesa të ngushta në dëm të dikujt; lëshim i padrejtë që i bëhet dikujt. Pazarllëk i turpshëm. Pazarllëk politik. Rruga e pazarllëqeve diplomatike.
- PEHLIVAN** m. bised. 3. fig. keq. Njeri dredharak, që di ta vërtitë punën në interes të tij në çdo rrethanë; ai që përdor dredhi, mashtrime etj. për t'i shpëtuar një gjendjeje të vështirë ose për të kapërcyer pa dëm pengesat që i dalin përpara. Është pehlivan i madh.
- PEHLIVANLLËK** m. keq. Dredhi a mashtrim që përdor dikush për t'i shpëtuar pa dëm një gjendjeje të vështirë a një rreziku, për t'u hedhur hi syve të tjerëve etj. veprim a sjellje prej pehlivani. Pehlivanllëk politik. Është i zoti për pehlivanllëqe. Bënte pehlivanllëqe.
- PELË** f. Rri si pelë. keq. përton të bëjë punë; rri pa merak e pa kujdes, pa i njohur e zbatuar mirë rregullat e mirësjelljes (për gra e për vajza të rritura). \* Del si mëzi para pelës keq. shih te MËZ, ~I. Të jep një thelë e të merr (të rrëmben) një pelë keq. shih te THEL/Ë, ~A.
- PELLG** m. 9. keq. Mjedis a vend me njerëz të këqij a me njerëz që kanë pikëpamje të mykura a reaksionare, që janë të shturur moralisht etj.; gjendje e keqe a e vështirë; moçal, batac. Pellg oportunistësh (mikroborgjezësh, kumarxhinjsh). Pellg rigjykimesh (besëtytnish). E nxori nga pellgu. Doli nga pellgu ku kishte rënë.
- PENDË** I f. Ia la pendët (puplat) dikujt iron. i iku papritur a fshehurazi nga dikush dhe as që u bë merak për të, i iku nga duart papritur dhe e la me gisht në gojë; mori ç'mundi, përfitoi sa mundi prej dikujt e iku papritur.
- PEQE** pj. bised. \* Me lepe e me peqe edhe keq. shih te LEPE.
- PESË** num. them. \* Pesë para oka (dy grosh oka) mospërf. shih te OK/Ë, ~A. Nuk ka as pesë (as dy) lëkura edhe iron. shih te LËKUR/Ë, ~A.
- PESHK** m. \* Me urdhër të peshkut iron. pa u lodhur për diçka pa bërë vetë asgjë. Hyri mish e doli peshk mospërf. shih te MISH, ~I. Peshku në det e tigani në zjarr fj. u. iron. thuhet kur një punë ende s'është kryer, kurse dikush kërkon para kohe të gëzojë të mirat që do të vijnë prej saj pasi të përfundojë; është tepër herët për diçka.
- PESHKOJ** kal. 2. fig. bised. edhe iron. Gjej një njeri a diçka që më hyn në

- punë duke kërkuar andej-këndej, zbuloj atë që më duhet; përpiqem të gjej e të marr diçka për vete me dinakëri ose me shkathtësi; gjuaj. Nga e peshkove atë njeri? E peshkoj për vete. \* Peshkon në ujë të turbullt (në ujëra të turbullta) keq. punon tinëz, vepron në mënyrë jo të ndershme, duke u munduar të përfitojë nga vështirësitë në të cilat gjendet dikush, një vend etj.; e turbullon një gjendje me qëllim që të nxjerrë përfitime.
- PETË** f. I ka plasur peta (cipa) e ballit keq. shih te CIP/Ë,~A.
- PETK** m. 5. fig. keq. Veshje a pamje e jashtme, nën të cilën dikush kërkon të fshehë fytyrën e vet të vërtetë, një gjë a një dukuri; maskë, lustër. Nën petkun zyrtar. Nën petkun e marksizmit (e socializmit). Nën petkun fetar.
- PËGËRË** as. edhe euf. Jashtëqitje (zakonisht për foshnjat).
- PËLLAS** jokal. 2. fig. thjeshtligj., tall., keq. Flas me zë të lartë, bërtas, flas kot e shumë sa i mërzit të tjerët. Pëllisnin hoxhallarët (priftërinjtë). Ule zërin, pse pëllet ashtu?
- PËLLITJE** f. 2. fig. keq. Thirrje a britmë e çjerrë kundër dikujt ose për diçka; sharje. Pëllitjet e shërbëtorëve të fashizmit. Pëllitjet e kalemxhinjve të imperializmit.
- PËRBINDËSH** m. 3. fig. keq. Njeri jashtëzakonisht i pashpirt e i neveritshëm, që mund të kryejë veprat më mizore e më të poshtra, vrasës e shfrytëzues shumë i egër e gjakpirës. Përbindëshat nazistë (fashistë, imperialistë),
- PËRBINDSHËM** mb. 2. fig. keq. Shumë i shëmtuar e i neveritshëm; që bëhet me egërsi të madhe e pa pikë mëshire, në mënyrë të poshtër e të pabesë. Fytyra e përbindshme e pushtuesve të huaj. Krimet e përbindshme të nazistëve (të imperialistëve).
- PËRÇAPEM** vetv. 2. fig. keq. Lëviz dhëmbët e buzët në shenjë pakënaqësie. U përçap i pakënaqur.
- PËRDALË** mb. f. keq. E shturur moralisht, që nuk e ruan nderin e vet si vajzë a si grua. Vajzë (grua) e përdalë.
- PËRDHE** ndajf. \* Me faqe përdhe (në dhe) shih te FAQ/E,~JA. Me shpinë përdhe (në tokë) shih te SHPIN/Ë,~A. I ka rënë hunda përdhe (në dhe) iron. shih te HUND/Ë,~A.
- PËRDHES** II m. euf. Gjarpri.
- PËRFYTEM** vetv. 1. Zihem me dikë duke u kapur për gryke, mbërthehem fytafyt, kacafytem, përlëshem. U përfytën keq. Qeni u përfyt me ujkun.
- PËRGOJIM** m. keq. 1. Veprimi sipas kup-timeve të foljeve PËRGOJOJ, PËRGOJOHEM. 2. kryes. sh. Të folurit keq e prapa krahëve për dikë; thashetheme. Nuk merren me përgojime.
- PËRGOJOHEM** Pës. e PËRGOJOJ keq. Përgojohej nga i gjithë fshati.
- PËRGOJOJ** kal. keq. Flas keq e prapa krahëve për dikë a për diçka, e marr nëpër gojë; merrem me thashetheme. Përgojonte vajzat e fshatit. Nuk përgojojnë të tjerët. Përgojonin rrugëve e skutave.
- PËRGOJUAR** mb. keq. Që është marrë nëpër gojë nga të tjerët për të keq, që e kanë përgojuar. Njeri i përgojuar.
- PËRGJËRIM** m. 3. kryes. ~E, ~ET iron. Betim ose zotim për diçka, që bëhet me fjalë të mëdha dhe me një mallëngjim të rremë. Përgjërimet e imperialistëve për paqe.
- PËRJARGEM** vetv. 3. keq., iron. Puthem tepër me dikë (sidomos për t'u treguar gjoja i dashur me të a për t'i shprehur ndjenja miqësie të rreme). Mjaft u përjargët!
- PËRJETSHËM** mb. \* Gjumi i përjetshëm (i madh) euf. shih te GJUM/Ë, ~I
- PËRKËDHEL** kal. 4. fig. keq. E marr dikë me të mirë, duke i plotësuar edhe tekat e trillet, duke mos e qortuar për gabimet që bën etj. E kanë përkëdhelur (tepër). Nuk e ka përkëdhelur jeta.

- PËRKËDHELI** f. 2. keq. Qëndrim tepër i butë ndaj dikujt, duke i plotësuar edhe tekat e trillet, butësi e tepruar; llastim. E prishën përkëdhelitë.
- PËRKËDHELUR** mb. 2. keq. Që është edukuar keq, duke ia plotësuar tekat e trillet, që është përkëdhelur tepër, i llastuar. Fëmijë i përkëdhelur.
- PËRLAJ** kal. E për lau pjatën. Për lau një pulë të tërë. E për lau ujku delen. Ai më për lan edhe mua. thjeshtligj., iron. ai ha shumë.
- PËRLESHM** vetv. U përleshën keq. U përleshën kalamajtë.
- PËR LUGËTOHEM** vetv. keq. Jepem shumë pas të ngrënit e të pirit; ha e pi jashtë mase, fryhem së ngrëni.
- PËRPALL** kal. 2. keq. Përhap një lajm, ua them të gjithëve diçka që di; tellallis. I përpalli lajmet në të katër anët.
- PËRPËLITEM** vetv. 2. fig. kryes. keq. Vua shumë; bëj përpjekje të mëdha e në shumë drejtime për të shpëtuar nga një rrezik, për të dalë nga një gjendje e vështirë a për të gjetur një rrugëdalje. Përpëliten në darën e një krize të rëndë.
- PËRPËLITJE** f. 3. fig. kryes. keq. Përpjekje të ethshme që bën dikush për të shpëtuar nga një rrezik, për të dalë nga një gjendje e vështirë a për të gjetur një rrugëdalje çfarëdo. Përpëlitet e fundit të klasave shfrytëzuese (të kolonializmit).
- PËRPJETË** E ktheu (e ngriti, e hodhi) me këmbë përpjetë mospërf. shih te KËMB/Ë, ~A. Mban bishtin përpjetë i është rritur mendja, vret lart. E mban (e ka) hundën përpjetë (lart) iron. shih te HUNDË, ~A.
- PËRPUNOJ** kal. 4. zakon. keq. Përpiqem t'i mbush mendjen dikujt e të ndikoj tek ai me mënyra të ndryshme, që të mbajë një qëndrim të caktuar për përfitime vetjake. Përpunonin mendimin (opinionin) publik. E kishte përpunuar një kulak. I përpunonte që të votonin për të.
- PËRTOKË** ndajf. 3. fig. keq. Në një nivel a në një gjendje shumë të ulët; me një cilësi shumë të dobët. Është përtokë. Moralin e kishin përtokë.
- PËRTROLLËS** mb. 2. si em. ~, ~I m. euf. Gjarpri, tokësi.
- PËRVETËSIM** m. 2. keq. Diçka që është përvetësuar a vjedhur; vjedhje. Përvetësime të paligjshme. Përvetësimi i titullit. drejt.
- PËRVETËSUES** m. keq. Ai që bën pronë të vetën pa të drejtë e në mënyrë të paligjshme një send, një pasuri etj. Dënimi i përvetësuesve të pasurisë.
- PËRZIEJ** kal. 6. fig. keq. Shtie në grindje e në ngatërresa njerëzit që janë bashkë ose afër njëri-tjetrit, ngatërroj. Përzjeu një lagje (një mëhallë). Përzjeu tërë dynjanë (botën).
- PËRRUA** m. \* Lumë a përrua shih te LUM/Ë, ~I. E hodhi përruan (lumin, vaun, hendekun) shih te HEDH 2. Zuri përruan (ledhin) keq. shih te ZË. Iu bë gjol e përrua shih te GJOL, ~I.
- PI** kal. \* Dehet pa pirë iron. shih te DEHEM. Ia ka pirë lëngun dikujt mospërf. e njeh mirë, ia di të gjitha vlerat, veset dhe huqet. E piu sherbetin mospërf. shih te SHERBET, ~I. Pi ujë te dikush keq. shih tek UJ/Ë, ~I. E kemi pirë këtë ujë mospërf. e dimë këtë punë, e kemi parë këtë gjë edhe më përpara. Pi uthull tall. shih tek UTHULL, ~A. E piu e zeza përfundoi keq, e pësoi rëndë, e mori dreqi. Pi macja uthull iron. shih tek UTHULL, ~A.
- PILAF** m. \* E gjeti lugën në pilaf keq. shih te LUG/Ë, ~A. I mbeti luga në pilaf iron. shih te LUG/Ë, ~A. Hyn (futet) si luga në pilaf keq., shih te LUG/Ë, ~A.
- PIRAT** m. 2. fig. keq. Agresor që dhunon tokat, ujërat ose hapësirën ajrore të një vendi të pavarur dhe sulmon qytete e fshatra të pambrojtura, vret banorë paqësorë etj. Piratët fashistë të ajrit.

- PIRAT** mb. 2. fig. keq. Që dhunon tokat, ujërat ose hapësirën ajrore të një vendi të pavarur dhe sulmon qytete e fshatra të pambrojtura, vret banorë paqësorë etj. Aeroplan pirat.
- PISPILINGË** f. keq. bised. Grua mendjelehtë e llafazane, që fut në grindje të tjerët. E kishte fryrë ajo pispilinga.
- PISPILLIM** m. keq. Pispillosje.
- PISPILLOHEM** vetv. keq. Pispillosem.
- PISPILLOS** kal. keq. Vesh, kreh e stolis dikë në mënyrë tepër të stërholluar; merrem shumë me diçka për ta zbukuruar. Pispilloste mustaqet.
- PISPILLOSEM** keq. Vishem, krihem e stolisem në mënyrë tepër të stërholluar për t' u dukur, nisem e stolisem jashtë mase. U vesh e u pispillos si për dasmë.
- PISPILLOSJE** f. keq. 1. Veprimi sipas kuptimeve të foljeve PISPILLOS, PISPILLOSEM. 2. Stoli e zbukurime të tepruara që përdor dikush për t' u dukur. Pispillosje pa shije.
- PISPILLOSUR** mb. keq. I veshur, i krehur e i stolisur në mënyrë të tepruar për t' u dukur, i nisur e i stolisur jashtë mase. Ishin ca zonja të pispillosura (ca kokoroshë të pispillosur).
- PISPILLUQ** m. keq. Njeri mendjelehtë që kujdeset vetëm për t' u nisur e për t' u stolisur, ai që pispilloset. Pispilluq mendjemadh. Vërtitej me një pispilluq.
- PJELL** kal. dhe jokal. 5. fig. kryes. keq. Bëhet shkak për lidhjen e diçkaje, zakonisht jo të mirë; shpik; sajon. Prodhimi i vogël pjell kapitalizmin. Hiqen sikur punojnë, duke pjellë vendime. b) keq. sajon gjëra të paqena, trillon. Më polli sherri me dikë shih te SHERR, ~I. Kur të pjellë mushka iron. shih te MUSHK/Ë, ~A. E di ku pjell pula shih te PUL/Ë, ~A. I erdhi veza për të pjellë thjeshtligj. shih te VEZ/Ë, ~A. Nuk mbarset mushka të pjellë mëz fj. u. shih te MUSHK/Ë, ~A. U mbars mali e polli një mi fj. u. shih te MAL, ~I. Ç' pjell macja (ç' len prej maces), gjuan minj fj. u. keq. shih te MAC/E, ~JA.
- PJELLË** f. 4. fig. keq. Rrjedhë jo e mirë e një dukurie, e një sistemi etj.; diçka e keqe e krijuar me pikësynime të caktuara; pasojë. Pjellë e imperializmit
- PJESË** f. \* Pjesa e luanit libr. iron. shih te LUAN, ~I.
- PLAÇKË** f. \* Një gjel plaçka shih te GJEL, ~I. Plaçkë tregu keq. diçka që sipas disave mund të shitet e të blihet në çdo kohë, mund të kalojë nga një dorë tek tjetra pa pyetur të zotin. Me plaçkë e me laçkë me të gjitha ç' ka, me çdo gjë, me tesha e me kotesha. (i ngriti, i ngarkoi) plaçkat iron. u shpërngul dhe shkoi në një vend tjetër; u largua.
- PLAF** m. \* E kishte plafin të madh dikush iron. kishte shumë miq, kishte rreth të gjerë që e ndihmonin dhe e mbronin kur bënte gabime a të këqija.
- PLAGË** f. Lëpijnë plagët (çibanët) e njërit-tjetrit keq. shih te LËPIJ.
- PLAK** m. Djemtë (fëmijët) hanë kumbulla (thana), pleqve u mpihen dhëmbët iron. shih te MPIHEM.
- PLAS** jokal. I ka plasur damari (delli) i ballit (i marres) keq. shih te. DAMAR, ~I. Plasi Muçoja për dyfek tall. shih te DYFEK, ~U.
- PLEKS** kal. 2. fig. keq. Thur; ngatërroj. Pleksin plane djallëzore.
- PLOT** ndajf. Djepi plot e këmbët jashtë iron. shih te DJEP, ~I.
- PLOTGOJË** f. euf. Dreqi, shejtani. E hëngërt plotgoja! mallk.
- PLUMB** m. b) njeri shumë i rëndë, njeri që mezi durohet. Plumb me sheqer iron. shih te SHEQER, ~I.
- PLLAKË** f. \* Si pllakë (si gur) varri shih te VARR, ~I. E ktheu (e ndërroi) pllakën (fletën) keq.
- POETUC** m. keq. Poet i keq e pa talent.

- POHE** f. vet. Me pohe e me bujë. keq. shih te BUJ/Ë,~A.
- POLICOR** mb. keq. 1. Që ka të bëjë me policinë a me policët në vendet borgjeze e revizioniste, që i përket policisë, i policisë; që është karakteristik për policinë në këto vende. Organet policore. Aparati policor. Qendër policore. Dhunë (metodë) policore. 2. Që mbahet më këmbë me anë të policisë e të xhandarmërisë, që sundon duke shtypur me egërsi masat punonjëse; i egër, barbar. Shtet policor. Regjim policor. Organizatë policore. 3. Që trajton tema nga veprimtaria e policisë në vendet borgjeze e revizioniste, që përshkruan ngjarje e aventura vrasësish e grabitësish, të shoqëruara me ndjekje e dhunë policësh e detektivësh. Libër (roman, film) policor.
- POLITIKAN** m. sh 2. bised., keq. Njeri joparimor që sillet e vepron me dredhi për të arritur qëllime të caktuara.
- POLITIKANIZËM** m. libr. keq. Mënyrë veprimi, qëndrim a sjellje prej një politikani joparimor e dhelarak. Ra në politikanizëm.
- POLITIKË** f. 4. keq. dinakëri në qëndrim e në sjellje, dredhi që përdoret nga njerëz joparimorë për të arritur qëllime të caktuara a për të mashtruar dikë. Duhej politikë atëherë. E mori me politikë. Ia mbushi mendjen me politikë.
- POMPOZ** mb. libr. keq. Që bëhet me bujë për të krijuar përshtypje të jashtme a për t'u dukur; i zbukuruar jashtë mase, i stërholluar e i fryrë; bombastik. Fjalim pompoz. Deklaratë pompoze. Ceremoni (pritje) pompoze. Pamje pompoze. Propagandë pompoze. Stil pompoz.
- POMPOZITET** m. libr. keq. 1. Të qenët pompoz. Pompozitet i madh. I dhanë pompozitet. Mbledhje me (pa) pompozitet. 2. Diçka që bëhet për dukje a për bujë; sjellje, veprime a veprimtari pompoze. S'duhen pompozitetet.
- POSHTË** 10. përd. kallëzues. keq. Përdoret në fjali këlhthitëse, kur hedhim parulla kundër armiqve e tradhtarëve. Poshtë armiqtë (tradhtarët, fashistët)! Poshtë imperializmi! Poshtë kapitalistët! \* Sa poshtë ka rënë katundi! mospërf. në ç'gjendje të keqe ka rënë (dikush a diçka). Ulu (poshtë), se të panë! iron. mos u mburr, mos u trego para të tjerëve; ç'na thua! E vuri poshtë dikë
- PRANDAJ** lidh. 2. përd. ndajf. edhe iron. Për këtë shkak, për këtë arsye. Ishte më i madh, prandaj! Aha, s'i pëlqeu, prandaj!
- PRAPASHTESË** f. 2. kryes. fig. keq. Fjalë të tepërta e të kota që thotë dikush për t'iu shmangur një pune ose një detyre; diçka e paqenë që shtohet me një qëllim të caktuar, shtojcë e tepërt, bisht. Fol shkurt e drejt, pa prapashtesa!
- PREDIKOJ** jokal. 2. kal. keq. Përhap një ide, një doktrinë etj. të dëmshme, kundërrevolucionare, antipopullore a antikombëtare; propagandoj diçka të keqe. Ideologët borgjezë predikojnë harmoninë ndërmjet klasave. 3. kal. keq. I flas shumë dikujt, i jap shumë këshilla sa e mërzit, i shes moral. Predikonte gjepura.
- PREDIKUES** m. 2. keq. Ai që përhap një ide, një doktrinë etj. të dëmshme e kundërrevolucionare, antipopullore a antikombëtare; propagandues i diçkaje të keqe. Predikuesit e moralit borgjez. Si predikues në shkretëtirë si predikues që s'e dëgjon asnjëri.
- PREHEM** vetv. 3. vet. veta III iron. Rri, qëndron prej kohësh pa e lëvizur njeri; dergjet. Preheshin ca hekurishte në një qoshe.
- PREKËS** mb. 2. Që ka mani të prekë çdo gjë që sheh, që nuk i rrihet pa prekur diçka; keq. që ka mani a zakon të vjedhë. Djalë prekës.
- PREPOTENCË** f. libr. keq. Forcë që dikush e përdor për të trembur, për të detyruar a për të shtrënguar një tjetër të bëjë

ashtu si thotë ai; pushtet që një nëpunës burokrat e shpërdoron për të urdhëruar të tjerët të bëjnë ashtu siç do ai, pa marrë mendimin e tyre ose pa u këshilluar fare me masat punonjëse; mujshi. Sillej me prepotencë. E kritikuan ashpër për prepotencë.

**PREPOTENT** mb. libr. keq. 1. Që përdor forcën për të detyruar ose për të shtëruar një tjetër të bëjë ashtu si thotë ai; që shpërdoron pushtetin për të bërë ashtu siç do ai, pa marrë mendimin e të tjerëve ose pa u këshilluar me masat punonjëse; që e quan veten më të fuqishëm e më të pushtetshëm se të tjerët; mujshar; që është karakteristik për një njeri të tillë. Nëpunës prepotent. Sjellje prepotente. Veprim prepotent.

**PRES** I kal. E preu malli (barku) për dikë a për diçka! iron. nuk e merr malli për të, as që do ta shohë me sy. Nga një anë të puth, nga tjetra të pret keq. shtihet si i mirë, por s'është i tillë, të vret natën e të qan ditën, është njeri me dy faqe.

**PRISHEM** vetv. \* Nuk u prish bota (dynjaja)! mospërf. s'ka ndodhur ndonjë e keqe e madhe!, nuk u bë kiameti! Iu prish (iu turbullua) gjaku u tremb, u frikësua shumë; u trondit shumë, u shqetësua shumë. m'u prish gjiza! thjeshtligj., iron. shih te GJIZ/Ë, ~A. M'u prish puna! mospërf., iron. nuk ka rëndësi për mua!, s'bëhem merak!, s'më bëhet vonë!, aq më bën!, punë e madhe fort! S'prishet dasma për një qepë (për një limon) fj. u. shih te DASM/Ë, ~A.

**PRISHUR** mb. \* Gramafon i prishur përb. njeri që flet shumë dhe kot, njeri që s'pushon së foluri. Është shoshë e prishur mospërf. është njeri llafazan, është thes i çjerrë.

**PROÇKAMADH** mb. keq. Që bën proçka gjithnjë; që thotë gjithnjë fjalë të kota e të papeshuara.

**PROÇKË** f. keq. Punë a fjalë e papeshuar, gabim trashanik, budallallëk; puna e kotë, pa asnjë vlerë. Bëri një proçkë.

Lëshoi një proçkë. Pasi bëri proçkën, rri e kruan kokën. fj. u.

**PROFESIONALIZËM** m. 2. keq. Prirje e gabuar që shfaqet kur vihet në plan të parë profesioni, kur i jepet rëndësi vetëm njohjes së profesionit, anës teknike e shkencore të tij, duke mos i kushtuar kujdesin e duhur përvetësimit të teorisë marksiste, qëllimit edukues të shkollës etj. Profesionalizëm i ngushtë. Shfaqje profesionalizmi. Të mos biem në profesionalizëm!

**PROPAGANDISTIK** mb. 2. keq. Që synon t'i mbushë mendjen dikujt me fjalë të zbrazëta e të gënjeshtërtë. Makina propagandistike borgjeze e revizioniste. E bëjnë për qëllime propagandistike.

**PROPAGANDOJ** kal. 2. keq. Mundohem t'i mbush mendjen dikujt me fjalë të zbrazëta e të gënjeshtërtë. Propagandonin gënjeshttrat e imperialistëve.

**PRUSH** m. Do të nxjerrë prush me këmbët e maces keq. kërkon të bëjë një punë me dinakëri për të pasur përfitime për vete.

**PULË** f. I ha pula qurrat mospërf. nuk është i zoti as për vete, është shumë i ngathët e i qullët. Rri si pulë e lagur përçm. shih te LAGUR (i, e). U bë veza të mësojë pulën! iron. shih te VEZ/Ë, ~A. Ia merr pula bukën nga dora mospërf. shih te BUK/Ë, ~A. Pula e botës duket më e madhe fj. u. iron. thuhet kur ajo që nuk të përket ty ose ajo që nuk e njeh të duket më e mirë.

**PUNË** f. Punë burrash. iron. Punë grash. mospërf. Punë fëmijësh. mospërf. M'u prish puna! mospërf., iron. shih te PRISHEM. Punë e madhe! mospërf. nuk ka gjë, nuk prish punë. Ajo punë euf. sëmundja e tokës, epilepsia. Puna e herës euf. sëmundja e tokës, epilepsia. Puna e hënës euf. sëmundja e tokës, epilepsia. Puna e truallit euf. sëmundja e tokës, epilepsia.

**PUNËHERË** f. bised. euf. Sëmundja e tokës, epilepsia. E zuri punëhera.



- PUNËKEQ** mb. 3. si em. ~, ~I m. vet. nj. euf. Djalli, i paudhi.
- PUPËL** f. Ia la puplat (pendët) dikujt iron. shih te **PEND/Ë,~A I. b)** keq. nuk ka fare mend në kokë. Nuk i është thyer (nuk i thyhet) pupla në dorë dikujt është shumë i zgjuar, i zoti e i shkathët; nuk ia ha qeni shkopin. Shumë pupla e pak mish fj. u. thuhet për dikë që nga pamja e jashtme duket sikur diç është, por në të vërtetë nuk ka ndonjë vlerë të madhe ose është fyçkë nga mendja; fjalëshumë e punëpakë.
- PUQEM** vetv. Kur të puqet (të bashkohet, të takohet) qielli e toka (qielli me tokën) iron. shih te **QIELL, ~I.**
- PURITAN** m. 2. libr., keq. Ai që mban qëndrim tepër të rreptë e të ngurtë ndaj normave e rregullave të vendosura; ai që mban qëndrim puritan të tepruar. 3. libr., keq. Përd. mb. sipas kuptimeve të emrit. Lëvizja puritane. Morali puritan. Qëndrim puritan.
- PURITANIZËM** m. 2. libr., keq. Qëndrim shumë i rreptë dhe i ngurtë ndaj normave e rregullave të vendosura; ruajtja me fanatizëm dhe me rreptësi të tepruar e gjithçkaje që duket si e drejtë, e rregullt, e mirë etj. Shfaqje puritanizmi.
- PUSULLË** f. \* Pusullë (letër) bakalli keq. shih te **BAKALL,~I.** E humbi pusullën shih te **HUMB.**
- PUTH** kal. \* I puth (i lëpin) këmbët (çizmet) dikujt keq. shih te **LËPIJ.** Puthi kryqin iron. vdiq. Të puth halla në të dy faqet thjeshtligj., iron. shih te **HALL/Ë,~A.** Për çdo punë puth dorën e tij nuk bën asgjë pa lejen a dijeninë e dikujt, kërkon pëlqimin e tij edhe për punë të vogla e të parëndësishme. Nga një anë të puth, nga tjetra të pret keq. është njeri me dy faqe, që hiqet në sy sikur të do, por nga ana tjetër të bën të keqen.
- PUTHEM** vetv. \* Puthu me Milon! thjeshtligj., iron. mbaroi, mori fund, s'ke se çfarë të bësh tashti; s'e gjen më tashti atë që e ke humbur.
- PUTHITEM** vetv. \* Janë puthitur çetelja me çetelen keq. shih te **ÇETEL/E,~JA.**
- QAFË** f. I ishte trashur qafa keq. shih tek **TRASHEM.** Thyej (këput) qafën (arrëzën)! keq. shih te **THYEJ.** E uli (e shtroi) qafën (kurrizin) përb. u nënshtrua pa kundërshtuar, uli zverkun. **GJUH/Ë,~A I.** I vari ujkut mëlçitë në qafë iron. shih te **VAR.**
- QAFËLESH** mb. 2. keq. Që i mban flokët tepër të gjatë mbi zverk sipas një mode të shëmtuar. 3. si em. ~, ~I m. ~Ë, ~ËT keq. Djalë ose burrë që i mban flokët tepër të gjatë mbi zverk dhe që për gjithë paraqitjen e jashtme ndjek një modë të shëmtuar.
- QARAMAN** mb. keq. 1. Që qan orë e çast dhe pa ndonjë shkak, që nuk pushon së qari (zakonisht për fëmijët). Fëmijë (djali)qaraman. Vajzë qaramane. 2. Që qahet për çdo gjë, që ankohet gjithnjë me shkak e pa shkak. Njeri qaraman. 3. fig. Që tingëllon si në të qarë, i përvaajshëm; që shpreh qarje e ankime të tepruara. Zë qaraman. Fjalë (vjersha) qaramane. 4. Përd. em. sipas kuptimeve 1,2 të mbiemrit. Qaraman i madh (i keq). Mos u bëj qaramane!
- QARAMASH** mb. keq. shih **QARAMAN,~E.**
- QARASH** mb. keq. shih **QARAMAN~E 4.**
- QARR** m. bot. \* Kur të bëjë qarri arra iron. kurrë, asnjëherë, kur të pjellë këndesi.
- QATIP** m. vjet. 2. keq. Nëpunës i paaftë e burokrat që merrej gjithë ditën me shkresurina. Qatipët e kohës së Zogut.
- QEJF** m. bised. 6. keq. Tekë. Bën qejfin e tij bën si do, si t'i teket. Bën si i do qejfi. Bën sipas qejfit. Ashtu i desh qejfi. Sot s'ia paska qejfi nuk i qenka tekur. Kur t'i dojë qejfi. I erdhi pas qejfit i pëlqeu shumë, i gjeti zemrën. m'u bë qejfi pushkë u gëzova shumë. s'e bën qejfin qeder nuk shqetësohet fare, nuk bëhet merak, nuk e prish rehatin, nuk i bëhet vonë për asgjë. I bën qejfin vetes keq. shih te **BËJ.** I ka dalë nga qejfi dikujt

- nuk i pëlqen më, i ka dalë nga zemra. I ka hyrë vetja në qejf shih te VET/E,~JA. Për shtatë palë qeje shih te SHTATË.
- QELBASH** mb. keq. 1. Që rri gjithnjë i papastër, fëlliqash. Djalë qelbash. Vajzë qelbashe. 2. Përd. em. sipas kuptimit të mbiemrit.
- QELEPIRXHI** m. bised. keq. Ai që i kërkon e i merr gjërat qelepër; ai që është mësuar të hajë e të pijë ose të rrojë në kurriz të të tjerëve, njeri që shkon pas qelepërit. Qelepërxhi i madh. U doli boja qelepërxhinjve.
- QEN** m. Rron si qen jeton shumë keq. Hahen (zihen) si qentë. Qen me kreshta (me gjemba) keq. shih te KRESHT/Ë,~A. Qen rrugësh (sokaku, zorrësh, sallhaneje) mospërf. njeri pa vlerë, që endet poshtë e përpjetë pa punë. Kapi (zuri) qeni një lepër mospërf., iron. rastisi një herë, një gjë që rastis një herë, nuk është tregues për diçka të përgjithshme. Lehin si qentë në hënëz (në hënë) keq. shih te HËNËZ,~A. E ruan si qeni mishin (si qeni mëlçitë) iron. nuk ia ndan sytë, nuk i ndahet, i është qepur këmba-këmbës (thuhet për dikë që kërkon të zhvatë medoemos diçka nga një tjetër). Rri si qen i dëbuar keq. shih te DËBUAR (i,e). Qeni leh atje ku ha fj. u. keq. thuhet kur dikush mban pa të drejtë anën e atij, nga i cili ka përftime. Ku leh qen e ku del tym, ku bën daullja bum iron. atje ku ka dasmë e aheng, atje shkon (për një njeri, të cilit i pëlqen të bredhë derë me derë e festë me festë).
- QEP** m. krahin. 2. fig. iron. Goja e njeriut. E hapi qepin. Iu çel qepi. Mbylle qepin!
- QETËS** mb. keq. 1. Që vepron pa u ndier e nën rrogos, që është fsheharak e i pabesë, që është thëngjill i mbuluar, tinëzar. Njeri qetës. Grua qetëse.
- QETHEM** vetv. \* Kur të qethen viçat iron. shih te VIÇ,~I.
- QETHUR** mb. \* Shkoi (vajti) për lesh e doli (u kthye, erdhi) i qethur fj. u. iron. shih te LESH,~I.
- QËNDROJ** jokal. Qëndron (vepron) prapa shpinës së dikuajt keq. shih te SHPIN/Ë, A. Qëndron (rri) mbi dy karrige keq. shih te KARRIG/E JA.
- QËROJ** kal. 11. thjeshtligj., keq. Grabit, vjedh, përlaj. Ia qëroi xhepat (paratë). I kishin qëruar tjegullat. Të qëron të bardhët e syrit është vjedhës shumë i shkathët, të vjedh sy ndër sy.
- QIELL** m. a) shumë i gjatë, shumë i lartë; b) keq. mendjemadh. Mbretëria e qiellit fet. shih te MBRETËRI,~A. b) iron. pa ndonjë vlerë të veçantë.
- QIME** f. b) keq. është tinëzar i madh, të dëmton pa u ndjerë fare. Ka qimen (lëkurën) e ujkut shih tek UJK, ~U 1. S'ka ku të gjejë (të nxjerrë) qime nuk gjen dot ndonjë shkak a ndonjë të metë, s'ka ku të kapet. Kërkon qimet e kokës kërkon një shpërblim shumë të madh, jep një çmim jashtëzakonisht të lartë. Kërkon (gjurmon, lyp) qimen në vezë mundohet të gjejë medoemos ndonjë të metë në një punë a në diçka tjetër, kapet pas gjërave fare të vogla e pa rëndësi. Nuk i mungon asnjë qime nuk i mungon asgjë, nuk ka asgjë mangët, i ka të gjitha të mirat. E ndan (e çan) qimen më katërsh (dysh); b) keq. është shumë dorështrënguar;
- QIT** kal. \* Ia qiti (ia hoqi, ia nxori) bojën keq. shih te BOJË,~A I. E qiti (e bëri, e nxori) çirak dikë edhe iron. shih te ÇIRAK,~U I. Ia qiti (ia nxori) nga hundët (nga hunda, për hundësh) diçka keq. shih te HUND/Ë,~A.
- QOFTE** f. gjell. 2. thjeshtligj., keq. Njeri i qullët, që nuk është i zoti për diçka.
- QOFTËLARG** m. euf. Djalli, shejtani (sipas besëtytnive).
- QOLE** I m. bised. 2. keq. Njeri pak i trashë nga mendja, që e përdorin të tjerët si të duan, budalla, leshko. E bënë qole.
- QORR** m. bised. 2. keq. Njeri i pavëmendshëm, ai që nuk shikon se ç'bëhet përreth, njeri i shushatur.

- QORR** mb. bised. \* E bëri qorr dikë keq. u përpoq t'ia hedhë dikujt.
- QOSHE** f. bised. Qoshe e ngrohtë (vend i ngrohtë) keq. shih te **NGROHTË** (i,e). Qoshe e rehatshme keq. shih te **REHATSH/ËM** (i), **~ME** (e).
- QUAJ** kal. Kushedi se ç'e quan veten! iron.
- QULL** m. \* I mbeti luga në qull iron. shih te **LUG/Ë,~A**. s'e nxjerr (dot) qimen aga qulli shih te **QIM/E, ~JA**.
- QULLAC** mb. bised. keq. shih **QULLASH,~E**.
- QULLASH** mb. bised. keq. 1. Që nuk është i zoti e i shkathtët, i plogët, i qullët. Fëmijë qullash.
- QULLOS** kal. bised. 2. fig. iron. E bëj keq një punë, nuk ia dal ta bëj mirë, e prish. E ka qullosur këtë punë. E qulloi fare, të shohim ç'na ka qullosur.
- QULLOSEM** vetv. bised. 3. vet. veta III fig. iron. Bëhet keq një punë, nuk del mirë, prishet. U qulloi puna.
- QUMËSHT** m. \* Djalë qumështi (mama) mospërf. shih te **MAMA,~JA**.
- QURRAC** mb. keq. shih **QURRASH,~E**.
- QURRAK** mb. keq. shih **QURRASH,~E**. 1. Që i ka hundët gjithnjë me qurra; që i kullojnë qurrat e nuk i fshin. Fëmijë qurrash. 2. fig. Që është me karakter të dobët, që përulet para kujtdo e para çdo gjëje, që nuk ka kockë; që ankohet e qahet vazhdimisht; frikacak. Njeri qurrash.
- QURRAN** m. keq. 1. Ai që ka shumë qurra, ai që të ngjall neveri duke i tërhequr qurrat. S'e shoh dot me sy atë qurrën.
- QURRASH** mb. keq. 1. Që i ka hundët gjithnjë me qurra; që i kullojnë qurrat e nuk i fshin. Fëmijë qurrash. 2. fig. Që është me karakter të dobët, që përulet para kujtdo e para çdo gjëje, që nuk ka kockë; që ankohet e qahet vazhdimisht; frikacak. Njeri qurrash.
- QURRAVEC** mb. keq. shih **QURRASH,~E**.
- QURROJ** kal. bised. 2. fig. keq. E prish puqën, e qulloi. E qurroi punën.
- QYFYREXHI** m. bised. 2. keq. Ai që nuk punon, po sillet lart e poshtë duke treguar qyfyre, llafazan e dembel.
- QYL** II m. bised. 1. E ngrënë ose e pirë pa paguar asgjë; një send a diçka tjetër që merret rastësisht falas. I pëlqen qyli. I bie qylit. thjeshtligj., keq. e ka zakon t'i marrë gjërat falas, i pëlqen e përpiqet të hajë e të pijë në kurriz të të tjerëve. 2. edhe **~A, ~AT** keq. Njeri që nuk punon, por e pret çdo gjë nga të tjerët; njeri për-tac, i ngathët e i pazoti.
- QYLAXHI** m. bised. keq. Ai që e ka zakon të hajë e të pijë pa paguar asgjë kur i del rasti, ai që mundohet të hajë e të pijë qyl.
- QYTETËROJ** kal. 2. keq. iron. Pushtoj e shfrytëzoj një vend më të prapambetur; duke u paraqitur sikur e bëj këtë për t'i shpënë atij zhvillimin e kulturën (për kolonizatorët).
- QYTETËRUAR** mb. 3. keq., iron. Që e paraqit veten më të zhvilluar, duke për-buzur të tjerët si më të ulët e të prapambetur. Të ashtuquajturat «vende të qytetëruara».
- QYTETËRUES** mb. 2. keq., iron. Që shtyp dhe shfrytëzon një vend më të prapambetur, duke u paraqitur sikur e bën këtë për t'i shpënë atij zhvillimin e kulturës (për kolonizatorët). 3. keq., iron. Përd. em. sipas kuptimit 2 të mbiemrit. Mbjajnë maskën e qytetëruesve.
- RACIAL** mb. 2. keq. Që mbështetet në dallimin e prerë e rrënjësor të racave njerëzore dhe në kundërvënien e tyre; që i ndan racat e njerëzve në «të larta» e «të ulëta» e që u vesh atyre cilësi e vlera thelbësore jo të barabarta; që e quan racën e bardhë si racën më të lartë dhe për-buz racat e tjera si më të ulëta; racist. Diskriminim (dallim) racial. Teori (politikë) raciale. Shtypje (urrejtje, ndjekje) raciale.

- RAFINUAR** mb. 3. fig. keq. Që është tepër dhelparak e i mbuluar; që vepron me mënyra dinake e shumë të stërholluara. Njeri (armik) i rafinuar. Mënyrë (metodë) e rafinuar. Propaganda (demagogji) e rafinuar. Mjete të rafinuara.
- RAJA** f. 3. keq. Njeri i nënshtruar, që pranon pa bërë zë zgjedhën e tjetrit; shërbëtor a puthador i dikujt. Raja i bindur. U bë raja i dikujt.
- REGJUR** mb. 4. keq. Që ka kohë që merret me një veprimtari të dëmshme dhe nuk heq dorë prej saj, i betuar. Kriminel (spion, agjent, armik) i regjur. Ujk i regjur.
- REHATI** f. bised. 1. Gjendje qetësie, pa shqetësime e pa kokëçarje, prehje; keq. prirja për të jetuar e për të punuar pa shqetësime dhe pa kokëçarje. Rehatia personale. Ndjenja e rehatisë. Prirja për rehati. Prish rehatinë. Shikon rehatinë e vet. Ka rënë në rehati. I ngriti rehatinë dikujt e shqetësoi.
- REHATSHËM** mb. bised. \* Qoshe e rehatshme keq. vend pune ku ka pak për të bërë, punë e lehtë pa kokëçarje e pa shqetësime.
- REKLAMË** f. 3. keq. Përpyetje për ta bërë sa më të njohur dikë a diçka e për t'i rritur vlerën para syve të botës, prirje për të bërë bujë. Prirje për bujë e për reklamë. I bën reklamë vetes. I bëjnë reklamë të madhe.
- REKLAMIST** m. keq. Ai që i bën reklamë vetes, ai që përpiqet të vërë në dukje përherë punët e aftësitë e veta, zakonisht duke i zmadhuar e zbukuruar, lëvdatëmadh.
- REKLAMOJ** I kal. 2. keq. Lëvdoj me të madhe dikë a diçka për ta bërë sa më të njohur, duke i rritur vlerën para syve të botës.
- REKLAMUES** I m. 2. keq. Ai që përpiqet të bëjë sa me të njohur dikë a diçka për t'i rritur vlerën para syve të botës. Reklamues i zellshëm. Reklamues i kapitalizmit. Luan rolin e reklamuesit.
- REKLAMUES** mb. 2. keq. Që përpiqet të bëjë reklamë për dikë a për diçka. Zhurmë reklamuese. Mbledhje reklamuese.
- REND** jokal. 3. fig. keq. Jepem fort pas diçkaje që sjell fitime a përfitime vetjake ose që më intereson a më pëlqen, duke lënë pas dore të tjerat, bredh. Rend pas parasë (pas lekut, pas fitimeve). Rend pas sasisë. Rend pas interesit personal (pas lavdisë, pas qejfeve).
- REPART** m. \* Shpirti i repartit keq. prirja e dikujt për t'u kujdesur e për t'u përpjekur vetëm për interesat e një grupi të ngushtë, ku bën pjesë ai vetë.
- RETORIKË** f. libr. 2. fig. keq. Retorizëm. Flet (shkruan) pa retorikë. Ka shumë retorikë.
- REVANSHIST** m. keq. Përkrahës i revanshizmit. Revanshistët gjermanë. Planet e revanshistëve. Qëllimet e revanshistëve.
- REVANSHIST** mb. keq. Që synon të rimarrë me luftë tokat e pozitat e humbura në luftërat e mëparshme dhe të hakmerret ndaj kundërshtarëve; që ka të bëjë me revanshistët, që u përket revanshistëve, i revanshistëve. Forca revanshiste. Politikë (veprimtari) revanshiste. Ushtri revanshiste. Plane revanshiste.
- REVANSHIZËM** m. keq. Politika që ndjekin e synimi që kanë qarqet reaksionare të një vendi për të rimarrë me luftë tokat e pozitat e humbura në luftërat e mëparshme dhe për t'u hakmarrë ndaj kundërshtarëve. Revanshizëm militarist. Revanshizmi gjerman.
- RËNDË** f. euf. Ajo punë, ajo e tokës, epilepsia. E zu e rënda.
- RËNDË** as. \* Të rëndët e dheut euf. ankthi. I çohet të rëndët i vjen për të vjellë.

- RËNDË** ndajf. 5. Me fjalë të rënda; ashpër, rreptas, keq. I foli rëndë. E kritikoi (e qortoi) rëndë. 7. Në gjendje të keqe shëndetësore, keq. I sëmurë rëndë. Është rëndë. U gdhi rëndë.
- RI** mb. \* Ilaç i vjetër në shishe të re keq. shih tek ILAÇ~I.
- ROB** m. 4. fig. keq. Ai që është i detyruar të zbatojë verbërisht urdhrat dhe dëshirat e dikujt; ai që është në pushtetin e plotë të diçkaje, që ndjek në mënyrë të verbër diçka; skllav. Rob i zakoneve prapanike. Rob i veseve (i lakmive). Nuk bëhem rob i tjetrit.
- ROJË** f. b) fig. keq. njeri që bëhet vegël besnike e dikujt për të mbrojtur interesat e tij. Ndërrim roje heqja e një njeriu ose e një grupi të veçantë dhe zëvendësimi me të tjerë në një post drejtues pa sjellë ndonjë ndryshim në politikë ose në mënyrën e drejtimit.
- RUAJ** kal. \* E ruan si qeni mishin (si qeni mëlçitë) iron. shih te QEN,~I.
- RUDE** mb. \* Sa më thellë, më ruda iron. thuhet për një punë, që sa më tej i shkohet, aq më e ndërlikuar del.
- RRAFSHOJ** kal. 6. fig. keq. Fshij, zhduk mekanikisht dallimet e veçoritë ndërmjet veprave, vlerave etj., i quaj të gjitha njësoj, i fut të gjitha në një thes. I rrafshoi veprat. Nuk duhen rrafshuar të mirat me të këqijat.
- RRAH** kal. 12. euf. Tredh. Rrahën demin (dashin, cjapin).
- RRAHUR** mb. 6. euf. I tredhur. Dash (cjap, dem) i rrahur.
- RRANGALLË** f. 3. fig. keq. Vepër a diçka tjetër që nuk ka asnjë vlerë. Rrangallë e vjetër borgjeze.
- RRASË** f. \* Ka gjetur rrasa vegshin (vorbën) keq. janë njësoj njëri me tjetrin, ka gjetur tenxherja kapakun.
- RRETH** m. \* Mori rrethin e daulles iron. nuk mori asgjë. I vuri rreth kokës e vuri veten në një gjendje të vështirë, i nxori kokëçarje vetes.
- RRËFEJ** kal. \* I rrëfeu (i tregoi) rrugën (udhën) dikujt mospërf. shih tek UDH/Ë,~A. I rrëfeu (i tregoi) shkopin dikujt shih tek TREGOJ. I rrëfen (i tregon) babait arat iron. shih te BABA,~I.
- RRËMBEJ** kal. \* Të jep një thellë e të rrëmben (të merr) një pelë keq. shih te THEL/Ë,~A. P
- RRËMUJAXHI** m. bised. keq. 1. Njeri që nuk mban rregull në punë e në vendin ku jeton. 2. Ai që sjell çrregullime e pështjellime, ai që bën rrëmujë. Rrëmujaxhi i madh.
- RRËMUJËMADH** mb. bised., keq. 1. Që nuk di të mbajë rregull në jetë e në punë, që i bën të gjitha rrëmujë. 2. Që i bën punët me rrëmujë e potere, që sjell çrregullime e pështjellime. 3. Përd. em. sipas kuptimit të mbiemrit. Është një rrëmujëmadh i pandreqshëm.
- RRËSHQANËS** m. 2. euf. Gjarpër.
- RRËZALL** m. 3. fig. keq. Njeri pa vlerë nga llumi i shoqërisë, fundërrinë.
- RRËZOHEM** vetv. 8. bised. keq. Largo-hem kundër dëshirës nga një vend, shporrem. Rrëzohu që këtej! \* Është rrëzuar (një herë) nga dardha dikush shih te DARDH/Ë,~A. U rrëzua (ra, zbriti) nga fiku iron. shih te FIK,~U. Iu rrëzua (i ranë) pendët (puplat) shih te PEND/Ë,~A I. U rrëzua kali, t'i presim këmbët! iron. shih te KAL/Ë,~I.
- RRI** jokal. \* Rri (qëndron) mbi dy karrige keq. shih te KARRIG/E,~IA. Rri (rron, jeton, është) në hijen e dikujt keq. shih te HIJ/E,~A. I rri me grushte hundëve dikujt keq. shih te HUND/Ë,~A.
- RRIPË** f. \* Ai i rripave euf. djalli, shejtani, ai i përroit. Përpara rripë e prapa thikë keq nga të dyja anët, vështirë andej e vështirë këtej. Mori rripën mori tatëpjetën. Mori rripat (skërkat) iku, u arratis, mori malet.

- RRIT** kal. \* Ia rrit fjalën dikujt keq. ia miraton e ia përkrah ato që thotë pavarësisht nëse e ka mirë ose jo, ia ushqen fjalën. Ia rrit mendjen (ia rrit veshët) dikujt i bën lëvdata të tepruara, e bën të mburret e t'i pëlqejë vetja. Rrit (mbaj) gjarprin në gji shih te GJARP/ËR,~RI. Rrit sorrën të të nxjerrë sytë shih te SORR/Ë,~A.
- RRITEM** vetv. I janë rritur (i janë zgjatur) thonjtë keq. shih te THUA, THOI. I janë rritur veshët dikujt shih te VESH,~I. Më rritet zemra ndiej kënaqësi të madhe për diçka, më bëhet zemra mal. Është rritur në prehër të nënës edhe mospërf. shih te
- RRJEDHUR** mb. bised. keq. Që ka humbur aftësinë për të gjykuar qartë e në mënyrë të shëndoshë, i matufosur, që e ka lënë mendja, matuf. Plak i rrjedhur.
- RRJEPËS** I m. 2. keq. Ai që grabit ose që shfrytëzon të tjerët pa mëshirë.
- RRODHE** f. bot. 3. fig. keq. Njeri që u ngjitet nga pas të tjerëve e i mërzit. Nuk m'u hoq qafe ai rrodhja. Erdhi edhe ky rrodhja.
- RROGËTAR** m. 4. keq. Ai që i shërben dikujt si vegël për të nxjerrë fitime, shërbëtor. Rrogëtarët e fashizmit. Rrogëtar i pushtuesve.
- RROJ** jokal. \* Rroftë sebepi iron. përdoret kur dikush shfrytëzon një shkak, një rast a një rrethanë çfarëdo për të bërë diçka ose për të nxjerrë ndonjë përfitim. Rroftë sa kungulli në brymë! iron. shih te BRYM/Ë,~A. Na rrofsh për dimër, se për verë jemi vetë thjeshtligj. iron. shih te DIM/ËR,~RI. Rron (jeton, rri, është) në hijen e dikujt keq. shih te HIJ/E,~A.
- RROTË** f. \* I ka lyer rrotën dikujt keq. shih te LYEJ.
- RRUAZË** f. Zuri rruazën (qafën, zverkun) keq. shih te ZË.
- RRUFJAN** m. keq. 1. Ai që ndërmjetëson në punë të ndyra dhe të pamoralshme; kodosh. Bën punën e rrufjanit. 2. Njeri i pandershëm, që vepron me dredhi e me pabesi dhe që bëhet vegël e të tjerëve për punë të këqija. Rrufjan i madh. Rrufjan politik.
- RRUGAÇ** m. keq. 1. Ai që sillet rrugëve, ai që nuk ka një vend të përhershëm jetese, endacak. Jetë rrugaçësh. 2. Fëmijë a djalosh që nuk sillet mirë në shoqëri, që i mungon edukata e shëndoshë; ai që fyen të tjerët pa asnjë shkak, që zihet kot me të tjerët dhe bën veprime të pahijshme e dëme. Fjalë (punë) rrugaçësh. Sillet si rrugaç. Riedukimi i rrugaçëve.
- RRUGAÇ** mb. keq. 1. Që sillet rrugëve, që nuk ka një vendbanim të përhershëm jetese; endacak. Djalë rrugaç. Vajzë (grua) rrugaçe vajzë (grua) e pamoralshme. Qen rrugaç. 2. Që sillet e vepron si rrugaç (zakonisht për fëmijët e të rinjtë). Fëmijë rrugaçë.
- RRUGË** f. \* I tregoi (i rrëfeu) rrugën (udhën) dikujt mospërf. shih tek UDH/Ë,~A.
- RRUMBULLAKOS** kal. 2. keq. Paraqit një çështje a një mendim, duke i hequr ose duke i mbuluar anët e mprehta, të padëshirueshme a kontradiktore; sheshoj, zbut. I rrumbullakos gjërat.
- RRUMBULLAKOSUR** mb. 2. keq. Që i janë hequr a mbuluar anët e mprehta, të padëshirueshme a kontradiktore. Fraza të rrumbullakosura.
- RRUNGAJË** f. 7. fig. keq. Njeri i trashë, kërcu.
- SAHAN** m. \* Lëpin sahanët (çanakët) e dikujt keq. shih te LËPIJ. I ka sahanët pa kapak shih te KAPAK,~U.
- SAHAT** m. bised. \* E pa sa ishte sahati iron. e mori vesh, e kuptoi si qëndronte puna.
- SAJIM** m. 4. keq. Gjë e shpikur nga mendja, diçka që nuk është e vërtetë, trillim. Sajime të rrezikshme (të kota, të ulëta). Janë të gjitha sajime të tij.
- SAJUAR** mb. 2. edhe keq. Që është nxjerrë nga mendja, që nuk është i vërtetë; i trilluar, i shpikur. Gënjeshtër e sajuar. Gjëra të sajuara. Tregim i sajuar. Ngjarje e sajuar.

- SALEPÇI** m. vjet. 2. keq. Njeri pa vlerë dhe me zakone të vjetra anadollake.
- SALLON** m. 3. keq. Sallë pritjeje në një shtëpi aristokratësh ose borgjezësh, që shërben edhe si qendër ku mbledhet një rreth njerëzish të klasave të privilegjuara me pikëpamje të caktuara politike, estetike etj. Sallonet aristokratike. Sallone letrare (politike). Politikë sallonesh. Letërsi (poezi) sallonesh. Muzikë (piketurë) sallonesh. Zakonet e salloneve.
- SALLTANET** m. bised., keq. 1. Shkëlqim i tepruar e madhështi e jashtme në veshje, në stoli, në pajisjen e shtëpisë etj.; gjëra tepër të shtrenjta që mbahen për stoli e dukje të jashtme. Salltanet i madh. Salltaneti i shtëpisë. Salltanet në veshje. Salltanetet e grave. I veshur me salltanet. Dhomë pune pa salltanete. Rronte në salltanet. 2. Sjellje e jashtme e veprimtari me shkëlqim e madhështi të tepruar. E pritën me salltanet. Ecën me salltanet. Po na vjen me salltanet.
- SAMAR** m. 2. iron. Kurrizi i njeriut. I mban samari. E mban mbi samar. \* Po e vret samari dikë iron. po e shqetëson diçka që i kanë thënë, po e djeg fjala që ka dëgjuar.
- SARAF** m. vjet. 2. keq. Njeri shumë dorështrënguar, koprrac, dorërrudhur. Ishte saraf i madh. 3. si mb. ~, ~E keq. Dorështrënguar, koprrac. Njeri saraf. Grua sarafe.
- SARHOSH** m. keq. 1. Pijanec, pirash. Sarhosh i keq (i madh). Sy (shikim) sarhoshi. Sjellje sarhoshësh.
- SASI** f. Rend pas sasisë. keq.
- SATELIT** m. 3. fig. keq. Shtet ose klikë në fuqi që ndjek në mënyrë të verbër dhe pa parime politikën e një shteti tjetër më të madh e më të fuqishëm. Satelitët e imperialistëve.
- SEBEP** m. bised. vjet. \* Rroftë sebepi! iron. shih te RROJ.
- SEHIR** m. bised. \* Për sehir sa për të kaluar kohën, pa bërë asnjë punë. Bën (mban) sehir keq. nuk merr pjesë, nuk ndihmon për një punë a për një fatkeqësi, rri duar-lidhur kur duhet bërë diçka.
- SEHIRXHI** m. bised. 2. keq. Ai që sodit duar-lidhur kur duhet bërë diçka, ai që nuk merr pjesë a nuk ndihmon për një punë a për një fatkeqësi; indiferent. Qëndrim (prej) sehirxhiu. Nuk rri sehirxhi para këtyre shfaqjeve.
- SEKS** m. (i bukur, delikat) edhe iron. gratë, sipas paragjykimeve mbi dallimin e meshkujve nga femrat. Seksi mashkullor burrat. Seksi femëror gratë.
- SEKT** m. 2. fig. zakon. keq. Grup që del me pikëpamje të ndryshme nga ato që ka një organizatë politike më e gjerë; grup i ngushtë e i mbyllur personash me interesa të veçanta dhe i shkëputur nga masat. Sekt i mbyllur. Sekt anarkistësh.
- SEKTAR** mb. keq. Që është karakteristik për një grup të ngushtë e të mbyllur brenda një organizate politike; që është i shkëputur brenda interesave të ngushta të një grupi; i ngushtë e i njëanshëm. Frymë sektare. Qëndrim sektar. Politikë sektare. Shfaqje sektare.
- SEKTARIZËM** m. keq. Shkëputje e lidhjeve me masat, duke u mbyllur brenda interesave të ngushta të një grupi; frymë sektare, qëndrim sektar. Rreziku i sektarizmit. Lufta kundër sektarizmit në parti.
- SEKTORIAL** mb. 2. fig. keq. Që shikon ose mbron vetëm interesat e ngushta të një sektori. Frymë sektoriale. Prirje të ngushta sektoriale.
- SEND** m. 6. bised., euf. Sëmundje e papritur a dobësi e menjëhershme që e godet njeriun; damlla, pikë. I ra një send. Për pak nuk i ra një send.
- SENDËRGJOJ** kal. 2. keq. Shpif, trilloj. Sendërgjonte gënjeshtër.
- SENSUALIZËM** m. 2. keq. Prirja për të vënë mbi çdo gjë kënaqësinë e shqisave dhe të epsheve. Sensualizëm i sëmurë. Sensualizmi i letërsisë dekadente.

- SERVIL** m. keq. Njeri pa karakter që u përulet orë e çast e u bën lajka më të fuqishmëve për t'u hyrë në qejf e për të pasur përfitime vetjake; puthador. Nuk i duron dot servilët.
- SERVIL** mb. keq. Që u përulet orë e çast e u bën lajka më të fuqishmëve për t'u hyrë në qejf e për të pasur përfitime vetjake; shpirtrob, shpirtskllav; që është tipar i një njeriu të tillë. Njeri servil. Qëndrim servil.
- SERVILIZËM** m. keq. Të qenët servil sjellje a qëndrim prej servili.
- SEVDALLI** mb. bised. 1. iron. Që dashurohet lehtë, që bie shpejt në dashuri. Kokëkrisur e sevdalli. Bandill sevdalli.
- SËPATË** f. \* Si lata, sëpata keq. shih te LAT/Ë, ~A I.
- SILUROJ** kal. 2. fig. keq. Bëj që të dështojë a të përfundojë keq diçka a dikush, duke vepruar fshehurazi; minoj. Siluruan konferencën (mbledhjen, marrëveshjen).
- SILURUES** m. 2. fig. keq. Ai që përpiqet fshehurazi të dëmtojë dikë a diçka a të bëjë të dështojë diçka a dikush.
- SILURUES** mb. 2. fig. keq. Që përpiqet fshehurazi të dëmtojë a të bëjë të dështojë diçka a dikush. Veprimtari përçarës dhe siluruese.
- SIRTAR** m. \* E futi (e vuri) në sirtar diçka keq. e la pa zgjidhur një punë a një çështje që ia kishte paraqitur dikush me shkrim.
- SJELL** I kal. \* E solli (e pruri) kokën mospërf. shih te KOK/Ë, ~A. E ka sjellë laraska iron. shih te LARASK/Ë, ~A.
- SKENË** f. \* Prapa skenës keq. fshehurazi nga sytë e botës, pa e marrë vesh të tjerët.
- SKLLAV** m. 3. fig. keq. Ai që ka humbur lirinë dhe ka rënë në varësi të plotë politike, ekonomike etj. të një tjetri; njeri që u nënshtrohet verbërisht dëshirave dhe vullnetit të dikujt, rob. Skllavë të kapitalit (të borgjezisë). Përujje (shpirt) prej skllavi.
- SKOTË** f. 3. keq. Soj a fis me përbërje të keqe; grup njerëzish me një tipar të keq. Skotë e ligë (e mbrapshtë). Skotë tradhtarësh (fundërrinash).
- SKUTH** m. keq. Ai që i fsheh veprimet e qëllimet e veta dhe që paraqitet ndryshe nga ç'është në të vërtetë, thëngjill i mbuluar; tinëzar. Skuth i keq. Çfarë skuthi që është! Rua ju nga ai skuth!
- SKUTHËRI** f. keq. Qëndrim ose veprim prej skuthi; tinëzi. Veproi me skuthëri.
- SLOGAN** m. libr. kryes. keq. Frazë e shkurtër që përsëritet për të propaganduar diçka; parullë e zbrazët ose mashtruese. Slogane bajate (demagogjike). Slogane propagandistike.
- SLAVOMADH** mb. keq. Që synon të shtrijë sundimin e shteteve sllave mbi vende të banuara nga popuj joslavë; që i shërben këtij synimi. Organizatë sllavomadhe. Qëllimet (synimet) sllavomadhe.
- SOCIALIST** mb. 4. keq. Që ka të bëjë me një parti reformiste me parime socialdemokrate, që është karakteristik për një parti reformiste socialdemokrate. Partitë socialiste të Evropës.
- SODIT** kal. 2. edhe keq. Vështroj punën ose veprimtarinë e të tjerëve pa marrë pjesë vetë, rri e shikoj. Sodiste me duar në ijë.
- SOFËR** f. 4. fig. keq. Rrethi i interesave e i qëllimeve të përbashkëta të një grupi. Në sofrën e interesave imperialiste. Ha (shtrohet, rri) në një sofër me dikë ka po ato interesa e qëllime me dikë.
- SOFIST** m. 2. keq. Ai që përdor sofizmat për ta paraqitur si të vërtetë diçka që duket qartë se është e rreme. Arsyetime prej sofisti.
- SORRË** f. zool. \* Si sorrat pas kërmës keq. me lakmi a me dëshirë të madhe.
- SPECIALIST** m. 2. bised. Njeri shumë i aftë për diçka; njeri të cilit i vjen doresh shumë për diçka, mjeshtër i mirë. Specialist i mbaruar. Specialist për gjithçka edhe iron. Është specialist për të tilla punë.



- SPEKTATOR** m. 2. fig. keq. Ai që është i pranishëm në një ngjarje, në një punë etj. dhe vështron pa u përzier e pa u shqetësuar për të; soditës, sehirxhi. Qëndrim prej spektatori. Nuk qëndruan spektatorë.
- SPËRDRIDHEM** vetv. 2. keq. Bëj lëvizje të tepruara e të pahijshme me trup, tundem e shkundem, përdridhem. Dridhet e spërdridhet. Hidhet e spërdridhet. Spërdridhen si ngjالات në grep.
- SPICËTAR** m. keq. Ai që fut spica, ngatërrstar, intrigant.
- SPIRË** I f. mjek. 2. keq. Supë fare e hollë e pa shije, gjellë e keqe tërë lëng, fare pa yndyrë; spirilëng. As që futej në gojë ajo spire.
- SPIRILËNG** m. keq. Gjellë shumë e hollë, fare pa yndyrë dhe pa shije, lëtyrë. Ç'është ky spirilëng!
- SPITULLAQ** mb. keq. 1. Që vishet e stoliset jashtë mase për t'u dukur, që pispilloset. 2. Përd. em. sipas kuptimit të mbiemrit.
- SPITULLIM** m. keq. 1. Veprimi sipas kuptimeve të foljes SPITULLOHEM. 2. Stërholim i tepruar në veshje, në paraqitjen e jashtme, në sjellje etj.; qëndrim jo i natyrshëm për t'u dukur para të tjerëve; pispillose. Gjithë naze e spitullime.
- SPITULLOHEM** vetv. keq. 1. Vishem e stolisem jashtë mase për t'u dukur, pispillosem për të tërhequr vëmendjen e të tjerëve. Spitullohej dhe shiste mend. 2. Sillem me mënyra të stërholluara për të rënë në sy, mbahem në mënyrë jo të natyrshme.
- SQEP** m. b) nuk arriti ta shtinte në dorë a ta bënte të vetën diçka. E ka sqepin të gjatë shih te GJATË (i,e). Ka ulur pak hundën, por ka ngritur sqepin iron. shih tek UL.
- STALLË** f. \* Stallë (thark) derrash keq. shih te DERR,~I.
- STELË** I f. 3. fig. mospërf. Banesë ose dhomë fare e vogël dhe e mbajtur keq. Banonte në një stelë.
- STEREOTIP** m. 3. si mb. ~, ~E. Që përsëritet vazhdimisht pa asnjë ndryshim; keq. shabllon, standard. Fjalë (shprehje, fraza) stereotipie.
- STËRSHITEM** vetv. 2. keq. Vihem vazhdimisht në shërbim të njërit e të tjetrit për para e për përfitime të tjera vetjake, shitem herë te njëri e herë tek tjetri, duke tradhtuar atdheun, popullin etj. Ishte nga ata që shiteshin e stërshiteshin.
- STOLISUR** mb. I zbukuruar me stoli ose me gjëra të tjera. E nisur dhe e stolisur e veshur me rroba të reja dhe e lyer për t'u dukur më e bukur; iron. e zbukuruar në mënyrë të tepruar, e pispillosur.
- STROFKË** f. 2. fig. keq. Vend ku fshihen dhe përgatiten për veprimtarinë e tyre keqbërësit ose armiqtë. Strofkë kriminelësh. Strofkë e fundit e agresorëve (e reaksionit). I goditën mu në Strofkë. U shkatërroi strofkat.
- STRUKEM** vetv. 3. fig. keq. Fshihem në ndonjë vend pasi jam mundur e shpartalluar. Shtëpitë ku ishin strukur pushtuesit (tradhtarët).
- SUBVERSIV** mb. libr., keq. Që ka për qëllim të përmbysë rendin në fuqi ose të dëmtojë pushtetin e ligjshëm nëpërmjet veprimtarisë së fshehtë. Veprimtari subversive. Shpartallimi i veprimeve subversive të imperialistëve.
- SUITË** f. libr. 2. iron. Njerëzit që i venë nga pas dikujt, të gatshëm për të plotësuar urdhrat e dëshirat e tij. Erdhi me gjithë suitën e tij.
- SURRAT** m. bised. 2. keq. Fytyrë e shëmtuar, e keqe ose e ndyrë; turi. Njeri me dy surrate. Ia dha (ia hoqi) surratit. Ia përplasi në surrat. S'dua t'ia shoh më surratin. 3. keq. Njeri me fytyrë të shëmtuar a të keqe; fig. njeri i keq e zemërlig,

- që nuk e duam. Ku u gjend edhe ai surrat atje.
- SUSTË** f. 5. fig. keq. Diçka që shërben si forcë lëvizëse. Paraja si sustë e shoqërisë borgjeze.
- SY** m. \* E do si kripën në sy dikë iron. shih te KRIP/Ë, ~A. I arrijnë sytë gjer te maja e hundës keq. shih te HUND/Ë, ~A. Një copë mish me dy sy mospërf. shih te MISH, ~I. Të jep thonjtë e bufit për të të nxjerrë sytë keq. thuhet kur dikush të bën një të mirë të vogël gjoja për të të ndihmuar, por synon që më pas të të bëjë një të keqe të madhe.
- SYÇAKËRR** mb. keq. Syvëngër, vëngarash, syll. Fëmijë syçakërr.
- SYKAÇKË** mb. keq. Syrrush.
- SYMACE** mb. keq. Që i ka sytë të bardhë e të ndritshëm si të maces.
- SYNIM** m. 2. kryes. keq. Qëllimi i fshehtë a i hapur për të shtënë në dorë me çdo mjet një vend ose për të vendosur sundimin mbi të tjerët. Synimet grabitqare të fashizmit (të imperializmit).
- SYPLASUR** mb. keq. 1. Që nuk shikon mirë nga sytë ose që nuk tregon kujdes kur bën diçka; si mallk. që i plaçin sytë. Nuk e sheh, more syplasur! 2. Që gënjehet lehtë; që nuk dallon të mirën nga e keqja a mikun nga armiku, sylesh. 3. shih SYKEQ, E. 4. Përd. em. sipas kuptimeve të mbiemrit. Ç'na bëri, syplasuri!
- SHABLLON** m. 4. përd. ndajf. keq. Ashtu siç është, pa i ndryshuar e pa i shtuar gjë, pa krijuar vetë asgjë, kallëp. E mori (e zbatoi) diçka shabllon.
- SHABLLONIST** m. 2. fig. keq. Ai që flet, shkruan a vepron duke përsëritur tërësisht diçka të njohur, e cila është përdorur më përpara nga shumë të tjerë, ai që kopjon mekanikisht pa krijuar vetë asgjë. Vepron si shabllonist.
- SHAJ** kal. \* Shan shtamba të zotin iron. shih te SHTAMB/Ë, ~A. Këtej të pi verën, andej të shan derën shih te PI.
- SHAJTOHEM** vetv. 1. Vritem keq në një gjymtyrë a në një pjesë të trupit, duke u goditur pas diçkaje të fortë, shembem. U shajtova keq.
- SHAKLLABAN** mb. keq. 1. Llafazan, që nuk i pushon goja, fjalëshumë. Grua shakllabane. 2. krahin. I mefshtë, i ngathët, i qullët; që nuk përzihet me njeri. Djalë shakllaban. 3. Përd. em. sipas kuptimeve të mbiemrit.
- SHALË** II f. I shkon (i ka hije) si shala gomarit iron. nuk i shkon fare, nuk i përshtatet (për një rrobë etj.). Shkoi (vajti) gjaku deri në shalë (deri në bark) të kalit (deri në tra) shih te BARK, ~U. Zbriti (u ul) nga shala e hipi në samar iron. ra nga përgjegjësia, zbriti nga një detyrë a punë e lartë në një detyrë a punë më të ulët, zbriti nga kalit e hipi në gomar.
- SHALËNGJITUR** mb. keq. Që mezi lëviz, i ngathët; që nuk është punëtor, që nuk e shpie një punë deri në fund. Është shalëngjitur ai.
- SHARTOJ** kal. 5. fig. keq. Bashkoj në mënyrë jo të natyrshme pikëpamje, ide a gjëra që në thelbin e tyre janë të ndryshme a të papajtueshme. Përpiqen të shartojnë materializmin dialektik me ideologjinë borgjeze.
- SHASTISUR** mb. 2. keq. I ngathët nga mendja e hutuaq, i hutuar. Njeri i shastisur.
- SHAT** m. \* Shati tërheq nga vetja fj. u. keq. thuhet për një njeri që mendon më parë a më shumë për të mirën e vet, për nevojat e veta.
- SHEJTAN** m. 2. fig. thjeshtligj. keq. Njeri dinak e shpirtkeq, njeri i prapë i prirë për prapësira e për të ngatërruar të tjerët; djall, dreq. Është një shejtan ai, që... \* Është bërë si shejtani keq. është fëlliqur shumë, është ndotur i tëri. Ka lindur përpara shejtanit keq. ia kalon edhe shejtanit në djallëzi, është dinak i madh dhe shumë i prapë. Është i shejtanit e i mejdanit është i zoti të bëjë edhe keq, edhe mirë, është i zoti për të gjitha

punët. Shejtan (djall, dreq) me brirë thjeshtligj. shih te BRI,~RI. Ia bëri pajë shejtanit (dreqit) shih te PAJ/Ë,~A I. Ka bërë shkollën e shejtanit keq. ka mësuar të gjitha djallëzitë e ligësitë. E shtie (e fut) shejtanin (djallin) në shishe shaka. shih te SHISH/E, ~JA. I ka hyrë shejtani (djalli, dreqi, macja, maçoku) në bark shih te BARK,~U. E ka shejtanin (djallin, dreqin, macen, maçokun) në bark shih te BARK,~U. Ikën (largo het, ruhet) si shejtani (si djalli) nga temjani shih tek TEMJAN,~I. Ia ka shitur shpirtin shejtanit keq.

**SHEMB** kal. 8. fig. keq. E qortoj dikë shumë ashpër, e dërrmoj fare; nuk e lë të marrë frymë.

**SHEMËR** f. \* E do si djalin e shemrës iron. nuk e do fare, s'e sheh dot me sy, e urren.

**SHENJTË** mb. 2. zakon. iron. Që merret si shembulli më i lartë i dëlirësisë e i pastërtisë morale, i virtutit e i ndershmërisë; që është i pamëkatë. Nuk është aq i shenjtë sa tregohet. \* Me frymën e shenjtë iron. si me magji, si me anë të një fuqie të mbinatyrshme. Lidhje e shenjtë libr., keq. lidhje e qeverive a e forcave reaksionare e kundërrevolucionare të disa vendeve, që ka për qëllim të shtypë luftën çlirimtare e lëvizjet revolucionare të masave popullore dhe të klasës punëtore (ashtu siç veproi Lidhja e Shenjtë e monarkëve të Rusisë, të Austrisë e të Prusisë për të shtypur lëvizjet revolucionare e çlirimtare në Evropë në fillim të shek. XIX).

**SHENJTËRISHT** ndajf. Në mënyrë të shenjtë, si një shenjt; me adhurim. Jetonte shenjtërisht. E ruan diçka shenjtërisht. Hante (pinte) shenjtërisht. iron. hante (pinte) mirë.

**SHEQERKË** f. \* E ëmbëlsoi me sheqerka dikë e mori me të mirë dikë, me qëllim që ta gënjente, që të nxirrte përfitime prej tij. I dha një sheqerkë keq. i dha një bakshish a një dhuratë të vogël për ta marrë me të mirë, për ta bërë për vete. Sheqerkë me

helm diçka që duket e mirë e joshëse nga jashtë, por që fsheh një rrezik të madh.

**SHES** kal. 2. edhe fig. keq. Tradhtoj dikë a diçka; ia lë dikujt në dorë për para ose për përfitime të tjera; shkel vlerat më të larta morale për përfitime vetjake. Shitën atdheun (vendin, lirinë, pavarësinë, interesat kombëtare). Shiti nderin. S'e shet veten tek të huajt. 3. fig. keq. Përpiqem ta paraqit dikë a diçka ndryshe nga ç'është në të vërtetë, për t'ia hedhur dikujt, për të mashtruar dikë. E shet një teori si origjinale (si materialiste, si shkencore). E shet veten si të ditur (të zotin, trim). E shet veten si mik. Shiti gjekë (shitja tjetërkujt) këto! gjej njerëz të tjerë që të të besojnë për këto që thua, se ne nuk na gënjen dot! 4. keq. Ua them të tjerëve, ua jap të tjerëve gjoja si të mirë për t'ua hedhur a për t'u dukur. Shet të trasha thotë fjalë të mëdha për t'u dukur, mburret. Shet pallavra (dokrra, dëngla, përralla) hiqet trim a i zoti para të tjerëve. \* Ia ka shitur shpirtin shejtanit keq. shih te SHEJTAN, ~I.

**SHËMTAK** mb. keq. I shëmtuar.

**SHËMTARAK** mb. keq. I shëmtuar.

**SHËMTUAR** ndajf. Në mënyrë të pahijshme, në mënyrë të shëmtuar, keq. Buzëqesh (ngërdheshet) shëmtuar.

**SHËNDET** m. \* Na la shëndetin (pendët) dikush mospërf. shih te LË. I lë shëndetin dikujt shih te LË. Mbaje me shëndet! iron. e deshe, vetë e ke fajin, prandaj rri urtë!, të qoftë! (për dikë që ka pësuar diçka jo të mirë nga pakujdesia ose për ndonjë arsye tjetër).

**SHËTIT** jokal. \* E shëtiti (e mat) me pëlëmbë shih te PËLLËMB/Ë, ~A. Shëtiti sytë (vështrimin) hedh vështrimin andej-këtej, kullot sytë. Shëtiti (bredh, shkon) lule më lule dikush keq. shih te LUL/E,~JA.

**SHFRENIM** m. 2. keq. Dhënia pas punëve të mbrapshta, shturje morale, liri e

tepruar për punë të këqija, mospërm-bajtje, harbim. Shfrenim i papërm-bajtur. Shfrenim ndjenjash (epshesh). Shfrenimet e fashistëve.

**SHFRENOHEM** vetv. 2. keq. Jepem a lëshohem pas punëve të mbrapshta, shtihurem, prishem fare moralisht. Ishte shfrenuar fare.

**SHFRENOJ** kal. 3. fig. keq. E bëj të jepet gjithnjë më shumë pas veseve e pas punëve të mbrapshta, e shtur.

**SHIJ** kal. 4. jokal. fig. keq. Bëj si të dua në një vend a në një mjedis, pa pyetur për asgjë dhe pa përfillur askënd, bëj si dua vetë. Shin si do vetë (sipas qejfit). Është mësuar të shijë. Shin si kali në lëmë.

**SHIKOJ** kal. \* Ta shikosh me dylbi! iron. s'ke për t'ia arritur që ta kesh a ta gëzosh, s'ke për ta parë kurrë.

**SHISHE** f. \* E shtie (e fut) shejtanin (dreqin, djallin) në shishe shak. është shumë i zoti, i shkathët e dinak, bën edhe atë që duket e pamundur. Ilaç i vjetër në shishe të re keq. shih tek ILAÇ, ~I.

**SHKALAVESH** kal. krahin. 3. E rrah fort dikë, e shqep në dru; e marr nëpër këmbë a e trajtoj keq.

**SHKEL** kal. \* Shkel e shko me nxitim pa kujdes; dosido, keq.

**SHKENCËTAR** m. \* Shkencëtar kabineti keq. shih te KABINET, ~I.

**SHKËRMOJ** kal. 2. fig. keq. Marr gjithçka të vlefshme që ka në një arkë a dollap, në një shtëpi etj., duke rrëmuar çdo skutë. Na e shkërmoi shtëpinë. I shkërmoi dollapët (sëndukët).

**SHKOJ** jokal. \* Në djall të shkojë (të vejë)! mallk. shih te DJALL, ~I. I shkoi (i ra) lodra euf. shih te LOD/ËR, ~RA. Shkoi për (për të bërë) vorba (vegsha) iron. shih te VORB/Ë, ~A. Shkon (bredh, shëtit) lule më lule dikush keq. shih te LUL/E, ~JA. I shkon (i ka hije) si shala gomarit iron. shih te SHAL/Ë, ~A. Një herë shkoi lepuri mbi urë edhe iron.

shih tek UR/Ë, ~A I. Shkoi shyta të kërkojë brirët, la edhe veshët fj. u. iron. shih te SHYT/Ë, ~A.

**SHKOLLARIST** mb. keq. Që është karakteristik për mënyrën si vepron në shkollë e si veprojnë nxënësit, që është i thjeshtuar, i ngushtuar e jokrijues; që nuk është i lidhur në mënyrë të gjallë me jetën. Trajtim shkollarist. Në mënyrë shkollariste.

**SHKOLLARIZËM** m. keq. Trajtimi i çështjeve ashtu si vepron në shkollë a si veprojnë nxënësit e shkollës tetëvjeçare; mënyrë e thjeshtuar, e ngushtë dhe jokrijuese për trajtimin a për studimin e çështjeve. Shfaqje të shkollarizmit. Bie në shkollarizëm.

**SHKOLLË** f. \* Në bankat e shkollës në kohën kur dikush vijon mësimet në shkollë. Ka bërë shkollën e shejtanit keq. shih te SHEJTAN, ~I. U ulën në bankat e shkollës shih tek ULEM. Shkollë e lirë ushtarake usht. shih te LIRË (i,e).

**SHKOP** m. 8. fig. keq. Njeri i trashë nga mendja, hu. Është shkop ai. \* Ka gjetur shkopi doçen keq. ka gjetur tenxherja kapakun. E ha barin pa shkop keq. vepron lirisht, nuk e pengon asgjë, livadhis.

**SHKREH** kal. 5. fig. Lodh, këput, rraskapit; dobësoj; tret; e gajas. E shkrehu sëmundja. Na shkrehu së qeshuri. Ç'na shkrehu! iron.

**SHKRESAXHI** m. keq. Nëpunës që përpiqet t'i zgjidhë çështjet vetëm me anë të shkresave, nëpunës që e kalon kohën duke hartuar shkresa dhe që mbivlerëson shkresat. Është kthyer në shkresaxhi.

**SHKRESOMANI** f. keq. Mani për të bërë sa më shumë shkresa dhe për t'i zgjidhur punët vetëm me shkresa.

**SHKRETË** mb. 6. iron. I thuhet me qesëndi një njeriu që kërkon një përfitim a një privilegj të padrejtë. I shkreti ti! E shkreta ajo!

- SHKRUAJ** kal. \* Shih e shkruaj! punët duken qartë, s'ka nevojë për shpjegime, është siç e sheh. Ku ta shkruajmë këtë? iron. thuhet kur dikush, që njihet si i paaftë, si përtac etj., në një rast të rrallë e kryen mirë një punë dhe i habit të tjerët. E shkruaj në akull shih tek **AKULL**,~I. Shkruaj me shkronja të arta shih tek **ARTË** (i,e). Shkroi një faqe të lavdishme (të ndritur) bëri një heroizëm, që do të mbetet i paharruar në histori. S'e shkruan (s'e vë, s'e fut, s'e shtie, s'e ka) në defter dikë a diçka edhe poh. shih te **DEFTER**,~I. Vetë shkruan, vetë vulos bën si do vetë, nuk pyet për njeri.
- SHKULEM** vetv. 5. euf. Dal jashtë, kryej nevojën; më shkon bark.
- SHOH** kal. \* E pafsha të ftohtë! mallk. shih te **FTOHTË** (i,e). Ulu (poshtë) se të panë! iron. shih tek **ULEM**. E pafsha në rrugë të madhe! mallk. shih te **RRUG/Ë**,~A. Sheh tym e bën konak iron. shih tek **TYM**,~I. E pafsha në (nëpër) dyert e botës (dyerve të botës)! mallk. shih te **DER/Ë**,~A.
- SHORR** kal. krahin. E shtrëngoju dikë, e zë ngushtë, ia mbledh rripat. Ia shorri keq.
- SHOSHË** I f. b) keq. armiku a e keqja duhen goditur me mjete të forta, derri do plumb. Nuk mbulohet (nuk zihet, nuk fshihet) dielli me shoshë fj. u. shih te **DIELL**,~I. E vunë në sitë e në shoshë dikë shih te **SIT/Ë**,~A. Shosha shosh, sita sit fj. u. secili ka aftësitë e veta e bën punën që ka mundësi të bëjë.
- SHPATË** f. \* Me shpatë në brez keq. shih te **BREZ**,~I.
- SHPATULL** f. \* I fërkon shpatullat (krahët, kurrizin, shpinën, zverkun) dikujt keq. shih te **FËRKOJ**. b) keq. është vjedhës i fortë, të qëron të bardhën e syrit. Marr mbi shpatulla (mbi supe, mbi vete) diçka marr përgjegjësinë, marr zotimin të bëj një punë të rëndë.
- SHPEJT** ndajf. b) keq. shkel e shko, pa kujdes.
- SHPEND** m. zool. 3. euf. Ujk; kafshë grabitqare. Ia hëngri shpendi dhinë. Ruanin natën mos vinte shpendi.
- SHPËLAJ** kal. 4. edhe iron. E ha të gjithë gjellën që ndodhet në një enë, s'le asnjë pikë a asnjë grimë në një enë, e fshij, e pastroj. E shpëlau pjatën (tasin, tenxheren). I shpëlau hambarët (kazanët) e hëngri (e piu) gjithçka që kishte, s'i mbeti më gjë. Ai të shpëlan ha shumë, s'le gjë pa ngrënë. \* Sa për të shpëlarë (për të larë) gojën iron. shih te **GOJ/Ë**,~A. I shpëlau duart nga kazma (nga lopata, nga çekani, nga bishti i lopatës) iron. nuk punon më me kazmë (me lopatë, me çekan), ka hequr dorë nga puna e krahut. E shpëlaftë mortja (kolera)! mallk. e marrtë mortja, vdektë!
- SHPËLARA** f. vet. 2. euf. Zakonet e grave, ato të muajit. I erdhën të shpëlarat.
- SHPËLARË** mb. 5. bised., keq. I paturp, i pacipë, që as skuqet, as zverdhët. Është fare i shpëlarë.
- SHPINË** f. \* I fërkon shpinën (krahët, kurrizin, shpatullat, zverkun) dikujt keq. shih te **FËRKOJ**. \* Qëndron (vepron) prapa shpinës së dikujt keq. fshihet pas një tjetri dhe nuk del haptas, shtyn dikë tjetër të veprojë për të arritur një qëllim. Thikë pas shpine keq. diçka që bëhet pabesisht për të dëmtuar rëndë a për të zhdukur një tjetër. Ia zbuti shpinën (brinjët, kurrizin) keq. shih te **ZBUT**. Ia bëri shpinën (kurrizin) më të butë se barkun keq. shih te **KURRIZ**,~I. Është si tapa në shpinë të detit keq. shih tek **TAP/Ë**,~A.
- SHPIRT** m. Për shpirt të babait iron. falas, pa të holla, pa pasur ndonjë përfitim. Me shpirt ndër dhëmbë shih te **DHËMB**,~I. Me shpirt (me zemër) të plagosur shih te **PLAGOSUR** (i,e). Shpirti i repartit keq. shih te **REPART**,~I. Ia ka shitur shpirtin shejtanit keq. shih te **SHEJTAN**,~I.
- SHPIRTKATRAN** mb. keq. Shpirtzi, zemërkatran.

- SHPIRTKAZMË** mb. keq. Shpirtzi, shpirtlig; zemërgur; gjakpirës.
- SHPIRTKRIMBUR** mb. keq. Që e ka shpirtin të ngushtë, shpirtvogël; që mendon keq për të tjerët, që u do të keqen të tjerëve, shpirtlig, zemërlig.
- SHPIRTPAKTË** mb. keq. Që është i dobët nga shpirti që nuk ka forcë shpirtërore për të përballuar vështirësi e rreziqe; frikacak; shpirtvogël.
- SHPIRTQEN** mb. keq. Që nuk ka mëshirë, që nuk ndien dhembje për fatkeqësitë e të tjerëve, shpirtkazmë, zemërquen.
- SHPIRTVOGËL** mb. keq. 1. Që e ka shpirtin të ngushtë, që edhe në gjërat më të vogla shikon vetëm përfitimin e vet, që shikon me smirë çdo gjë që kanë të tjerët, zemërvogël; kund. shpirtmadh. Borgjezë shpirtvegjël. U tregua shpirtvogël.
- SHPOHEM** vetv. \* Iu shpua kazani dikujt shih te KAZAN, ~I. I është shpuar xhepi (kuleta) iron. i janë mbaruar paratë, s'i ka mbetur asnjë lek.
- SHPORTË** f. \* Shportë karavidhesh keq. shih te KARAVIDH/E, ~JA 2.
- SHPUAR** mb. \* Daulle e shpuar keq. njeri llafazan e i padurueshëm, që flet shumë e s'bën asgjë. Legen i shpuar mospërf. llafazan i madh; ai që s'mban dot asnjë të fshehtë. Teneqe e shpuar mospërf.
- SHPUZAK** mb. 2. fig. keq. Fsheharak, tinëzak, që është si thëngjill i mbuluar.
- SHTAMBË** f. GRYK/Ë, ~A. Shan shtamba të zotin iron. tregohet më i ditur a më i mirë se ai që e ka rritur dhe e ka mësuar.
- SHTAZËRI** f. 2. edhe ~, ~TË fig. keq. Të qenët i egër e shtazarak; sjellje e egër, mizore dhe e pamëshirshme, sjellje prej shtaze. Shtazëria e pushtuesve. Shtazëritë e fashistëve
- SHTËPI** f. \* Ora e shtëpisë euf. shih te OR/Ë, ~A II. I zëntë shtëpia (oborri) bar! mallk. shih te BAR, ~I I.
- SHTRAT** m. 13. fig. keq. Tërësia e kushteve dhe e rrethanave që shkaktojnë lindjen dhe zhvillimin e shfaqjeve e të dukurive të dëmshme për moralin e shoqërisë sonë, mjedis jo i shëndoshë. Shtrati i grindjeve (i thashethemeve). Gjente shtrat dembelizmi. I bënte shtrat tarafilëkut. \* I është bërë shtrat dikujt a diçkaje keq. i është bërë mbështetje, e përkrah dhe e mbron; i ka krijuar kushte të përshtatshme për të vepruar a për t' u zhvilluar.
- SHTREMBËRUES** m. Ai që e shtrembëron diçka me qëllim të keq. Shtrembëruesit e së vërtetës. Shtrembëruesit e një teorie (e një doktrine).
- SHTRIG** m. 2. keq. Plak i keq, pa fëmijë e pa njeri, që nuk do askënd; plak i shëmtuar dhe me vese e huqe të këqija; njeri shumë dorështrënguar, zemërngushtë e shpirtzi. Shtrig i keq. Mbeti shtrig. Shpëtoi nga ai shtrig. 3. përd. mb. keq. Shumë dorështrënguar; zemërngushtë, shpirtkazmë.
- SHTRIGË** f. 2. keq. Plakë e keqe, pa fëmijë e pa njeri, që nuk do askënd; plakë e shëmtuar dhe me vese e huqe të këqija; grua shumë dorështrënguar, zemërngushtë e shpirtzezë. 4. përd. mb. keq. Shumë dorështrënguar; zemërngushtë e shpirtkazmë.
- SHTRIJ** kal. \* I ka shtrirë kthetrat keq. kërkon të grabitë të sundojë.
- SHTRYDHËTAR** mb. keq. 1. Që përpiket të nxjerrë sa më shumë përfitime nga të tjerët për veten e vet, që përpiket vetëm të marrë nga të tjerët e të mos japë asgjë, që shikon vetëm interesin e vet; zhvatës.
- SHTYJ** kal. 6. E lë për më vonë një punë; e zgjat afatin e përfundimit të diçkaje. E shtynë nisjen (mbledhjen, dasmën, lejen, afatin). I shtynë zgjedhjet (votimet). E shtyu pagesën (dërgimin, dorëzimin) e diçkaje. E shtyj një ditë (një javë, një muaj). Mos e shtyj më këtë punë! E shtyn nga dita në ditë. E shtynë për të shtunën. E shtynë për ditën e moskurrit. iron. e shtynë pa afat të caktuar.

- SHTHUR** kal. \* E ka shtthurur gojën keq. flet ç't'i vijë, s'i vë fre gojës; përdor gjithfarë fjalësh të ndyra, flet larë e pa larë, është gojëndyrë. Thur e shtthur shih te THUR.
- SHTHURUR** mb. \* E ka gojën të shtthurur (të prishur, të rëndë) keq. është gojështhurur, është gojëndyrë.
- SHUAR** mb. 9. euf. I vdekur. Më mirë i shuar se i turpëruar. fj. u. Më mirë i shuar se gjallë e i harruar. fj. u.
- SHUFALAK** mb. keq. Që vishet pa kujdes e nuk i mban mirë rrobat, shkatarrat.
- SHUL** ndajf. 1. Kryq a tërthor me dikë ose me diçka tjetër; për së gjeri a për së gjati mbi një tjetër ose mbi diçka; pjerrtas, shtrembër; keq. Brezat vihen shul. I vuri drutë shul. Ra shul përdhe. E gjetën shul në shtrat. I ka degët shul. Ishte rrëzuar shul mbi rrugë (një pemë). E kishte zënë rrugën shul. I rrinte shul kalit (gomarit). E ka lënë tryezën shul. Mos rri shul! I mban këmbët shul. \* Shul e tërthor kryq e tërthor. Mbeti shul mbeti pa gjë, mbeti në diell. Ma zuri shul diçka ma përfoli e ma nxori nga hundët. Ia zuri shul dikujt keq.
- SHULOJ** kal. 4. bised. Rrah me dru. E shuloi keq.
- SHUPRAG** m. 2. keq. Njeri që s'kujdeset fare për familjen e për shtëpinë; njeri i pazoti në punë, i humbur.
- SHURDH** m. Ai që nuk dëgjon fare nga veshët. Shkollë për shurdhët e për memecët. Është shurdh, s'dëgjon fare. Shurdh je? iron.
- SHURDHOJ** kal. 2. fig. keq. E lodh dikë me zhurmë a me të folur, i çaj veshët. Më shurdhoi gjithë ditën. Më shurdhoi telefoni. Na shurdhuan veshët me ankime të kota.
- SHUSHULL** f. kryes. 3. fig. keq. Fundërrina të shoqërisë, pleh. Ata jam shushulla.
- SHUSHUNJË** f. Të ngjitet si shushunjë. keq. (për një njeri që të qepet e s'të ndahet). 2. fig. keq. Njeri që të ngjitet e s'të ndahet për një punë të tijën. Është shushunjë e keqe. 3. fig. keq. Shfrytëzues i egër e i pashpirt, gjakpirës. Shushunja gjakpirëse. Çliruan popullin nga shushunjat.
- SHYT** mb. \* Shkoi shyta të kërkojë brirët, la edhe veshët fj. u. iron. shkoi për të fituar diçka, po humbi edhe atë që kishte pasur; vajti për t'i kërkuar llogari dikujt, po i kërkuar llogari atij vetë dhe e vunë përpara.
- TAGRAMBLEDHËS** m. hist. Nëpunës që mbledhte taksat ose tatimet, mbledhësi i tagrave. E përzunë tagrambledhësin. Ç'më vjen si tagrambledhës? keq.
- TAKOHEM** vetv. \* Më takohen sytë me dikë shkëmbej vështrimin me një tjetër, shihem sy ndër sy me dikë. Kur të takohet (të bashkohet, të puqet) qielli e toka (qielli me tokën) iron. shih te QIELL, ~I.
- TAMTAM** m. 3. fig. keq. Bujë e madhe, zhurmë e madhe që bëhet për diçka. E bënë me tamtame të mëdha. U mblodhën me tamtame.
- TAPË** f. \* Është tapë (tapë topi) thjeshtligj., tall, i trashë nga mendja, që nuk kupton asgjë, që nuk merr vesh fare; që nuk ka fare njohuri për një fushë a për një çështje të caktuar. I vuri tapën (shtupën) gojës shih te SHTUP/Ë, ~A. Është si tapa në shpinë të detit keq. s'është i zoti të zërë një vend e të qëndrojë, s'qëndron dot në një vend.
- TARAF** m. bised. Ana e njerëzve të një fisi, të një lagjeje etj., grup miqsh e shokësh të afërt; grup njerëzish me mendime, me qëllime dhe me interesa të përbashkëta, parti; keq. grup njerëzish që janë lidhur ndërmjet tyre me miqësi të sëmure e që i mbajnë anën njëri-tjetrit për çdo gjë. Tarafi ynë. Tarafi i nuses (i dhëndrit). Fryma e tarafit. keq. Shpirti i tarafit. keq. Njerëz të një tarafi. Njeri me taraf njeri që ka shumë shokë e miq, që e ndihmojnë e i mbajnë anën. Lufta kundër tarafeve. Është taraf i dikujt. Është nga tarafi tjetër. Ka taraf të madh

- ka shumë shokë, miq e të afërm; ka shumë përkrahës. U ndanë (u përçanë) në tarafe. U bë me tarafin e dikujt. s' pajtohet me tarafet. S'jemi për tarafet. Prej ç' tarafi je? Lidheshin taraf pas tarafi.
- TARTAKUT** m. 2. shar. Njeri i ulët, njeri i keq. Ik, more tartakut!
- TARTAROSEM** vetv. bised. 3. fig. S'më vjen mirë; prishem, tharohem në fytyrë. Pse tartarosesh? U tartaros keq.
- TELENDISEM** vetv. bised. U telendis keq.
- TELENDISUR** mb. bised. I turpëruar, i poshtëruar në sy të botës; që është marrë nëpër gojë për keq.
- TELLALL** m. 2. keq. Dikush që përhap lajme e që propagandon një gjë me zhurmë e me bujë në interes të një tjetri. Tellallët e shtypit borgjez. Tellallët e revizionizmit.
- TEMENA** f. bised. 2. keq. Përlulje ndaj një tjetri, nënshtrim. s' i bëj temena s' i përullem, nuk i nënshtrohem. E do (e kërkon) me temena. I rrinte (i sillej) me temena.
- TENXHERE** f. \* Ka gjetur tenxherja kapakun (u rrokullis tenxherja e gjeti kapakun) keq. kanë gjetur njëri-tjetrin (dy njerëz që janë njëlloj nga karakteri, nga zakonet etj.).
- TENJË** f. zool. \* I ka hyrë tenja po e bren sëmundja nga brenda, i ka hyrë sëmundja. Ka tenjën (shiritin, sprinjën) në bark dikush iron. ha e nuk ngopet; nuk shëndoshet fare, megjithëse ha shumë. Tenja e gjësë së gjallë kërrnjotë.
- TEORI** f. 5. kryes. keq. Fjalë e gjykime të kota, që nuk ndihmojnë punën, fjalë boshe e mendime që nuk sjellin dobi. Lëri teoritë! Mjaft me teori! Këto janë teori (profka).
- TEORIZOJ** kal. 2. keq. Flas me fjalë të mëdha për diçka, bëj teori kot më kot, jap mendime abstrakte e të përgjithshme që nuk ndihmojnë punën, vlerësoj në mënyrë të njëanshme anën teorike të diçkaje, duke shpërfillur anën praktike të saj.
- TEORIZUES** m. 2. keq. Ai që flet me fjalë të mëdha për diçka, ai që bën teori kot më kot, ai që jep mendime abstrakte e të përgjithshme, të cilat nuk ndihmojnë punën; ai që vlerëson vetëm anën teorike të diçkaje, duke shpërfillur anën praktike të saj.
- TEREZI** f. bised. I jepte rëndësi tapisë dhe jo terezisë. keq. Doli çuni nga terezia. b) s'ka ndërmend të bëjë diçka. Nuk prish terezinë (gjakun) shih te PRISH. S'e mat fjalën në terezi nuk e peshon fjalën mirë, flet pa menduar mirë. Është në terezi tjetër euf. i ka rënë sëmundja e tokës.
- TERS** mb. bised. \* Ters i Pojanit thjeshtligj. njeri që gjithnjë e për çdo gjë shfaq mosbesim, njeri që gjithnjë ndjell keq.
- TEVEQEL** mb. bised. keq. 1. Që është pak i metë nga mendja; që i merr gjërat me mendjelehtësi; jo i zgjuar, i trashë, që nuk i kap gjërat shpejt, që nuk ia pret, budalla.
- TËRHEQ** kal. \* I tërheq (i heq) kërraba nga vetja keq. shih te KËRRAB/Ë, ~A. Shati tërheq nga vetja fj. u., keq. shih te SHAT, ~I.
- TIGAN** m. \* Djalë (vajzë) tigan mospërf. djalë i përkëdhelur dhe i rritur me të gjitha të mirat. Fundi i tiganit (i kusisë) tall. shumë i zi (për një njeri). Peshku në det tigan në zjarr fj. u., iron. shih te PESHK, ~U. Urtë e butë e plot tigan fj.u. iron. shih tek URTË.
- TIGËR** m. 2. fig. keq. Njeri i egër e mizor.
- TIJ** pron. \* Erdhi dita e tij shih te DIT/Ë, ~A. Bufi mburr zogjtë e tij iron. shih te BUF, ~I.
- TINËZAK** mb. keq. 1. Tinëzar. Grua tinëzare. Punë tinëzare.
- TINËZI** f. keq. Fshehtësia me të cilën bëhet një punë a një veprim, pa e parë, pa e dëgjuar a pa e ditur njeri me qëllim të keq; të qenët tinëzar, sjellje e qëndrim



- prej tinëzari. Flet (vepron) me tinëzi. I bën punët me tinëzi.
- TINËZOHEM** vetv. 2. keq. Mbaj diçka të fshehtë, e fsheh diçka me qëllim të keq, sillem a veproj si tinëzar. Mos m'u tinëzo!
- TOGË** II f. hist. 2. fig. libr., keq. Mbulesë për të fshehur përmbajtjen e diçkaje ose qëllimin e vërtetë, petk, veshje. Ka veshur togën e marksistit.
- TOKË** I f. vet. nj. \* Rri në tokë! iron. jo more! (kur dikush thotë diçka shumë të çuditshme e të pabesueshme). \* Ajo e tokës (sëmundja e tokës) mjek., euf. epilepsia. Kadaifi i tokës bot. shih te KADAIF, ~I. Lëngata e tokës (e hënës) mjek., euf. shih te LËNGAT/Ë, ~A.
- TOP** m. b) e shkatërroi përfundimisht. Është tapë topi (tapë) thjeshtligj., tall. shih tek TAP/Ë, ~A. Mish për top keq. ushtarë që dërgohen me forcë nga qeveritë e vendeve borgjeze për t'u vrarë në luftëra pushtuese e grabitqare.
- TOROLINGË** f. 2. përd. mb. fig. keq. I lehtë nga mendja; që e ka kokën bosh, fyçkë. Është torolingë fare!
- TOROMAN** mb. bised. keq. 1. Torollak; bu-dalla. Djalë toroman. Vajzë toromane.
- TRASHALUQ** mb. keq. 1. Që e ka trupin të trashë e zakonisht të shkurtër, që është shumë i mbushur në shtat; që është i trashë, i ngjallur. Burrë trashaluq. Grua trashaluqe.
- TRASHAMAN** mb. keq. 1. Trashaluq. 2. fig. Që i kap gjërat me vështirësi, që nuk është i zgjuar, jo i mprehtë, i trashë nga mendja. Njeri trashaman.
- TRASHANIK** mb. keq. Që është karakteristik për një njeri të trashë e të pagdhendur, që i mungon kultura dhe fisnikëria; që nuk përputhet me sjelljen e mirë e të kulturuar, i ulët; që s'e pranon arsyeja, që nuk duhet bërë a nuk duhet thënë; që duket sheshit, që bie në sy menjëherë, i trashë, i rëndë (për një gabim, një titull etj.). Sjellje trashanike. Fjalë (shprehje, shaka) trashanike. Të qeshur trashanik. Gënjeshtër (shpifje) trashanike. Gabim trashanik.
- TRASHEM** vetv. b) nuk i bën më përshtypje asgjë. I ishte trashur qafa keq. b) kishte rënë në një vend të mirë e me të ardhura të mira, ishte pasuruar. Është trashur vargonjsh keq. i është rritur mendja, nuk përfill njeri. I janë trashur veshët nuk dëgjon mirë, është shurdhuar.
- TRASHË** mb. \* Ujët e trashë (e madh) euf. jashtëqitja e njeriut, nevoja e madhe.
- TRAZOVAÇ** mb. keq. 1. Që trazon çdo gjë, që nuk lë gjë pa prekur me dorë, që nuk lë dy gurë bashkë; që nuk të lë të qetë (sidomos për fëmijët). Djalë trazovaç. Vajzë trazovaçe.
- TRE** m. num. them. \* Tre hunj e një thupër keq. shih te HU, ~RI. I bëjnë sytë tre e tre dikujt i bëhen ca si miza përpara syve, nuk i dallon gjërat qartë, nuk sheh mirë.
- TREG** m. \* Plaçkë tregu keq. shih te PLAÇK/Ë, ~A. Nuk nxjerr (nuk qit) gjë në treg (në shesh) shih te SHESH, ~I.
- TREGOHEM** vetv. 1. E shfaq veten para të tjerëve me vetitë, aftësitë a të metat që kam, e zbuloj veten se kush jam. U tregua bujar. U tregua burrë. Tregohet i gatshëm (këmbëngulës, i palodhur). U tregua i paaftë. Tregohem i vëmendshëm. U tregua diplomat. iron.
- TREGOJ** kal. b) i zbuloi qëllimet e veta grabitqare, armiqësore etj., e tregoi natyrën e vet të egër, e zbuloi veten. E tregojnë me gisht dikë shih te GISHT, ~I. I tregoi grushtin dikujt shih te GRUSHT, ~I. I tregoi (i nxori), gjoksin dikujt shih te GJOKS, ~I. Nuk i tregon këmbët (i fsheh këmbët) shih te KËMB/Ë, ~A. Ia tregoi (ia rrëfeu) qejfin dikujt shih te QEJF, ~I. I tregoi (i rrëfeu) shkopin dikujt e kërcënoi. I tregoi (i rrëfeu) udhën (rrugën) dikujt mospërf. shih tek UDH/Ë, ~A. I tregoi vendin dikujt shih te VEND, ~I. I tregon (i rrëfen) babait

- arat iron. shih te BABA,~I. Tregoi fytyrën e vërtetë shih te FYTYR/Ë,~A. I tregon lëkurën e ujkut dikujt shih tek UJK,~U I. I tregoi se nga lind dielli iron. shih te LIND. Ia tregoi potkonjtë (këpucët) diellit (qiellit) përb. shih te DIELL,~I. Tregoi edhe qumështin e nënës shih te QUMËSHT,~I. I tregoi zorret e barkut shih te ZORR/Ë,~A.
- TRET** kal. 8. fig. keq. Pranoj, duroj, honeps. Nuk, m'i tret mideja këto lëvdata. Nuk i tret dot gënjeshtat e tij.
- TRI** f. num. them. \* Tre hunj e një thupër keq. shih te HU,~RI. Është tre mel e dy grurë mospërf. shih te MEL,~I.
- TRINË** f. \* U bë trinë keq. u deh keq, u bë tapë.
- TROJKË** f. 2. fig. libr. keq. Grup njerëzish prej tre vetash, që janë në krye të një vendi dhe drejtojnë pa përfillur mendimin e masave punonjëse e në kundërshtim me interesat e këtyre masave, treshe.
- TROKAS** jokal. \* Po troket në derën tënde iron. shih te DER/Ë, ~A.
- TROKË** f. b) keq. ishte dehur keq, ishte bërë tapë. Është trokë nga mendja keq. nuk i hyn gjë në kokë, nuk merr vesh, është i trashë, s'ka gjë në kokë, e ka kokën fare bosh.
- TRU** m. anat. I kanë rënë trutë në qafë mospërf. nuk është në gjendje të mendojë e të arsyetojë qartë; është shushatur. I. Ia hodhi trutë në erë keq. shih tek ER/Ë, ~A. I kërcyen trutë në kokë keq. shih te KOK/Ë, ~A. I ka lëpirë lopa trutë (mendtë) dikujt tall. shih te LËPIJ.
- TRUALL** m. \* Puna e truallit euf. shih te PUN/Ë, ~A.
- TRUDALË** mb. keq. 1. Që është pa mend në kokë, budalla; si mallk. që i dalshin trutë!
- TRUMBETOJ** kal. 2. fig. zakon. keq. Shpall në të katër anët diçka pak të njohur ose të panjohur, bëj që ta marrin vesh të gjithë, e nxjerr në shesh, ua bëj të njohur të gjithëve; përhap, me bujë në çdo anë. Trumbetoj të vërtetën. Trumbetoj fitoret. Trumbetoj në të katër anët. Ia trumbetoj gjithë botës. Trumbeton me të madhe.
- TRUNDRYSHKUR** mb. keq. 1. Që i kap gjërat me vështirësi, jo i zgjuar, i trashë. Njeri trundryshkur. 2. Që ka mendime të mykura, që është me të vjetrën. Borgjez (mikroborgjez) trundryshkur.
- TRUTHARË** mb. keq. 1. Që nuk është në gjendje të gjykojë si duhet, i ngathët nga mendja, jo i zgjatur; që i kanë rrjedhur trutë; matuf, kokëzbrazët; si mallk. që iu thafshin trutë e kokës! 2. Përd. em. sipas kuptimit të mbiemrit. Çfarë truthari paska qenë!
- TUL** m. 8. përd. mb. fig. keq. I qullët, i ngathët, që s'të kryen punë; që s'ia pret, i trashë; sylesh (për njerëzit). Tul me dy sy copë mishi me dy sy. Ishte tul fare.
- TULTË** mb. 6. fig. keq. Që s'është i zoti për asgjë, i plogët, i ngathët, qullac. Fëmijë i tultë.
- TUND** kal. \* I tund (i luan) bishtin dikujt keq. shih te BISHT, ~I. Tund (luan) derën mospërf. rri kot; merret me punë pa vlerë, sa për të kaluar kohën. s'i ka tundur djepin dikujt nuk ia di moshën, s'ka nga t'ia dijë se ç'moshë ka. I tundi (i shkuli) dhëmballët (dhëmbët) dikujt shih te SHKUL. Tundi këmbën mospërf. vdiq. Tund degën e ullirit iron. shih tek ULLI,~RI. Tund këmbët në diell mospërf. shih te DIELL,~I. Hyr e dil e tund peshqirin mospërf. shih te HYJ.
- TUPAN** m. vjet. b) diçka e tellallisën anembanë, e trumbetuar në të katër anët. E hedh vallen (kërcen) si të bjerë tupani keq. sillet e vepron sipas rastit e si t'i leverdisë, i hedh këmbët sipas daulles.
- TURBULLT** mb. \* Peshkon në ujë të turbullt (në ujëra të turbullta) keq. shih te PESHKOJ.

- TURI** m. \* Fut turinjte (hundët) në diçka keq. shih te FUT. Ka turinj (hundë) shih te HUND/Ë, ~A. Nuk ka turinj (hundë) për dikë a për diçka mospërf. shih te HUND/Ë, ~A. I theu (i dërrmoi) turinjte (hundët, brinjët, dhëmbët, nofullat) dikujt përçm. shih tek THYEJ.
- TURISPEC** mb. keq. shar. 1. Që e ka turirin e gjatë e të tërhequr si spec; që e ka ngjyrën e fytyrës të kuqërremtë e të ndezur. 2. fig. Inatçi, zemërak që merr inat menjëherë.
- TURIVARUR** mb. keq. 1. Që i ka lëshuar buzët nga pakënaqësia, nga zemërimi, nga mërzia etj. 2. përd. ndajf. Me buzët varur, duke qenë i pakënaqur a i zemëruar. Shfry turivarur. Rrinte turivarur. Më vështroi turivarur.
- TURIVRARË** mb. keq. Që është i ngrysur në fytyrë, që nuk i qesh buza kurrë; i zymtë e i mërzitur.
- TURJELË** f. 3. fig. keq. Njeri që kërkon të mësojë çdo gjë me hollësi ai që zhbiron e mundohet të zbulojë çdo të fshehtë, zhbirues, biramel. Është një turjelë ai!
- TURKOSHAK** mb. keq. 1. Turk. Pasha turkoshak. Krerët turkoshakë. Taborr turkoshak. Emër turkoshak. 2. Që vepron a qeveris me mënyra të prapambetura e të vrazhda; që u përmbahet zakoneve të vjetruara e prapanike; që ka mendime e sjellje të trasha; anadolak. Regjim turkoshak. Mendime (paragjykime) turkoshake. 3. përd. em sipas kuptimeve të mbiemrit. Luftonin me turkoshakët.
- TURP** m. I ka plasur turpi. keq. nuk turpërohet për asgjë, i ka plasur cipa.
- TUTKUN** mb. keq. shar. 1. I trashë nga mendja, që nuk ia pret, që ia hedhin lehtë të tjerët; që nuk është në gjendje t'i dalë zot vetes, i humbur. Njeri tutkun.
- TUTOR** m. 2. keq. Ai që kujdeset në mënyrë të tepruar për dikë dhe ia ndrydh lirinë e mendimit, të veprimt e të sjelljes. Iu bë tutor.
- TUTORI** f. 2. keq. Kujdes i tepruar për dikë që ia ndrydh lirinë e mendimit, të veprimt e të sjelljes. Mjaft me tutori!
- TYM** m. b) keq. nis të zbulohet një punë, një vepër e keqe, dalin në shesh të palarat. I doli tymi dikujt u shkatërrua krejt, dështoi, u dogj (kur dikush humbet fare pasurinë ose falimenton në tregti). Sheh tym e bën konak iron. shkon derë më derë dhe e shtron me muhabet, gjen derë e futet, e kalon kohën me llafe e jo me punë. Ku leh qen e ku del tym, ku ia bën daullja bum iron. shih te QEN,~I.
- THAJ** kal. 4. bised. edhe shak. a iron. Nuk i lë asnjë pikë, e shteroj deri në fund; e pi ose e ha, të gjithë, e zbraz krejt; i marr çdo gjë që ka, s'i lë asgjë. E njoh diçka shumë mirë, e di me rrënjë (edhe iron.). Ama ç'e paske tharë! iron. (kur dikush nuk e ka mësuar fare një mësim a e ka bërë keq një punë).
- THANË** f. Djemtë (fëmijët) hanë thana (kumbulla), pleqve u mpihen dhëmbët iron. shih te MPIHEM.
- THARË** mb. 8. bised., keq. Përd. em. f. sipas kuptimit 5 të mbiemrit. Luajti të tharat! Luajti duart (këmbët), që i ke si të thara!
- THARTIÇKË** f. kryes. bised. 2. fig. keq. Grua gjuhustër.
- THASHETHEMEXHI** m. bised. keq. Ai që merret me thashetheme, njeri i thashethemeve. Fjali thashethemexhiu thashethemexhinjtë fshihen si minjtë.
- THELË** f. \* Të jep një thel e të merr (të rrëmben) një pelë keq. të jep pak për të të marrë shumë; të jep kusinë e të merr shtëpinë. Lëre lëngun e hyr në thela! iron. shih. te LËNG,~U.
- THELLË** ndajf. \* Sa më thellë aq më të ruda iron. shih te RUDË,~A.
- THEM** kal. I thonë luftë. I thonë punë, s'i thonë shaka. Jetë i thënçin! iron. s'është jetë për të qenë kjo, është jetë e keqe. Burrë (grua) i thënçin! iron.

- THEMBËR** f. Vëri majat (gishtat) nga (ke) thembrat! iron. shko andej nga ke ardhur, mbathja, mbushu! Nga vë ballin, vë thembrat (thembrën) tall. shih te BALL/Ë,~I.
- THEPAK** mb. 2. keq. Kokëfortë, kokëshkëmb.
- THES** m. \* Derr në thes keq. pa ditur gjë, pa e parë ose pa e njohur fare dikë a diçka. Miell nga thesi i botës (i huaj) iron. shih të MIELL,~I.
- THËLLËZË** f. zool. b) iron. e pa mirë se ç' mund të bënte; e pa sa pisk e kishte. Kusia mbi prush, thëllëza fushë fj.u. shih te KUSI, ~A.
- THËNGJILL** m. \* Thëngjill i mbuluar (gacë e mbyllur) keq. shih te MBULUAR (i,e).
- THIKË** m. \* Thikë pas shpine keq. shih te SHPIN/Ë,~A.
- THOI** m. 3. vet. fig. keq. Zgjedhë shumë e rëndë, shtypje e padurueshme nga një njeri mizor, nga një grup njerëzish gjakatarë, nga një sistem shoqëror shfrytëzues nga ligje, zakone a pikëpamje prapanike e të rënda etj.; rrezik ose kërcënim i madh nga diçka; kthetra. Në thonjtë e imperializmit. Në thonjtë e bejlerëve (e çifligarëve, e tregtarëve, e xhandarëve). Në thonjtë e kanunit. Ra në thonjtë e dikujt a të diçkaje. c) mospërf. s'ka më fare fuqi, s'është më ai që ka qenë, s'ka më pushtet, forcë, pasuri etj.; ç) mospërf. vdiq, ngordhi. Më ra për thonjsh më ngrinë duart a këmbët, m'u thanë duart a këmbët nga të ftohtët. I dha thonjtë dikujt keq. e dëboi, i dha duart. Është me thonj dikush keq. b) është vjedhës, ka dorë. E ka në (për) thua e ka zakon, është mësuar të veprojë, të sillet etj. në atë mënyrë që e prisnim; është mësuar me diçka, është e zakonshme për të. S'ka thonj mospërf. s'ka fuqi të të bëjë keq. Që nga koka deri te thonjtë (te thembrat) shih te KOK/Ë,~A. Kruan thonjtë tall. shih te KRUAJ. Merr (zë) në thua. Me thonj me dhëmb keq. shih te DHËMB,~I. I ka thonjtë pa hequr keq. vjedh, vijon të vjedhë. E ka thuan të keq keq. vjedh, ka dorë. I ka thonjtë të prerë dikush a) mospërf. s'ka fuqi të të bëjë keq; s'ka forca të të dëmtojë; s'të bën dot asgjë; Të jep thonjtë e bufit për të të nxjerrë sytë keq. shih te SY,~RI.
- THONJGJATË** mb. 2. fig. keq. Që lakmon shumë, që e ka mendjen të rrëmbejë; që vjedh, hajdut:
- THUA** m. 3. vet. fig. keq. Zgjedhë shumë e rëndë, shtypje e padurueshme nga një njeri mizor, nga një grup njerëzish gjakatarë, nga një sistem shoqëror shfrytëzues nga ligje, zakone a pikëpamje prapanike e të rënda etj.; rrezik ose kërcënim i madh nga diçka; kthetra. Në thonjtë e imperializmit. Në thonjtë e bejlerëve (e çifligarëve, e tregtarëve, e xhandarëve). Në thonjtë e kanunit. Ra në thonjtë e dikujt a të diçkaje.
- THUNDËR** f. 3. fig. keq. Zgjedhë e rëndë, sundim i egër; shtypje. Thundra fashiste. Thundra e bejlerëve (e feudalëve, e kapitalit). Ra (është, vuan, lëngon) nën thundrën e pushtuesve. U çlirua (shpëtoi) nga thundra e egër.
- THUPËR** f. \* Ose hu ose thupër fj.u. shih te HU,~RI. Tre hunj e një thupër keq. shih te HU,~RI.
- THYEJ** kal. a) iron. lëre se na bëre të qeshim, nuk shikon, na shkule së qeshuri b) keq. na gënjeve rëndë!; na mbushe me gënjeshtër! Ia theu bririn shih te BRI,~RI. Thyej dorën fitoj pak nga pak, duke i ushtruar, aftësinë e shkathtësinë e nevojshme për të bërë një punë, nis t'ia marr dorën një pune. Theu dhëmbët humbi keq, pësoi humbje të rëndë, u dëmtua shumë. I theu (i dërrmoi) dhëmbët (hundët, brinjët, turinjët, nofullat, fulqinjët) dikujt përçm. Thyej (këput) arrëzën (qafën)! keq. largohu që këtej!, shporru! Theu (këputi) qafën (zverkun, arrëzën). b) keq. ta hedh lehtë, ta hedh kur të duash; c) keq. vjedh shumë e me marifet, të qëron të bardhët e syrit. Nga theva këmbën e dola (e vajta

e shkova e erdha )! ç'm'u desh që dola (që vajta, që shkova, që erdha!), ç'bëra që dola (që vajta, që shkova, që erdha). Të thyente kokën (kryet) me para ishte shumë i pasur, kishte shumë para. Bie miu e thyen kokën, është bosh, s'ka asgjë brenda (për hambarin etj.). Mendja e madhe të thyen qafën (zverkun) fj.u. shih te MENDJ/E,~A. Gjuha kocka s'ka e kocka thyen fj. u. shih te GJUH/Ë,~A I.

**UDHË** f. Udha (rruga) e mbarë (të qoftë)! iron. shih te MBARË. (i,e).

**UJDI** f. bised. Ujdi diplomatike. keq.

**UJË** m. 5. fig. keq. Diçka e tepërt, e panevojshme në një vepër, në një krijim etj. Teksti kishte shumë ujë. I hoqi ujin e tepërt. c) keq. U zbulua, doli sheshit. Dehet me ujë iron. shih te DEHEM. Është mbi ujë është në gjendje të pasigurt e të paqëndrueshme, nuk e di si do t'i vejë puna. Pi ujë te dikush keq. është vegël e dikujt, bën punën e dikujt. Nuk pi ujë diçka nuk ka vlerë; nuk shkon, ecën, nuk zë vend, nuk ndikon. E kemi pirë këtë ujë mospërf. shih te PI. Prashit (mih, lëron) në ujë merret me një punë, nga e cila nuk del asgjë, mundohet kot, rreh ujë në havan. Pupël përmbi ujë shih te PUP/ËL,~LA. I qiti në ujë (paratë) shih te QIT. I shkon ( i vete) pas ujërave sillet a vepron sipas dëshirave të dikujt, i shkon pas qejfit. Turbullon (ngatërron) ujërat (ujin) sjell ngatërresa, hap telashe, ngatërron punët. Ujë i tërbuar shak. shih tek TËRBUAR (i,e). AS në ujë, as për ujë keq e mos më keq, s'ka ku shkon më keq. m'u bë gjaku ujë (lëng). Të dhënça ujë me lugël mallk. shih te LUGË. Noton në të njëjtat (në po ato) ujëra me dikë keq. ndjek po atë rrugë si dikush tjetër, ka pak a shumë po ato mendime e pikëpamje, është njësoj si ai; është po në atë gjendje të padëshirueshme. Peshkon në ujë të turbullt (në ujëra të turbullta) keq. shih te PESHKOJ. Mbytet në një pikë (lugë, gotë, filxhan, gisht) ujë mospërf. e humbet toruan shumë shpejt, hutohet edhe

përpara një gjeje fare të vogël.

**UJË** as. 2. euf. Jashtëqitje e njeriut. Ujë e hollë (e vogël) lëng që përftohet në veshkat, mblidhet në një fshikëz të posaçme dhe del jashtë nga organizmi. Ujë e trashë (e madh) jashtëqitjet nga zorra e trashë. Bën (derdh) ujët. I mbahehet ujët nuk e bën dot ujët e hollë.

**UJK** I m. 2. fig. keq. Njeri shumë i egër e i pamëshirshëm; ai që kërkon të vrasë të tjerët e të gllabërojë gjithçka; lakmues i pangopshëm. Ujqit imperialistë.

**UL** kal. \* E uli hundën iron. shih te HUND/Ë,~A. S'e ul hundën keq. shih te HUND/Ë,~A. E uli (e shtroi) qafën (kurrizin) përb. shih te QAF/Ë, ~A. Ka ulur pak hundën, por ka ngritur sqepin iron. s'ka hequr dorë nga krenaria e kotë, vazhdon të mbahet më të madh përpara të tjerëve.

**ULEM** vetv. Ulu (zbrit) nga fiku! iron. shih te FIK,~U. Ulu (poshtë) se të panë! iron. i thuhet dikujt që mbahet më të madh, në kuptimin: mos u mburr shumë se të njohin sa vlen! U ul (zbriti) nga shala e hipi në samar; iron. shih të SHAL/Ë,~A.

**UNË** keq. tërësia e vetive të një njeriu, të cilat ai përpiket t'i vërë në dukje në çdo kohë e me çdo kusht, vetja; bota e ngushtë e dëshirave dhe e interesave vetjake të një njeriu, të cilën ai kërkon ta vërë mbi çdo gjë tjetër, mbi interesin e përgjithshëm. Uni poetik (lirik). Fryma e unit. Ngre krye (nxjerr kokë) uni. Shpreh unin e vet. Flet uni. Vë (nxjerr) përpara unin. E bren (e pengon) uni. S'e lë uni. E mposhti (e mundi) unin.

**UNGJILL** m. 2. fig. keq. Vepër a teori që mbahet si bazë ideologjike, si dogmë për një veprimtari politike, shoqërore, kulturore etj.

**URATË** f. b) iron. u prish fare, humbi diçka. E mori ferra uratën shih te FERR/Ë,~A. Hardhia e bën rrushin, ferra merr uratën fj.u. shih te HARDHI,~A.

**URDHËR** I m. \* Me urdhër të peshkut iron. shih te PESHK,~U.

- URDHËRDHËNËS** m. 2. keq. Njeri që drejton vetëm me anë të urdhrave. Kthehet në urdhërdhënës.
- URDHËRO** pasth. 3. iron. Përdor kur i drejtohem dikujt, për të shprehur pakënaqësinë për diçka që nuk mund të bëhet më ose që dihej se ashtu do të përfundonte. Urdhëro të lutem! Urdhëro gjej vend tani!
- UROV** m. bot. \* Ha urov vuan, heq keq. I shkojnë urov prej dikujt ia ka frikën dikujt, i shkojnë shtatë.
- URTË** ndajf. c) pa zhurmë e pa bujë, pa undier. Urtë e butë e plot tigani fj.u. iron. thuhet për dikë që përpiqet ta ketë mirë me të gjithë, të mos i prishë marrëdhëniet me asnjëri, që t'i shkojnë mbar punët e veta.
- URUAR** mb. bised. 4. euf. Që nuk është i mbarë e i pëlqyeshëm, që nuk e duam; që të mundon; që dëshirojmë të jetë i mirë, e i mbarë; i bekuar. Ky i uruar shi e prishi fare. Ajo raki e uruar e mori në qafë. 5. euf. përd. em. sipas kuptimit 4 të mbiemrit. E do shumë të uruarin. Ç'u bë i uruari? Më këputi, i uruari. Mos andej, moj të uruara!
- USHTRI** f. sh 1. Ushtria e kazermës. keq. shih te KAZERM/Ë, ~A.
- USHUNJËZ** f. zool. \* Iu ngjit si ushunjës dikujt keq. iu qep e nuk i ndahet, iu ngjit si rrodhe.
- UTHULL** f. \* Pi uthull! tall. i thuhet me shpoti dikujt që nxehet menjëherë. Pi macja uthull iron. i thuhet zakonisht një të vogli kur e shohim që pi duhan, raki a diçka që është për të rriturit. Nuk pi macja uthull iron. është diçka e pamundur, është gjë që s'bëhet. Laje gojën mirë me uthull! iron. shih te LAJ.
- VAGABOND** m. keq. 1. Ai që bredh rrugëve pa punë, sillet keq e bën veprime të dënueshme nga shoqëria; rrugaç; aventurier. Sjellje prej vagabondi.
- VALË** f. 5. bised. Enë prej metali (gjym, kusi etj.), që vihet në zjarr për të zier ujë. Vuri valën në zjarr. Lepuri në mal e vala në zjarr. fj. u. iron.
- VALLE** f. \* Hedh vallen siç bie daullja (sipas daulles, siç bie lodra) keq. shih te DAULL/E, ~JA.
- VAMPIR** m. 2. fig. keq. Ai që shfrytëzon pa mëshirë të tjerët; gjakpirës. Vampirët kapitalistë. 3. fig. keq. Hamës i madh, llupës, ai që s'ka të ngopur.
- VANDAL** m. hist. 2. fig. keq. Ai që prish e shkatërron në mënyrë barbare monumentet e artit e të kulturës dhe çdo gjë tjetër me vlerë; njeri i egër e barbar, shkatërrimtar i pamëshirshëm. Vandalët fashistë (nazistë). Vandalët e kohës sonë.
- VAR** kal. I vari ujkut mëlçitë në qafë iron. i besoi me mendjelehtësi një njeriu të pandershëm e të pabesë pikërisht atë gjë që ai e lakmonte më tepër, priti të mbrohet nga ai që dëshironte t'i bënte të keqen, besoi e shpresoi tek i ligu;
- VAREM** vetv. pës. \* I janë varur mustaqet iron. shih te MUSTAQE, ~T.
- VARFANJAK** mb. 3. keq. Që e ka zemrën të ngushtë, me shpirt të vogël. Mos u bëj varfanjak!
- VARFËRISHT** ndajf. libr. Në varfëri, me varfëri; keq. Jetonte varfërisht. I veshur varfërisht.
- VARGËTAR** m. 2. keq. Vargëzues.
- VARGËZOJ** kal. 3. fig. keq. E zvarrit një punë a një çështje, e zgjat tepër diçka, e heq zvarrë. 6. edhe jokal. keq. Bëj vjer-sha të dobëta nga ana ideoartistike, thur vargje pa vlerë.
- VARGOJ** kal. 5. fig. keq. E zvarrit diçka, e zgjat shumë, e bëj tërkuzë. E ke varguar shumë atë punë.
- VARGUA** m. \* Ishte trashur vargonjsh keq. shih tek TRASHËM.

- VASAL** m. sh 2. fig. keq. Njeri që varet plotësisht nga dikush tjetër, ai që i përulet e i nënshtrohet dikujt; shtet që varet plotësisht nga një shtet tjetër dhe i nënshtrohet këtij. Vasal i imperializmit.
- VDEKUR** m. \* Ngjall të vdekurin nga varri shih te NGJALL. Ai nxjerr të vdekurin nga varri shih te NXJERR. Lë të vdekurin e shkon në dasmë keq. lë një punë të rëndësishme a të ngutshme për t'u marrë me diçka jo të domosdoshme, nuk i vlerëson drejt punët.
- VDES** jokal. Vdes bleta. euf.
- VEGËL** f. 5. fig. keq. Njeri që vihet në shërbim të dikujt dhe bën punën e tij, njeri a grup njerëzish, që i shërben dikujt si mashë për të arritur qëllime të caktuara; ai që i shërben verbërisht dikujt, shërbëtor. Vegël e verbër (qorre). Vegël e ndyrë. Vegël politike. Vegël e imperializmit. Vegël e armikut (e reaksionit). Vegël agresioni. Është bërë vegël e të tjerëve. Shërbente si vegël. E përdorte si vegël.
- VEGSH** m. \* Shkoi për (për të bërë) vegsha (vorba) iron. shih te VORB/Ë,~A. Ka gjetur rrasa vegshin (vorbën) keq. shih te RRAS/Ë,~A.
- VEND** m. Vend i lig (i keq). euf. baqthi. Vendi i ujit. euf. Vendi i hollë. euf. Vend i rëndësishëm. Vend i ngrohtë (i rehatshëm). keq. punë e lehtë e me pagë të mirë. Vend pëllumbash. bised., iron. punë shumë e lehtë. Gjeti vendin mospërf. mori atë (zakonisht dënimin) që meritonte. Mbaj vendin! keq. shih te MBAJ. Mëshoji vendit! keq. shih te MËSHOJ. S'i zë bytha vend thjeshtligj., keq. nuk ngulet në punë.
- VERBALIZËM** m. keq. Përdorim i tepruar e pa nevojë i fjalëve për të kumtuar a për të shpjeguar diçka, duke errësuar përmbajtjen ose duke mos shprehur thelbin e çështjes. Ra në verbalizëm. Luftojnë verbalizmin.
- VERBËR** mb. 3. fig. Që nuk vepron a nuk sillet duke u mbështetur në arsyetimet e në mendimet e veta, por bën si i thonë të tjerët; që nuk mbështetet tek arsyeja e te gjykimi i shëndoshë. Zbatues i verbër. Bindje e verbër. Dashuri e verbër. Vegël e verbër. keq. njeri që vepron si shërbëtor i bindur i dikujt. Ka besim të verbër. Në mënyrë të verbër.
- VERBOJ** kal. \* Me lugë të kon, me bisht të verbon keq. shih te LUG/Ë,~A. Një sy verboje, një vesh shurdhoje! shih te SY,~RI.
- VERDHALAQ** mb. keq. 1. Verd hacak.
- VERESIE** ndajf. bised. 2. fig. keq. Kuturu, kot, pa u menduar, pa përgjegjësi; pa treguar vëmendjen e duhur. Fliste veresie. I lëshonte fjalët veresie fliste kot. Jeton (rron) veresie jeton pa një qëllim të caktuar. Punon veresie punon më tym, pa e ditur përse.
- VERË** I f. \* Na rrofsh për dimër, se për verë jemi vetë! thjeshtligj., iron. shih te DIM/ËR,~RI.
- VESH** m. \* Gomar me veshë. thjeshtligj., keq. njeri shumë i trashë nga mendja; budalla me brirë. Nxori (qiti) veshët keq. nisi të dalë, filloi të duket a të shfaqet, nxori krye; doli në shesh, u zbulua; e shfaqti veten ashtu siç ishte. Ia preu veshët dikujt shih te PRES 1. I hyn në një vesh e i del nga tjetri (nga një vesh i hyn e nga tjetri i del) mospërf. shih te HYJ.
- VESH** kal. 8. fig. keq. I mbuloj përmbajtjen me fjalë e me fraza, e zbukuroj dhe e stolis me shprehje të ndryshme. E veshi me fraza të bukura. E veshin me formula të zbrazëta (me frazeologji revolucionare).
- VESHGJATË** mb. 3. si em. euf. VESHGJAT/Ë, ~I. m. ~Ë,~ËT. Gomari.
- VESHSHPUAR** mb. 3. keq. Që nuk ua vë veshin fjalëve të të tjerëve, që nuk i kush-ton vëmendje asaj që i thuhet; që nuk i bëjnë përshtypje qortimet që dëgjon.
- VET** pron. vetv. \* Mbahet pas flokëve të vet iron. shih te FLOK,~U.

- VETE** përem. vetv. 4. si em. euf. Vendi ku janë herdhët, vendi i hollë, vendi i keq; herdhët. I dhemb vetja. I ra në vete. I ra vetja u rrënxua. U këput ndër vete u rrënxua. I bën qejfin vetes keq. shih te BËJ. E mbante qefinin me vete shih te QEFIN, ~I. I tërheq (i heq) kërraba nga vetja keq. shih te KËRRAB/Ë, ~A. Shati tërheq nga vetja fj.u. keq. shih te SHAT, ~I.
- VETE** jokal. \* Në djall të vejë (të shkojë)! mallk. thjeshtligj. shih te DJALL, ~I. Do t' i vejë ai fis keq. shih te FIS, ~I. Prapa diellit të vejë! mallk. shih te DIELL, ~I.
- VETËQETËSIM** m. keq. Veprimi dhe gjendja sipas kuptimit të foljes VETËQETËSOHEM. Vetëqetësimi është i dëmshëm. Nuk ka vend për vetëqetësim e për vetëkënaqësi.
- VETËQUHEM** vetv. keq. I vë vetes një emër a një titull, i cili nuk më takon ose nuk përputhet me të vërtetën; e quaj veten të tillë a të atillë. Vetëquhej socialist. Vetëquhej mbret (kryetar).
- VETVETE** përem. vetv. Është dashuruar me vetveten. keq.
- VEZË** f. \* U bë veza të mësojë pulën! iron. i thuhet dikujt kur përpiqet t' i japë këshilla një tjetri që ka shumë më tepër përvojë.
- VË** kal. I vuri bisht prapa. keq. I vë bal-luke keq. shih. te BALLUK/E, ~JA. S' e vë në brinjë mospërf. shih te BRINJ/Ë, ~A. simA. E ka vënë (e ka) në shenjë (në nishan) dikë shih te SHENJ/Ë, ~A. I vë shenjën dikujt shih te SHENJ/Ë, ~A. E ka vënë (e ka fu-tur) në shënjestër dikë e ka vënë në shenjë. I vuri shkelmin diçkaje shih te SHKELM, ~I. Ta vë babën burrë keq. shih te BAB/Ë, ~A. E vë barrën pas samarit tall. shih te BARR/Ë, ~A. I vinte (i ngjiste) brirë (brirët e kaut) dikujt keq. shih te BRI, ~RI.
- VËRRAS** jokal. 2. keq. Flas me zë të lartë e të gjerrë, çirrem; bërtas. Vërriste si i shkalluar. Vërriste nga inati. Mos vërrit!
- VICKË** f. kryes. 2. fig. keq. Kundërshtim i pathemeltë për diçka, përpjekja që bën dikush pa arsye për të kundërshtuar a për të mos pranuar diçka. Hidhte vicka. Është njeri i vickave është njeri që hedh shkëlma, që s' rri urtë.
- VIÇ** m. \* Kur të qethen viçat iron. kurrë, as-njëherë.
- VIHEM** vetv. \* U vu në blojë keq. shih te BLOJ/Ë, ~A.
- VIJ** jokal. I vjen hakut (i vjen për hak) dikujt keq. nuk e lë pa i dhënë atë që meriton. I ardh të (i rëntë) pas veshit (pas qafës)! mallk. shih te VESH, ~I. Nuk i vjen zëri iron. përdoret nga dikush kur ky bën sikur nuk dëgjon atë që thotë një tjetër ose bën sikur nuk kupton për se është fjala, sepse nuk dëshiron ta bëjë diçka.
- VISHEM** vetv. 7. fig. iron. Paraqitem me një pamje tjetër, duke fshehur a duke mbuluar qëllimet e vërteta ose veprimet e këqija; shtirem. Na vishen si marksistë. Vishëj si revolucionar.
- VITRINË** f. 3. fig. keq. Diçka e zbukuruar që nxirret përpara me qëllim që të krijojë një përshtypje të gabuar për gjërat, rrethanat, etj. që përfaqësohen prej saj.
- VJEDHACAK** mb. bised. keq. shar. 1. Që vjedh sende të vogla; vjedhës.
- VJELL** kal. 4. fig. keq. Flas shumë keq për dikë a për diçka, nxjerr gjithçka të keqe që mbaj përbrenda; them fjalë të këqija a shpif për dikë për të nxjerrë inatin, shfryj. Vjell vrer (helm, helm e vrer, zeh-her) kundër dikujt. E volli atë që kishte në bark. Vollën shumë gojët e këqija.
- VJETËR** mb. \* Hap defterët e vjetër edhe keq. shih te DEFTER, ~I. Ilaç i vjetër në shishe të re keq. shih tek ILAÇ, ~I.
- VOCKËL** mb. zvog. Jetë e vockël. fig. keq. jetë pa ideale të mëdha, jetë e mbyllur me interesa fare të ngushta vetjake.



- VOGËL** mb. 9. keq. Që lidhet vetëm me veten a me interesin e vet, i ngushtë; që nuk është zemërgjerë; që nuk është fisnik nga shpirti, shpirtvogël. Me qëllime (me interesa) të vogla. Me shpirt të vogël. Njeri i vogël. \* Dera e vogël euf. shih te DER/Ë,~A. Ujët e vogël (e hollë) euf. shih tek UJ/Ë,~T 2.
- VORBË** f. \* Stan vorbash mosërf. stan i keq, stan pa bulmet. Ka gjetur rrasa vorbën (vegshin) keq. shih te RRAS/Ë, ~A. Shkoi për (për të bërë) vorba (vegsha) iron. mbaroi, vdiq.
- VRAS** kal. \* Të vret barkun iron. të pëlqen shumë diçka, ke qejf ta hash. Vret (numëron, zë) miza (gjithë ditën) mospërf. shih te MIZ/Ë,~A. Vret barkun në hije iron. nuk i pëlqen të punojë, është dembel e rri pa punë.
- VRESHT** m. \* Hajde baba të të tregoj vreshtin (arat)! iron. shih BABA,~I.
- VRIMË** f. \* Fyell pa vrima mospërf. njeri që s'vlen për asgjë; njeri fare budalla.
- VRINGËLLOJ** kal. 3. fig. keq. E kërcënoj dikë me armë, tregoj forcën para dikujt për ta frikësuar, i kanosem me luftë. Imperialistët vringëllojnë armët.
- VULGAR** mb. 1. keq. Që sillet në mënyrë të pahijshme e të pakulturoar; që është karakteristik për një njeri të trashë në të folur e në sjellje; që ka përmbajtje të rëndë, që nuk duhet bërë a nuk duhet thënë, i ulët. Njeri vulgar. Qëndrim vulgar. Sjellje vulgare. Fjalë (shprehje) vulgare.
- VULGARIZIM** m. libr. 2. keq. Mënyrë e paraqitjes së diçkaje, duke e thjeshtëzuar jashtë mase ose duke i shtrembëruar thelbin a përmbajtjen. Shtrembërime dhe vulgarizime. Ra (kaloi) në vulgarizim.
- VULGARIZOHET** vetv. libr. 1. keq. Thjeshtëzohet jashtë mase a shtrembërohet, bëhet vulgar, merr pamje vulgare. U vulgarizua çështja.
- VULGARIZOJ** kal. 1. keq. E thjeshtëzoj diçka jashtë mase e paraqit duke ia shtrembëruar thelbin a përmbajtjen; e paraqit në mënyrë vulgare. E vulgarizoi teorinë (idenë, pikëpamjen, çështjen).
- VULGARIZUES** mb. 1. keq. Që e paraqet diçka duke e thjeshtëzuar jashtë mase ose duke ia shtrembëruar thelbin a përmbajtjen; vulgar. Shpjegim vulgarizues. Pikëpamje vulgarizuese.
- XIXËLLONJË** f. 2. bised. keq. Vajzë a grua mendjelehtë, që i pëlqen të duket e të bredhë që nuk di ta ruajë bukurinë e nderin e vet. Bridhte pas xixëllonjave.
- XHABAXHI** m. bised. keq. 1. Ai që kërkon të hajë në kurriz të të tjerëve, qelepërxihi.
- XHAMBAAZ** m. 2. keq. Njeri që bën dallavere; njeri dredharak që përpiqet t'ua hedhë të tjerëve e të nxjerrë përfitime për vete; dallaveraxhi; bataqçi. Pazarllëqe prej xhambazi.
- XHAMBAAZLLËK** m. 2. zakon. bised. keq. Veprime për të nxjerrë përfitime me rrugë të pandershme, dallavere. Bënte xhambazllëqe. Merrej me xhambazllëqe.
- XHAMI** f. \* Gjeti xhami (kishë) ku të falet iron. shih te KISH/Ë, ~A.
- XHEP** m. \* I është shpuar xhepi (kuleta) iron. shih te SHPOHEM.
- XHEVAHIR** m. 3. iron. Fjalë a veprime të gabuara ose krejt pa vend. Xhevahire shtypi. Thotë xhevahire. Ka plot xhevahire.
- XHUFKË** f. \* Zero me xhufkë (me bisht) keq. shih te BISHT,~I
- XHYBE** f. 3. fig. keq. Mbulesë për të fshehur fytyrën e vërtetë a qëllimet e vërteta.
- YLEFE** f. vjet. iron. Rrogë.
- YRNEK** m. bised. \* Një yrnek janë mospërf. keq. janë njësoj, nuk kanë ndryshim njëri nga tjetri.

- ZABIT** m. 2. keq. Oficer i egër, i vrazhdë e i paditur, oficer i pashpirt që shtyp dhe mundon popullin. Është oficer i popullit, s'është zabit. Sillet si ndonjë zabit. Iku koha e zabitëve.
- ZANAT** m. \* Sa ka zanati! edhe iron. ka punë e gjëra që i njeh mirë vetëm ai që merret me to dhe që s'mund t'i dinë të gjithë, duhet ta njohësh mirë një punë që ta bësh si duhet.
- ZBARDH** kal. 6. fig. I jap nder e lavdi, e nderoj, e nxjerr faqebardhë; e ndrit; e bëj më të lumtur. Ia zbardhi faqen (fytyrën) babait (familjes, shkollës, ndër-marrjet). Na i zbardhën armët. I zbardhi jetën. Ajo e zbardhi atë shtëpi. Lëre, se e zbardhe! iron. \* Zbardh (hap, zbulon) dhëmbët keq. zgërdhihet; qesh me të tal-lur. Zbardhi sytë mospërf. vdiq.
- ZBËRTHEJ** kal. \* I zbërthen brinjët keq.
- ZBRES** jokal. \* Zbriti (ra, u rrëzua) nga fiku iron. shih te FIK, ~U. Zbriti (u ul) nga shala e hipi në samar iron. shih te SHAL/Ë, ~A II.
- ZBUKUROJ** kal. 2. edhe keq. E përpunoj dhe e pasuroj, e latoj dhe e limoj, e stërholl- loj për ta bërë më tërheqës, më të gjallë e më shprehës (për stilin, gjuhën etj.). E ka zbukuruar gjuhën (stilin).
- ZBUKURUAR** mb. 2. Që është bërë më tërhe- qës, që është pasuruar me elemente më shprehëse, që është limuar e latuar; keq. Tepër i stërholluar (për gjuhën, për stilin etj.). Gjuhë e zbukuruar. Poezi e zuku- ruar. Ka stil të zbukuruar.
- ZBULOJ** kal. \* I zbuloi (i zbraz, i hapi) barkun diku shih te ZBRAZ. Zbulon (zbardh, hap) dhëmbët keq. shih te ZBARDH.
- ZBULUAR** ndajf. \* Me bark zbuluar pa fshe- hur gjë, hapur. Paske fjetur zbuluar iron. nuk qenke në qejf, nuk qenke mirë.
- ZBUT** kal. \* I zbuti (i shoi, i ftohu, i uli, i shtroi) gjakrat shih te GJAK, ~U I. Ia zbuti kurrizin (shpinën, brinjët) keq. e rrahu fort, e rrahu keq, e rrahu mirë e mirë. Ia zbuti (ia uli) zërin shih tek UL.
- ZDRËMALAQ** mb. keq. I zdrëmur. Kalë (gomar, ka) zdrëmalaq. Shtambë zdrë- malaqe.
- ZEMËR** f. \* Iu drodhën telat e zemrës edhe iron. shih tek TEL, ~I.
- ZEMËRKATRAN** mb. keq. Zemërzi.
- ZEMËRNXIRË** mb. 2. keq. Zemërzi.
- ZEMËROJ** kal. E zemëroi keq.
- ZEMËRQEN** mb. keq. 1. Që nuk ka mëshirë, që nuk ndien asnjë dhembje për fatke- qësitë e të tjerëve; i pamëshirshëm, mi- zor, shpirtqen, shpirtkazmë. Beu ishte zemërquen.
- ZEMËRSHTRIGË** mb. keq. 1. Që e ka zem- rën shumë të keqe, zemërkeq (kryesisht për gratë). Njerkë zemërshtrigë.
- ZERO** f. \* Zero me bisht (me xhufkë) keq. shih te BISHT, ~I.
- ZEZË** f. \* E bën (e paraqit) të bardhën të zezë (të zezën të bardhë) keq. shih te BARDH/Ë, ~A (e).
- ZË** m. b) Nuk i vjen zëri iron. shih te VIJ.
- ZË** kal. E zuri në cak keq. shih te CAK, ~U. Zë (vret, numëron) miza (gjithë ditën) mospërf. shih te MIZ/Ë, ~A. Mos të zëntë ora! mallk. shih tek OR/Ë, ~A I. Zuri përruan (ledhin) keq. vdiq; ngordhi. E ka zënë qymyri shak. shih te QYMYR, ~I. Zuri rruazën (qafën, zverkun) keq. c) ngulitet, bëhet pjesë e pandarë e diçkaje. S'i zë bytha vend thjeshtligj., keq. shih te VEND, ~I. Zuri (kapi) qeni një lepur mospërf., iron. shih te QEN, ~I.
- ZGËRDHIHEM** vetv. 1. keq. Qesh zakon- isht pa vend e pa shkak, duke shtrem- bëruar fytyrën e duke nxjerrë dhëmbët jashtë, për të vënë në lojë dikë a për të shfaqur mospërfillje ndaj diku; zbardh dhëmbët. Ç'ke që zgërdhiesh? Mos u zgërdhi ashtu!

- ZGËRDHIJ** kal. Zgërdhin dhëmbët keq. qesh duke shtrembëruar fytyrën e duke nxjerrë dhëmbët jashtë për t'u tallur me dikë a për të shfaqur mospërfillje ndaj tij, zgërdhihem.
- ZGOBELL** mb. keq. 1. Që e ka trupin të gjatë, por të shëmtuar. Burrë zgobell. Grua zgobelle.
- ZGURDHË** f. 2. keq. Gurmazi, fyti, gryka. E hapi zgurdhën. Sa e ka zgurdhën, na shurdhoi.
- ZGJAT** kal. \* E ka zgjatur gjuhën (gojën) keq. është bërë llafazan, merr nëpër gojë dikë a diçka, flet shumë kundër dikujt a diçkaje, e shan dikë; merret me thashetheme. Zgjati hundët keq. u përzie në punët e dikujt tjetër, fut hundët në çështje që nuk i përkasin. Zgjat krahët (duart, gishtërinjtë) keq. shtrin e përhap ndikimin e vet. E zgjat muhabetin me dikë bëhet i afërt me dikë, afrohet shumë me të.
- ZGJATEM** vetv. \* I janë zgjatur (i janë rritur) thonjtë keq. shih te THUA, THOI.
- ZGJEBARAK** mb. 2. si em. ~, ~U m. ~Ë, ~ËT përçm. Njeri i fëlliqur e i veshur keq.
- ZGJYRË** f. 7. përd. ndajf. Zi, keq. I ka vajtur puna zgjyrë.
- ZI** ndajf. 2. fig. Keq; shumë keq. Hoqi zi. I shkoi zi. Mendon zi. Zi e më zi. I shkonin punët zi.
- ZI** mb. 5. fig. Që sjell të këqija a që ndjell të këqija; i keq. Zakon i zi. Era (juga) e zezë erë e ftohtë, që fryn në dimër dhe që është e dëmshme për bimët. E ka zemrën të zezë. E ka shpirtin të zi. E mori plumbi i zi. I ka dalë nami i zi.
- ZJARR** m. Lepuri në mal e vala (kusia) në zjarr fj.u. iron. shih te LEPUR, ~I. Peshku në det, tigani në zjarr fj.u. iron. shih te PESHK, ~U.
- ZJARRFIKËS** m. 3. fig. keq. Ai që mundohet të shuajë luftën e popujve për liri ose të pengojë lëvizjet revolucionare, ai që përipiqet të pengojë zhvillimin e vullshëm të një ngjarjeje etj. Zjarrfikësit revizionistë. Zjarrfikës revolucionit (i luftërave çlirimtare).
- ZOG** m. \* Nxjerr (çel) zogj iron. Bufi mburr zogjtë e tij iron. shih te BUF, ~I.
- ZOGORI** f. 2. keq. Grumbull njerëzish të harbuar, që kanë qëllime të këqija ose që veprojnë kundër të tjerëve. Zogori bejlerësh. Fashizmi me zogoritë e tij.
- ZONJË** f. \* Zonjë e bukur bot. helmarinë. Zonjë e mirë euf. sëmundja e lisë. Lule zonje bot. shih te LUL/E, ~JA.
- ZORRAXHI** m. keq. Njeri që u lëpihet të tjerëve, u bën lajka dhe mundohet të përfitojë prej tyre; sahanlëpirës. Zorraxhi i fëlliqur.
- ZOTI** m. vet. tr. e shquar. \* S'e njeh qeni të zotin shih te QEN, ~I. Shan shtamba të zotin iron. shih te
- ZOTI** mb. 2. keq. Që ka prirje për të bërë diçka të keqe, që s'e ka për gjë të bëjë një të keqe.
- ZOTROTE** palak. bised. 2. iron. Përdoret për t'iu drejtuar me qesëndi ose me qortim një njeriu që e mban veten për të madh. Nuk luajtke zotrote! Erdhe, zotrote?
- ZUZËROJ** jokal. 1. keq. Mbjaj qëndrim prej zuzari, sillem si zuzar. Djali i beut zuzëronte nëpër qytet.
- ZVARRITEM** vetv. 3. fig. E shtyj jetën me të keq, mezi jetoj, zhargem. Zvarriteshin me të keq.
- ZVERK** m. Zuri zverkun (rruazën, qafën) keq. shih te ZË.
- ZYRTAR** m. 2. keq. Burokrat. Është bërë zyrtar.
- ZYRTAR** mb. 4. keq. Që është karakteristik për burokratin. Qëndrim zyrtar. Me ton zyrtar.

- ZYRTARIZËM** m. keq. Mbivlerësim i punës që kryhet në zyrë dhe i rolit që luajnë shkresat e aktet zyrtare; kuptimi dhe zbatimi në mënyrë shumë të ngushtë i ligjeve dhe i rregullave të vendosura nga organet shtetërore; qëndrim prej zyrtari a prej burokrati. Frymë (prirje) zyrtarizmi. Shfaqje të zyrtarizmit.
- ZHABË** f. zool. b) keq. thuhet kur dikush nuk e bën një punë pa i dhënë diçka të hajë e të pijë.
- ZHARGAVINË** f. krahin. keq. 1. Makinë, karrocë a mjet tjetër që është vjetruar a që mezi ecën; karakatinë. Hipi në një zhargavinë. 2. fig. Njeri tepër i ligështuar, që mezi heq këmbët zvarrë e që s'është i aftë për të bërë ndonjë punë; njeri fare pa vlerë. U bë fare zhargavinë. Nuk të mbaron punë zhargavina.
- ZHARGAVITET** vetv. krahin. keq. 1. Vjetrohet shumë e mezi ecën, bëhet zhargavinë (për një makinë, karrocë etj.). 2. fig. Ligështohet e bëhet fare i paaftë për punë; humbet çdo aftësi a vlerë (për njerëzit).
- ZHARGAVITUR** mb. krahin. keq. 1. Që është vjetruar shumë e mezi ecën, që është bërë zhargavinë. Karrocë e zhargavitur. 2. fig. Që është ligështuar e është bërë fare i paaftë për punë; që ka humbur çdo aftësi a vlerë (për njerëzit).
- ZHBIJ** kal. 1. Shkul një bimë me gjithë rrënjë. E zhbinë barin e keq. Shkatërroj diçka që nga themeli; asgjësoj, shfaros. E zhbiu shtëpinë. I zhbinë armiqët.
- ZHBIRUES** mb. Tip zhbirues. keq.
- ZHDRIDHEM** vetv. 3. vet. veta III fig. Prishet, merr një drejtim tjetër. Puna u zhdrodh keq.
- ZHELAMAN** mb. keq. 1. I veshur me zhele; që i varen zhelet, leckaman, zhelan.
- ZHELE** f. 2. fig. bised., keq. Njeri a diçka që nuk ka asnjë vlerë, leckë; njeri që merret nëpër këmbë nga kushdo. Para tij ai është zhele. E bëri zhele e shau rëndë,
- s' i la gjë pa thënë, e bëri për pesë para. përd. mb. I vjetër, i grisur dhe i ndotur (kryesisht për veshjet). Pantallona (këpucë) zhele.
- ZHELEMEL** mb. keq. Zhelaman, leckaman.
- ZHELENDYRË** mb. keq. Që është veshur me zhele shumë të ndyta, sa që nuk shihet dot me sy, i rreckosur e i ndyrë.
- ZHËNGË** f. 4. fig. keq. Njeri i bërë si zhabë. Erdhi zhënga.
- ZHGAN** m. 1. edhe keq. Lukuni, zogori. Zhgan ujqish (qensh). Zhgan kusarësh (rrugaçësh). Zhgan armiçsh (larosh). Zhgan të dehurish (pijanecësh).
- ZHGJYMTOJ** kal. 1. E bëj krejt të gjymtë, e gjymtoj keq.
- ZHONGLER** m. 2. fig. keq. Njeri që vepron e punon me dredhi; njeri pa parime në jetë, njeri që nuk e mban fjalën e që kthehet nga të fryjë era, ai që e ndryshon shpesh qëndrimin e tij sipas interesit; njeri dhelparak, dredharak. Zhonglerët revizionistë.
- ZHURMË** f. 5. keq. Diskutim i madh e i fryrë, që bëhet qëllimisht në shtyp etj. rreth një njeriu, një veprë a një çështjeje për të tërhequr vëmendjen e njerëzve, për të mashtruar, për t' u dukur etj.; bujë. Zhurmë demagogjike. Zhurma e propagandës borgjeze (revizioniste). Prirje për bujë e për zhurmë. Pa zhurmë e pa bujë. Bën shumë zhurmë. E shpallën me zhurmë.
- ZHURMËMADH** mb. 4. keq. Që bëhet qëllimisht me shumë zhurmë e bujë për të tërhequr vëmendjen e njerëzve; i bujshëm, zhurmëshumë. Mbledhje zhurmëmadhe. Deklarata zhurmëmëdha. Reklamë (propagandë) zhurmëmadhe.
- ZHURMËSHUMË** mb. 3. keq. Që bëhet qëllimisht me bujë e me zhurmë për të tërhequr vëmendjen e të tjerëve; i bujshëm, zhurmëmadh. Lëvdata zhurmëshumë. Reklamë zhurmëshumë.

**ZHURMESHËM** mb. 5. keq. Që bëhet qëllimisht me zhurmë e bujë për të tërhequr vëmendjen e të tjerëve, zhur-

mëmadh. Deklarata (bisedime) të zhurmshme. Takim i zhurmshëm. Fushatë e zhurmshme.